



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 56 regjistër (JR)
Datë 11.10.2021

Nr. 9 i vendimit
Datë 28.02.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.02.2024, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 416, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (me protokollet (1) e (12) të saj) dhe jurisprudenca e kësaj gjykate; nenet 18, 29, 30, 31, 33/1, 41, 42 dhe 179/b, paragrafi 1, 2 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni A, pika 1, neni C, pikat 3 e 5, neni D, pika 5 dhe neni F, pikat 1, 2, 3 e 7 të Aneksit të Kushtetutës; nenet 1,

2, 62, 63, dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenet 46, 47, 48 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet me shkrim, që përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. Pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 28.05.2018, sipas të cilit:

1. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.

2. Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë.

3. Ka mosdeklarime pasurie.

4. Nuk ka kryer deklarim të rremë.

5. Subjekti nuk gjendet situatën e konfliktit të interesit.

4. Me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera. Për këtë qëllim, ka dërguar raportin e hartuar për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
5. Për vlerësimin e aftësive profesionale, KLGj-ja, pasi ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret e vlerësimit, të pasurisë, figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në provat e administruara, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që subjekti të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 416, datë 08.07.2021, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
7. Në vendim, Komisioni ka konkluduar për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit mbi konkluzionet si më poshtë.

7.1. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë: Subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Gjithashtu, subjekti ka kryer disa deklarime të pamjaftueshme dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, në këtë rast, duhet të aplikohet pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

7.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: Subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas gurmës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe trupi gjykues e konsideron të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

7.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale: Komisioni çmon se ka arritur një nivel kualifikues, sipas gurmës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

II. Mbi ankimin dhe shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku

8. Më datë 16.09.2021, subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, paraqiti pranë Komisionit ankimin e protokolluar me nr. {***} prot., kundër vendimit nr. 416, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky ankim është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Nëpërmjet ankimit të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, në përmbushje të procesit të rregullt ligjor, kërkoi nga Kolegji të administrohen provat si më poshtë vijojnë:

- raport i audituesit ligjor A. M.;

- deklaratë noteriale e z. E. S.;

- dokument nga Credins Bank, datë 18.08.2021;

- e-mail, datë 08.07.2021; e-mail, datë 03.09.2021; si dhe e-mail, datë 07.09.2021 – komunikime me Komisionin.

Në përfundim të ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji:

(i) Çeljen e hetimit gjyqësor dhe zhvillimin e gjykimit në seancë dëgjimore, përsëritjen e shqyrtimit të provave të dosjes së rivlerësimit, si dhe të lejohet paraqitja e shqyrtimi i disa provave të reja, për të cilat plotësohen kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

(ii) Ndryshimin e vendimit nr. 416, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhënë për subjektin e rivlerësimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku.

8.1. Shkaqet procedurale të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

8.1.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vendimin e Komisionit, duke kërkuar shqyrtimin në themel të fakteve e provave nga Kolegji, çeljen e hetimit gjyqësor dhe zhvillimin e gjykimit në seancë gjyqësore publike, si dhe marrjen e disa provave të reja, për të cilat plotësohen kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se për diferencat negative që u përkasin viteve 2015 dhe 2016, nuk është pyetur nga Komisioni dhe as vënë në dukje si problematika të rezultuara në këto dy vite. Subjekti pretendoi se procedura administrative e zhvilluar në Komision, ka pasur shkelje të rëndësishme të të drejtave të subjektit lidhur me njohjen me rezultatet e hetimit dhe shkaqet që prezumojnë vendosjen e masës disiplinore, të cilat kanë çuar në zhvillimin e një procesi të parregullt, në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës. Subjekti pretendon se e drejta për barazi të armëve në kuptimin e një balance të drejtë të mundësive për diskutimin e provave edhe nga subjekti i rivlerësimit, duhet të ishte aplikuar edhe në këtë proces, por qartësisht ky parim i barazisë së armëve ka munguar.

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

8.1.2 *Lidhur me periudhën financiare para vitit 2003*, nga e cila ka rezultuar një diferencë negative në Komision, prej 283.071 lekësh, për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 81,4

¹ "Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit".

m², blerë në vitin 1995, në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare e Komisionit nuk është e saktë, pasi të ardhurat e bashkëshortit janë përfshirë në mënyrë të pjesshme duke e kundërshtuar për arsye si vijojnë.

(i) Konkluzioni i Komisionit për këto të ardhura është i gabuar për shkak se distanca kohore prej 30 vjetësh më parë, në mënyrë absolute e bën të pamundur administrimin e dokumentacionit nga organet tatimore. Subjekti pretendon se të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti, nga puna si avokat për periudhën 1990-1992, duhet të konsiderohen në shumën 600.000 lekë.

(ii) Në lidhje me kursimet nga pagesat për udhëtimet e bashkëshortit jashtë shtetit në vitet 1992-1997, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se Komisioni në vendim konkludon se ato mund të bëhen pjesë e analizës financiare, por nuk gjejnë pasqyrim në këtë analizë. Subjekti pretendon se nga vizita në ShBA dhe në Këshillin e Evropës, të ardhurat e kursyera kanë qenë jo më pak se 1.000.000 lekë.

(iii) Në lidhje me pagesat e siguruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë gjatë periudhës 1992-1997, subjekti pretendon se për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nuk gjendet dokumentacion për të provuar përfitimin e pagesave. Sipas pretendimit të subjektit, të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga mësimdhënia, për periudhën 1992-1996, kanë qenë jo më pak se 100.000 lekë.

(iv) Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit, subjekti pretendon se kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë në vitin 1995, edhe pa përfshirë në analizë të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit. Sipas subjektit, pasuria është shitur në vitin 1995, por kontrata është realizuar në vitin 1998 për shkak se blerësi kishte probleme financiare me persona të tretë.

(v) Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të vitit 1996 të ardhurat nga shitja e garazhit në shumën 10.000 dollarë, të cilat janë deklaruar në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti kërkon nga Kolegji që të ardhurat për krijimin e kësaj pasurie të konsiderohen si të ligjshme, duke konkluduar rrëzimin e diferencës negative prej -283.071 lekësh dhe pranimin e analizës financiare të subjektit, e cila rezulton me vlerë pozitive në shumën 1.372.824 lekë.

8.1.3. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 195 m² dhe garazh me sip. 22,2 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se marrëdhënia ndërmjet saj dhe babait nuk ka qenë interesi, e krijuar nga një marrëdhënie biznesi, dhurimi apo huaje, e për rrjedhojë ai nuk mund të konsiderohet si person tjetër i lidhur apo person i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit pretendon se edhe nëse babai i saj do të konsiderohet si person tjetër i lidhur, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, rezulton se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar pagesën e shumës prej 25.000 USD në vitin 2001. Sipas subjektit të rivlerësimit, babai i saj ka pasur një aktivitet privat në Peqin, fakt i cili ka rezultuar edhe nga hetimi në Komision, por subjekti kërkon nga Kolegji që të vlerësohet informaliteti dhe koha e largët e kaluar. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, pretendon se ajo ka vërtetuar edhe me

anë të provës shkresore se babai i saj ka pasur një marrëdhënie huaje me shtetasin V. K., në shumën 25.000 USD, çka i ka mundësuar atij pagesën pranë firmës së ndërtimit, por Komisioni nuk e ka konsideruar këtë huadhënie në analizën e tij duke e paragjykuar situatën se ky dokument është paraqitur me vonesë. Në përfundim të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri financiare të subjektit në shumën - 189.091 lekë dhe për parapagimin nga babai i saj në shumën 3.426.000 lekë. Nga analiza që ka kryer subjekti i rivlerësimit, pretendon se ka pasur mundësi financiare për të krijuar këtë pasuri.

8.1.4. Lidhur me dy apartamentet me sipërfaqe 184,2 m² dhe 82,4 m² dhe tri garazhe me sipërfaqe përkatësisht 21,93 m², 15,95 m² dhe 15,08 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, kompleksi “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se huaja që ka shërbyer si burim krijimi është shlyer prej shumës së marrë kredi në Tirana Bank, e cila është deklaruar si në deklaratat periodike, ashtu edhe në atë *vetting*. Sipas subjektit, huaja, si burim krijimi i kësaj pasurie, është shlyer me shumën e marrë kredi, prandaj, për sa kohë është likuiduar plotësisht nëpërmjet shlyerjes nga ky burim, në momentin e përpilimit të deklaratës në vitin 2017, ajo nuk ka ekzistuar. Për personin tjetër të lidhur, z. K. P., subjekti pretendon se konkluzionet e Komisionit për të mos konsideruar mjetet monetare si të disponueshme dhe të përdorshme nga huadhënësi, nuk qëndrojnë. Sipas subjektit të rivlerësimit, z. P. është administrator dhe ortak me 75% të kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK dhe është i regjistruar në QKB edhe si person fizik, me fushë veprimtarie: “Investime në fushën e punimeve të ndërtimit”.

8.1.5. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 57 m² dhe verandë me sipërfaqe 31 m², ndodhur në {***}, Vlorë, subjekti i rivlerësimit pretendon se për kontratën e porosisë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 07.06.2013, të lidhur ndërmjet bashkëshortit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, nuk ka pasur dijeni për kohën kur ajo është nënshkruar, pasi u revokua brenda një muaji, duke qenë se apartamenti i përcaktuar në këtë kontratë nuk ishte i njëjtë fizikisht me atë të përshkruar në kontratë, ndaj shoqëria e ndërtimit i ktheu shumën prej 30.000 eurosh bashkëshortit. Me të njëjtën shoqëri ndërtimi është lidhur një kontratë e re porosie për blerjen e një apartamenti në datën 22.03.2018. Subjekti i rivlerësimit kundërshton rezultatin financiar të Komisionit, i cili ka konkluduar për një diferencë negative në shumën -2.661.037 lekë.

8.1.6 Lidhur me gjendjen cash në banesë, të deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2004, subjekti rivlerësimit ka pretenduar në ankim se shumën prej 600.000 lekësh e ka shpenzuar në vitin 2005 për arredimin e shtëpisë në rr. “{***}”, ndërsa shumën prej 900.000 lekësh e ka shpenzuar në vitin 2006. Sipas subjektit, qëndrimi i Komisionit se pakësimi i gjendjes *cash* nuk është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2005 dhe nuk është deklaruar burimi në DIPP-në e vitit 2006 dhe as në deklaratën *vetting*, është i gabuar, pasi mungesa e deklarimit të pakësimit të gjendjes *cash* në deklaratën e vitit 2005 dhe mbartja e shumës prej 900.000 lekësh në vitin 2006 nuk e zhbën faktin e disponimit të shumës së mësipërme nga subjekti në vitin 2006. Sipas subjektit të rivlerësimit, në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me një pasaktësi në deklarim dhe jo me mosdeklarim.

8.1.7 Lidhur me analizën financiare për vitet 2006, 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit e kundërshton si jo të drejtë rezultatin financiar të Komisionit për këto vite.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Zegjine Sollaku, duke vendosur shkarkimin e saj nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, gjithashtu dhe në rastet kur nuk jemi në kushtet e nenit 51 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji 49/2012”). Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 364, datë 02.04.2021, të Komisionit nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi në bazë të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

11.1. Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, të paraqitur në ankim, me të cilën kërkoi nga Kolegji që gjykimi i çështjes së saj të zhvillohet në

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

seancë gjyqësore publike, të administrohen si prova të reja aktet që kërkoi të merren³ nga Kolegji, të cilat ia ka bashkëngjitur ankimit.

11.2. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit disa akte shkresore (cituat në paragrafin 8 më sipër), për të cilat pretendon të merren si prova të reja në kuadër të shqyrtimit të çështjes së saj të rivlerësimit. Më datë 20.02.2024, në Kolegj janë depozituar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, në përputhje me parashikimet e nenit 49, paragrafi i dytë i ligjit nr. 49/2012.

11.3. Bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj, si dhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit – trupi gjykues vendosi refuzimin e marrjes në cilësinë e provave të reja të akteve bashkëlidhur ankimit të subjektit, duke arsyetuar si vijon.*

11.4 Në mbështetje të parashikimeve ligjore, në rastin konkret vlerësohet se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për administrimin e provave nga trupi gjykues, përveçse nuk mbështetet mbi fakte që provojnë mospasjen mundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, por edhe sikur të ishin në plotësim të këtyre kritereve, nuk konsiderohen të nevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për më tepër, edhe sikur të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë nëpërmjet tyre, përsëri nuk ndikojnë në marrjen e vendimit, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

11.5. Gjithashtu, në vlerësim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillnin nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit për korrigjimin e tyre. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerësoi kryesisht se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga

³ Subjekti kërkoi të administrohen nga Kolegji provat e cituara në paragrafin 8 më sipër.

Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

11.6 Njëkohësisht, trupi gjykues vlerëson të nënvizojë se pretendimet apo qëndrimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në aktin “Raport audit”, të paraqitur me ankimin dhe të kryer nga eksperti kontabël A. M., duke qenë se janë përfshirë si pjesë integrale e vetë ankimit të subjektit, i cili ka përthithur analizat financiare dhe interpretimin e ligjit të bërë prej ekspertit në brendinë e tij, janë analizuar nga trupi gjykues në marrjen e këtij vendimi në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, pavarësisht faktit se akti i ekspertimit nuk iu nënshtua regjimit të provës së re.

11.7 Trupi gjykues në konkluzion të arsytimit të mësipërm, vlerësoi që çështja të gjykohej në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazën e akteve të administruara në Komision, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku.

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

- 12.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se diferencat negative që u përkasin viteve 2015 dhe 2016, të cilat i korrespondojnë shumës në total prej -3.058.296 lekësh, ishin konstatime të papritura, pasi asnjëherë, qoftë edhe në pyetësorë gjatë fazës së hetimit, apo edhe gjatë seancës dëgjimore në Komision, nuk është pyetur dhe nuk i janë vënë në dukje si gjetje problematikat e rezultuara në këto dy vite. Subjekti pretendoi se procedura administrative e zhvilluar në Komision ka pasur shkelje të rëndësishme të të drejtave të subjektit lidhur me njohjen me rezultatet e hetimit dhe shkaqet që prezumojnë vendosjen e masës disiplinore, të cilat kanë çuar në zhvillimin e një procesi të parregullt në shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”) dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sipas këtyre pretendimeve, Komisioni kur konstaton se subjekti nuk ka përmbushur një detyrim ligjor të caktuar, duhet t’ia bëjë me dije dhe t’ia komunikojë qartë subjektit të rivlerësimit, pikërisht për garantimin e së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, për t’u dëgjuar drejtësisht e për t’u mbrojtur në mënyrë efektive ndaj gjetjeve. Subjekti pretendon se e drejta për barazi të armëve në kuptimin e një balance të drejtë të mundësive për diskutimin e provave edhe nga subjekti i rivlerësimit, duhet të ishte aplikuar edhe në këtë proces, por qartësisht ky parim i barazisë së armëve ka munguar.

12.1 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, se ajo nuk është pyetur për të dhënë shpjegime për diferencat negative që u përkasin viteve 2015 dhe 2016, duke qenë se nuk i është vënë në dispozicion metodologjia e ndjekur për hartimin e analizës financiare nga Komisioni, me qëllim që të ndërtonte një mbrojtje efektive nëpërmjet konsultimit me ekspertë të fushës, trupi gjykues konstaton një situatë faktike të ndryshme. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se së bashku me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit analizën financiare për periudhën 2003-2016, duke i bashkëngjitur edhe metodologjinë me shpjegimet për mënyrën e hartimit të kësaj analize. Subjekti i rivlerësimit, znj.

Zegjine Sollaku, së bashku me prapësimet e saj, ka paraqitur në Komision për këto dy vite një analizë financiare të korigjuar sipas pretendimeve të saj, në të cilën, pas reflektimit të këtyre pretendimeve, vitet 2015 dhe 2016 kanë vlerë pozitive, çka dëshmon se subjekti i rivlerësimit është njohur me rezultatin negativ të këtyre viteve nga Komisioni, përfshirë arsyet që e kanë shkaktuar, dhe është mbrojtur duke e korigjuar këtë rezultat të analizës financiare në favorin e saj, duke korigjuar ato elemente që ajo i ka vlerësuar të gabuara.

12.2 Rezulton se subjekti është mbrojtur në përgjigje të rezultateve të hetimit nëpërmjet shtjellimit të pretendimeve të saj, sipas të cilave, megjithëse ka korigjuar rezultatin përfundimtar të viteve 2015 dhe 2016, nuk gjen pasqyrim kontestimi i elementeve të analizës së Komisionit që kanë shkaktuar balancat negative të këtyre viteve, për sa i përket përdorimit të arkës së personit fizik në emër të bashkëshortit të subjektit, për të përballuar shpenzimet e ekonomisë familjare gjatë viteve në diskutim. Këto kontestime janë evidentuar vetëm me ankimin dhe analizën e bërë në raportin auditues të ekspertit A. M., i paraqitur bashkë me ankimin, i cili do të analizohet në detaje në vijim të këtij arsyetimi, lidhur me shkaqet e ankimit që i adresohen kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në këtë mënyrë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, se ajo nuk është njohur me këto problematika që kanë shkaktuar balancën negative, rezulton i pambështetur në të dhënat që gjenden në dosjen e Komisionit, për sa rezulton se ajo është njohur me rezultatin negativ të raportit të hetimit paraprak dhe e ka kontestuar atë për shkaqe në të cilat nuk përfshihen ato që i adresohen përdorimit të arkës së personit fizik. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se nuk i ka kaluar barra e provës për këto dy vite, për balancat negative dhe arsyet e krijimit të tyre, nuk gjendet i bazuar.

12.3 Lidhur me pretendimin e moszbatimit të parimit të barazisë së armëve, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka zhvilluar seancë dëgjimore publike, gjatë së cilës, pas paraqitjes së gjetjeve prej relatorit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime e ka parashtruar pretendimet e saj për të kundërshtuar rezultatet dhe gjetjet e hetimit administrativ, në ushtrim të së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar. Në vendim është bërë një analizë e plotë e provave, të cilat janë shqyrtuar për vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Rezulton se për secilën pasuri të hetuar, janë marrë në konsideratë shpjegimet dhe pretendimet e subjektit, duke i cituar ato herë pas here, si dhe janë dhënë shpjegimet për mospranimin e kërimit për marrjen e provave me dëshmitarë. Gjithashtu, rezulton se gjatë hetimit administrativ, shpjegimet dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, janë administruar nga Komisioni, dhe se asnjë prej këtyre akteve nuk është refuzuar, si edhe i janë nënshtruar vlerësimit të Komisionit sipas gjetjeve respektive, duke i dhënë vlerën provuese që Komisioni ka çmuar sipas diskrecionit të tij. Nuk rezulton që gjatë seancës dëgjimore të jenë parashtruar kërkesa apo debatuar çështje që lidhen me administrimin e provave që subjekti ka paraqitur në Komision. Sa më sipër, nuk u evidentuan të dhëna, sipas të cilave procesi i zhvilluar në Komision të ketë cenuar parimin e barazisë së armëve gjatë shqyrtimit të çështjes së subjektit të rivlerësimit.

12.4 Për sa më sipër, nga analiza që i bëhet këtij shkakut ankimi, rezulton se subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, i është garantuar procesi i rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të

Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së. Neni 42, pika 2 e Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se: *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj* (dispozitë kjo në harmoni me KEDNj-në). Kjo dispozitë kushtetuese nuk rezulton të jetë shkelur nga Komisioni në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, shkaku i ankimit për cenim të procesit të rregullt ligjor, nuk gjendet i bazuar.

Vlerësimi i Kolegjit lidhur me kriterin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit për këtë kriter

13. ***Lidhur me periudhën financiare para vitit 2003***, nga e cila, në përfundim të hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar një diferencë negative në vlerën prej 283.071 lekësh, për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 81,4 m², blerë në vitin 1995, në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare e kryer nuk është e saktë, pasi të ardhurat e bashkëshortit janë përfshirë në mënyrë të pjesshme duke e kundërshtuar atë për arsyet si vijojnë.

(i) Konkluzioni i Komisionit për këto të ardhura është i gabuar për shkak se distanca kohore prej 30 vjetësh më parë, në mënyrë absolute e bën të pamundur administrimin e dokumentacionit nga organet tatimore. Subjekti pretendon se pavarësisht se miratimi i ligjit nr. 7544, datë 06.01.1992, “Për tatimin mbi fitimin” është bërë në janar të vitit 1992, aktet nënligjore për vënien në zbatim të tij kanë dalë shumë kohë më vonë dhe për më tepër, ligjet fiskale të miratuara në janar të vitit 1992 janë shfuqizuar pas një viti dhe nuk janë implementuar për shkak të nxjerrjes me vonesë të akteve nënligjore dhe krijimit të strukturave për zbatimin e këtyre ligjeve. Subjekti pretendon se për një periudhë aktiviteti 6-mujor që, sipas Komisionit, nuk provohen pagesat e tatimeve, duhet të njihen në total të periudhës, të ardhura në shumën 600.000 lekë.

(ii) Në lidhje me kursimet nga pagesat për udhëtimet e bashkëshortit jashtë shtetit në vitet 1992-1997, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni në vendim konkludon se ato mund të bëhen pjesë e analizës financiare, por nuk gjejnë pasqyrim në këtë analizë. Subjekti pretendon se për shkak të kohës së gjatë të kaluar, institucionet e huaja që kanë kryer pagesat e kanë të pamundur të japin informacione. Subjekti pretendon se niveli i pagesave të përfituara nga bashkëshorti i saj ishte i tillë që nuk përfshinte vetëm shpenzimet e qëndrimit, por ishte edhe një shpërbllim në cilësinë e ekspertit të lartë. Subjekti pretendon se nga vizita në ShBA dhe në Këshillin e Evropës, të ardhurat e kursyera kanë qenë jo më pak se 1.000.000 lekë.

(iii) Në lidhje me pagesat e siguruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë gjatë periudhës 1992-1997, subjekti pretendon se për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nuk gjendet dokumentacion për të provuar përfitimin e pagesave. Sipas pretendimit të subjektit, të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga mësimdhënia, për periudhën 1992-1996, kanë qenë jo më pak se 100.000 lekë.

(iv) Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit se deklarimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 3, janë

kontradiktore krahasuar me deklaramet e saj në deklaratën *vetting*, është i gabuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë në vitin 1995, edhe pa përfshirë në analizë të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit. Subjekti shpjegon se pasuria është shitur në vitin 1995, por kontrata është realizuar në vitin 1998 për shkak se blerësi kishte probleme financiare me persona të tretë dhe regjistrimi i kësaj pasurie në vitin 1995 do t'i sillte atij bllokimin e kësaj pasurie nga huadhënësit me të cilët kishte konflikt.

(v) Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të vitit 1996 të ardhurat nga shitja e garazhit të ndodhur në Tiranë, në shumën 10.000 dollarë, të cilat janë deklaruar në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti pretendon se kjo pasuri u shit në kohën e trazirave në vitin 1997 dhe për shkak se ky ndërtim ishte provizor, i pahipotekuar, nuk është bërë kontratë shitjeje noteriale, por është bërë vetëm një deklaratë me shkrim dore. Subjekti pretendon se nuk ka ruajtur dokumentacion për shkak të periudhës së gjatë kohore, gjithashtu pretendon se në atë periudhë nuk kanë pasur detyrim ligjor për t'u treguar të kujdesshëm për ruajtjen e dokumentacionit që të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, në ankimin e saj i kërkon Kolegjit që të ardhurat për krijimin e kësaj pasurie të konsiderohen si të ligjshme, duke marrë parasysh të ardhurat si më sipër, si dhe duke konkluduar me rrëzimin e diferencës negative prej -283.071 lekësh, e si rrjedhojë pranimin e analizës financiare të subjektit, e cila rezulton me vlerë pozitive në shumën 1.372.824 lekë.

13.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Në konkluzion, duke konsideruar dhe reflektuar efektet mbi analizën financiare të vlerësimeve përfundimtare të trupit gjykues për çdo pretendim të subjektit – të argumentuar më lart në paragrafët përkatës, ku janë trajtuar edhe tematikat specifike – pamundësia financiare e familjes së subjektit për të paguar/krijuar këtë pasuri reduktohet në vlerën negative prej 283.071 lekësh.*

13.2 Nga hetimi administrativ i kryer në Komision lidhur me apartamentin me sip. 81,4 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, e të blerë në datën 30.04.1995, me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., kanë rezultuar të dhënat e mëposhtme.

Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie nga:

- (i) kursimet familjare ndër vite nga pagat;
- (ii) dietat e bashkëshortit si këshilltar i Presidentit të Republikës;
- (iii) dietat nga vizita në ShBA, një muaj, në maj të vitit 1993 (kursyer 4.000 USD);
- (iv) pagat si pedagog i jashtëm në Fakultetin Juridik.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 (në vijim “DIPP”), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë apartament 3+1, me burim krijimi privatizimin nga Enti Kombëtar i Banesave, pa deklaruar vlerën e tij prej 1.126.289 lekësh sipas kontratës së shitblerjes dhe as burimet financiare të krijimit të tij.

13.3 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të realizuara gjatë periudhës 1992-2003, të cilat ndër të tjera kanë shërbyer si burim për krijimin edhe të kësaj pasurie, në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

(i) “Paga e bashkëshortit si hetues në vitet 1987-1989, në vlerën 22.480 lekë; (ii) pedagog i brendshëm në Fakultetin e Drejtësisë 1989-1992, në vlerën 28.000 lekë; (iii) këshilltar ligjor i Presidentit të Republikës 1992-2002, në vlerën 4.165.159 lekë; (iv) këshilltar i jashtëm i Bankës Tirana, për periudhën 1996-2000, në vlerën 11.500.000 GRD (dhe dhrahmi greke); (v) kursime nga dietat për shërbime dhe udhëtime jashtë shtetit të bashkëshortit, në vlerën 20.000 USD; (vi) të ardhura nga veprimtaria si pedagog i jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë, si: UT, Universiteti Luarasi, Universiteti Evropian, Universiteti Kristal, Universiteti Marin Barleti. Të ardhurat e përfituara janë në vlerën 27.826 euro (Universiteti Evropian) dhe 9.600.000 lekë (Universiteti Marin Barleti dhe Universiteti Kristal). P.S.: Universitetet e tjera nuk kanë dokumentacion”.

13.4 Në deklaratën e parë të Interesave Privatë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura për bashkëshortin nga institucionet si më poshtë:

(i) Presidenca, periudha 1992-2002; (ii) Fakulteti i Drejtësisë Tiranë, periudha 1989-1992 (për të tria shumat neto 2.217.157 lekë); (iii) Bordi i “Botimeve Zyrtare”, periudha 1999-2002; (iv) avokat privat për vitet 1990-1992; (v) konsulent i jashtëm juridik, Tirana Bank, periudha 1996-2001, shuma gjithsej 5 milionë lekë; (vi) dieta për udhëtime jashtë shtetit, 1992 e në vazhdim, nga Presidenca, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e K.E Strasburg, USIS etj.

13.5 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e krijuar nga hetimi administrativ, rezulton se apartamenti objekt analize është blerë me anë të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 30.04.1995, lidhur ndërmjet Degës së Entit Kombëtar të Banesave, Tiranë, në cilësinë e shitësit dhe Th. S., në cilësinë e blerësit, kundrejt çmimit të blerjes 1.126.389 lekë, paguar sipas mandatarëkëtimit nr. {***}, datë 29.03.1995.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “AShK”) ka informuar Komisionin me shkresën nr. {***} prot., datë 15.10.2019, duke bashkëngjitur kontratën e shitblerjes dhe kartelën e pasurisë për apartamentin me sip. 81,4 m², se pasuria me nr. {***}, në {***}, rezulton e regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. Th.S..

13.6 Lidhur me burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, rezultoi se në deklaratën *vetting* janë deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti, të ardhura të familjes të renditura si në paragrafët 13.4 e 13.5 më sipër, të cilat Komisioni i ka marrë në analizë duke kontrolluar nëse këto burime janë të mjaftueshme për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 81,4 m².

13.7 *Lidhur me të ardhurat e krijuara nga puna si avokat* për periudhën 1990-1992, të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni në vendim ka konkluduar se: *[...] ndonëse për periudhën 1990 - 1991, për të cilën nuk kishte dispozita rregulluese e parashikuese mbi detyrimet tatimore, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion që të provojë specifikisht të ardhura të realizuara përgjatë kësaj periudhe, trupi gjykoës çmon se për shkak të distancës kohore dhe mungesës së organizimit formal-administrativ dhe mospasjes së detyrimit të ruajtjes së dokumentacionit provues të të ardhurave deri në ditët e sotme, në këto rrethana gjen aplikim pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe mund të konsiderohet si e realizuar e ardhur e z. Th. S. nga ushtrimi i profesionit si avokat, në shumën prej 300.000 lekësh dhe jo 600.000 lekë sa pretendon subjekti. Ndërsa, për sa i përket vitit 1992, edhe nëse do të ishte provuar (apo prezumuar për shkak*

të aplikimit të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016) shuma e të ardhurave të përfituara si avokat, bashkëshorti i subjektit në këtë periudhë duhet të ishte regjistruar në organet tatimore dhe të paguante detyrimet tatimore përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, për rrjedhojë, pretendimet e tij nuk mund të vlerësohen të pranueshme për shkak të kohëzgjatjes, për sa kohë të dhënat tatimore, nëse do të ishin paguar, do të rezultonin aktualisht të evidentueshme.

13.8 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të drejtuar nga Komisioni, si dhe pasi iu njoftua nëpërmjet rezultateve të hetimit, se të ardhurat e pretenduara nga avokatia në periudhën 1990-1992, mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si burim në analizën e pasurisë, ka sqaruar se: *Me miratimin e ligjit nr. 7382, dt.08.05.1990, "Për avokatinë në RPSSH", pedagogëve të brendshëm të Fakultetit të Drejtësisë u njihej e drejta e ushtrimit të profesionit të avokatit. Unë kam provuar me dokumente se: 1. Ligji nr. 7382, datë 08.05.1990, "Për avokatinë në RPSSH", lejonte pedagogët e brendshëm të Fakultetit të Drejtësisë të ushtronin profesionin e avokatit.*

2. Bashkëshorti im ka qenë pedagog i brendshëm i Fakultetit të Drejtësisë.

*3. Ka vendime gjyqësore të cilat provojnë qenien e bashkëshortit tim avokat gjatë atyre viteve. Unë kam mundur të gjej deri më sot një vendim civil, nr. {***}, datë 25.03.1992, me palë paditës/kundërpaditur G. N. dhe të paditur/kundrapaditës A. L. etj. [...] Ligji për "Tatimin mbi të ardhurat" është miratuar në fund të vitit 1992 dhe është bërë efektiv gjatë vitit 1993. Në vitet 1990-1992 nuk ka pasur ligj për tatimin e të ardhurave. Për rrjedhojë, bashkëshorti im nuk kishte gfarë tatimi të paguante sepse nuk ekzistonte një detyrim ligjor i tillë. Të ardhurat nga ky aktivitet janë deklaruar edhe në deklarinimin për herë të parë në vitin 2003.*

13.9 Subjekti i rivlerësimit bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 3 ka dorëzuar në Komision dy deklarata noteriale, ku sipas deklaratës⁴ së z. R. H. sqarohet se me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit ka bashkëpunuar në shumë çështje civile dhe penale, ndër të cilat ishte edhe një çështje birësimi për të cilën bashkërisht janë paguar në vlerën 3.000 dollarë, duke përfituar nga 1.500 dollarë secili. Gjithashtu, sipas deklaratës⁵ noteriale të z. M. D., sqarohet se sapo është miratuar ligji për avokatinë, bashkë me 30 avokatë të tjerë ka ushtruar këtë profesion që nga nëntori i vitit 1990, si dhe me z. S. i cili ishte pedagog i brendshëm në Fakultetin e Drejtësisë dhe ligji ia mundësonte një gjë të tillë. Për shkak se numri i avokatëve ishte i kufizuar, deklaruesi sqaron se çdo muaj përfitonin pagesa jo më pak se 200.000 lekë nga ushtrimi i këtij profesioni.

13.10 Subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision me prapësimet mbi rezultatet e hetimit deklaratën⁶ noteriale të z. E. B., i cili sqaron se bashkëshorti i subjektit ka qenë avokat gjatë fazës së hetimit në çështjen penale të ngritur ndaj babait të tij në periudhën 1991-1992. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi gjithashtu shkresë⁷ të kryetarit të Gjykatës Tiranë, drejtuar bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, sipas së cilës sqarohet se, bazuar në verifikimin e kryer në arkivin penal

⁴ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 28.07.2020.

⁵ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 28.07.2020.

⁶ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 28.07.2020.

⁷ Shkresë nr. {***} prot., datë.18.06.2021, e kryetarit të Gjykatës Tiranë.

dhe civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën nga viti 1990-1992, kanë mundur të gjejnë vetëm vendimin civil nr. {***}, datë 25.03.1992, ku bashkëshorti i subjektit është një nga avokatët e palëve.

Pas prapësimeve të rezultateve të hetimit, si dhe dorëzimit të dokumentacionit provues nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konsideruar të ardhura të bashkëshortit të subjektit për periudhën 1990-1992 vetëm shumën 300.000 lekë, duke mos i konsideruar asnjë të ardhur me këtë burim për vitin 1992 deri në muajin qershor.

13.11 Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konsideroi parashikimet e legjislacionit të kohës që legjitimoi pas një periudhe të gjatë kohe ndalese, ushtrimin e avokatisë si një profesion i lirë. Nga verifikimi i legjislacionit të kohës, rezultoi se ligji nr. 7544, datë 06.01.1992, “Për tatimin mbi fitimin”, i cili përcakton detyrimet tatimore për personat fizikë e juridikë, ka hyrë në fuqi sipas nenit 17 të po këtij ligji, më datë 01.01.1992, ndërkohë që, referuar informacionit të Qendrës së Botimeve Zyrtare⁸, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 1, më datë 10.05.1992. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se sipas vërtetimit të Institucionit të Presidentit të Republikës me nr. {***} prot., datë 26.10.2016, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga paga pranë këtij institucioni që nga muaji qershor 1992 deri në muajin prill 2002. Pra, sipas këtij dokumentacioni, ligji i kohës për tatimin mbi fitimin është botuar në Fletoren Zyrtare në maj të vitit 1992, ndërkohë që bashkëshorti i subjektit ka përfituar të ardhura nga avokatia deri në qershor të këtij viti, periudhë për të cilën Komisioni ka konkluduar që duhet të ishin paguar detyrimet tatimore, duke mos i përfshirë të ardhurat nga avokatia për 6-mujorin e parë të vitit 1992, në masën 300.000 lekë. Si rrjedhojë e sa më sipër, konkluzioni i Komisionit se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit duhet të kishte paguar detyrime tatimore në 6-mujorin e parë të vitit 1992, periudhë gjatë së cilës nuk kishte hyrë ende në fuqi legjislacioni që detyronte pagimin e tyre, nuk gjendet i bazuar në ligj.

13.12 Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues e analizoi pretendimin e subjektit edhe në këndvështrim të parashikimeve të ligjit nr. 7382, datë 08.05.1990, “Për avokatinë në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Në dispozitat e këtij ligji, nuk parashikohet shprehimisht se lejohen pedagogët e brendshëm të Fakultetit të Drejtësisë të ushtronin profesionin e avokatit. Në nenin 5 të tij parashikohet se: *Pranohen si anëtarë të kolegjeve të avokatëve, shtetasit që kanë arsimin e lartë juridik dhe një vjetërsi pune si juristë jo më pak se 3 vjet. Përjashtimet për rregullin e vjetërsisë së punës si jurist bëhen nga ministri i Drejtësisë.* Sipas këtij parashikimi, lejohen të punojnë si avokatë, juristët që kanë jo më pak se 3 vite punë, por dhe në një interpretim të zgjeruar të dispozitës, duke barazuar pozicionin e juristit me atë të pedagogut të brendshëm të Fakultetit të Drejtësisë, sërish nuk gjendet parashikimi eksplicit për këta të fundit, siç pretendon subjekti në prapësimet e rezultateve të hetimit. Gjithashtu, në nenin 13 të këtij ligji parashikohet se: *Ndihma juridike jepet kundrejt pagesës në bazë të tarifave të caktuara nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe arkëtohet për llogari të kolegjeve. Në raste të veçanta, të parashikuara në rregulloren e avokatisë, ndihma juridike mund të jepet falas. Mënyra*

⁸ <https://qbz.gov.al/eli/ligji/1992/01/06/7544>

e ndarjes së të ardhurave caktohet me rregullore të ministrit të Drejtësisë. Avokatët gëzojnë të drejtën e sigurimeve shoqërore shtetërore. Sipas këtij parashikimi, në periudhën në fjalë, duket se avokatia ka funksionuar si pjesë e institucioneve shtetërore, ku dhe tarifat të cilat përcaktoheshin nga dy ministritë, arkëtoheshin për llogari të kolegjeve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë kontekst, avokatia, ndonëse njihej si institut, nuk ushtrohej ende si profesion privat, nga i cili siguroheshin të ardhura të realizuara nga mbrojtja e palëve, por sipas nenit 1 të këtij ligji ishte si angazhim/detyrë e institucioneve për t'u dhënë ndihmë juridike shtetasve shqiptarë a të huaj, institucioneve, ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, si dhe personave juridikë të huaj. Në mbështetje të këtij parashikimi, për periudhën e pretenduar se bashkëshorti ka ushtruar avokatinë, 1990 - 1992, duket se ky aktivitet ushtrohej nën ombrellën rregullatore të Ministrisë së Drejtësisë, brenda së cilës ishin ngritur Kolegjet e Avokatisë të paktën deri në miratimin e ligjit nr. 7512/1991, si në vijim arsyetuar. Ky rregullim duket se nuk siguron mundësinë e krijimit të të ardhurave si prej një aktiviteti privat të bashkëshortit, në mënyrën e ekspozuar nga subjekti i rivlerësimit.

13.13 Përveç sa më sipër, lidhur me sasinë e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga avokatia (600.000 lekë), nga dokumentacioni i administruar në dosje, subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, nuk provoi me dokumentacion që bashkëshorti i saj e ka realizuar këtë shumë. Në deklaratën fillestare të pasurisë, në vitin 2003, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në rubrikën “Të ardhura personale nga paga [...]” ka deklaruar “*cash* 1990-1992”, por pa përcaktuar shumën e përfituar. Gjithashtu, referuar deklaratave noteriale të cituara më sipër nga kolegë avokatë të bashkëshortit të subjektit, nuk provohet sasia e përfituar, përpos faktit që këto deklarime janë kryer gjatë dhe në funksion të procesit të rivlerësimit në Komision, duke pasur një vlerë provuese të kufizuar, për shkak se nuk janë përpiluar në kohën reale të krijimit të këtyre të ardhurave. Nga ana tjetër, duke vlerësuar informacionin historik për ekonominë e viteve ‘90 në Shqipëri, duket i pabesueshëm fakti i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, që të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit nga bashkëshorti, të jenë realizuar në shumën prej 600.000 lekësh, për një periudhë 8-mujore. Në këto kushte, pavarësisht se gjendemi në situatën e mësipërme, trupi gjykues, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, vlerëson të konfirmojë qëndrimin e Komisionit, i cili ka konsideruar të ardhura të ligjshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1990-1992, shumën 300.000 lekë.

13.14 *Sa u përket kursimeve nga pagesat për udhëtimet jashtë shtetit të bashkëshortit të subjektit në vitet 1992-1997*, Komisioni ka konkluduar: *Lidhur me kursimet e pretenduara nga udhëtimet e bashkëshortit në Evropë dhe ShBA, fillimisht vërehet se përgjithësisht dietat janë vlera monetare të përfituara për mbulimin e shpenzimeve dhe nuk mund të konsiderohen si të ardhura/kursime, me përjashtim të rasteve kur provohet e kundërta. Në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se, nisur nga: (i) dokumentacioni i paraqitur nga subjekti (deklaratë noteriale; kërkesë për të dëgjuar një dëshmitar mbi këtë rrethanë; dokument mbi mospasje detyrimi për deklarime në doganë të të hollave të pretenduara si të sjella në Shqipëri); (ii) argumentimi i dhënë në prapësime dhe në seancë dëgjimore mbi situatën ekonomiko-shoqërore asokohe në Shqipëri; të ndërthurura me (iii) faktin që ky burim është deklaruar nga subjekti prej vitit 2003, si dhe në deklaratën vetting; dhe*

duke mbajtur në konsideratë (iv) kohën e largët dhe pamundësinë objektive për të provuar pretendimin, ndonëse kursimi dhe transferimi i shumës së pretenduar dhe disponimi/përdorimi i saj në Shqipëri nuk është provuar plotësisht – ky burim mund të konsiderohet në analizën financiare për periudhën përkatëse.

13.15 Në pyetësonin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit t'i vejë në dispozicion dokumentacionin ligjor që provon të ardhurat e realizuara prej bashkëshortit nga udhëtimet jashtë shtetit, dhe në përgjigje subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme, por ka qenë e pamundur marrja e një përgjigjeje nga Këshilli i Evropës për konfirmimin e pjesëmarrjes dhe pagesat e kryera, me arsyetimin se, sipas rregullave të Këshillit të Evropës, dokumentacioni që kërkohet, ruhet jo më shumë se 10 vjet.

13.16 Bashkë me përgjigjet e pyetësonit nr. 3, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision vërtetim nr. {***}, datë 23.6.2020, nga Këshilli i Evropës, në të cilin është sqaruar se nuk mund të ofrojnë një vërtetim mbi honorarët e përfituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 – 2002, për shkak se rregulloret e tyre financiare kërkojnë ruajtjen e informacionit deri në 10 vite⁹. Subjekti dorëzoi gjithashtu vërtetim nr. {***} prot., datë 21.02.2019, nga Institucioni i Presidentit të Republikës mbi të ardhurat në valutë të përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për shërbimet jashtë vendit për periudhën 1994 – 2001. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.06.2020, nga z. A. H., i cili ka deklaruar se në maj të vitit 1993, së bashku me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për shkak të detyrës, zhvilluan një vizitë¹⁰ 1-mujore në ShBA, për të cilën kanë marrë një shumë prej 5.100 USD për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit. Deklaruesi sqaron se nga ky udhëtim, secili u kthye me kursime mbi 3.000 USD dhe se z. S. ishte kthyer me 3.500 USD. Gjithashtu subjekti dorëzoi edhe deklaratë noteriale të z. K. T. nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.06.2020, i cili është shprehur se në maj të vitit 1993, së bashku me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, zhvilluan një vizitë 1-mujore për t'u njohur me sistemin e drejtësisë në ShBA, ku kanë marrë një shumë prej 5.000 USD dhe se ai personalisht kishte kursyer më shumë se gjysmën e kësaj shume.

13.17 Lidhur me sa më sipër, Komisioni konkludoi në rezultatet e hetimit se nuk mund të konsiderohen si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale ku ata kanë qenë pjesëmarrës. Rrjedhimisht, dietat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në udhëtimet e tij në ShBA apo edhe nga Këshilli i Evropës, edhe nëse do të provohej shuma e saktë dhe përfitimi i tyre, nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare si të ardhura.

⁹ *Bashkëlidhur shkresës në gjuhën angleze (përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar), Këshilli i Evropës ka vendosur një tabelë me historikun e pagesave të kryera, të ekspertëve që udhëtonin me shpenzimet e buxhetit të Këshillit të Evropës.*

¹⁰ *Subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion edhe Programin Ndërkombëtar të Vizitorëve, të zhvilluar në periudhën 22 maj 1993 – 22 qershor 1993, për sistemin e drejtësisë të ShBA-së, së bashku me listën e pjesëmarrësve, ndër të cilët janë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe deklaruesit e mësipërm A. H. dhe K. T.*

13.18 Në lidhje me barrën e provës së kaluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit për pagesat nga udhëtimet jashtë shtetit, pretendoi se ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të pamundësisë objektive për të disponuar dokumentacionin e mësipërm, për arsye se institucionet përkatëse nuk i kanë të ruajtura për periudha më të largëta se 10 vjet.

Subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision një deklaratë noteriale të përpiluar në ShBA, e datës 14.06.2021, nga z. A. Sh., i cili është shprehur se në vitin 1993 është marrë me organizimin dhe shoqërimin e një grupi juristësh, mes të cilëve edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Deklaruesi sqaron se anëtarëve të delegacionit u është dhënë *cash* apo me çeqe shuma prej 5000 apo 5200 dollarësh për të mbuluar shpenzimet e hotelit dhe të ushqimit, ndërsa për shpenzimet e tjera, përfshirë ato të lëvizjes jashtë shtetit, janë përballuar nga organizatorët. Anëtarët e delegacionit kanë mundur të zgjedhin vetë hotelin, duke u organizuar edhe nga 3-4 veta në një dhomë për të mos shpenzuar. Në fund të vizitës, anëtarët kanë këmbyer çeqet në USD dhe z. S. ka këmbyer ditën e fundit, shumën prej 3.500 USD.

13.19 Pas reflektimit të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit, Komisioni, në vendim ka konkluduar se për kursimet e pretenduara nga udhëtimet e bashkëshortit në Evropë dhe ShBA, megjithëse nuk u provua disponimi/përdorimi i tyre në Shqipëri, ky burim mund të konsiderohet në analizën financiare për periudhën përkatëse, dhe në analizën financiare të Komisionit është përfshirë si e ardhur shuma 3.500 dollarë. Kolegji në jurisprudencën e tij¹¹ ka vlerësuar se të ardhurat e deklaruara nga subjektet e rivlerësimit si të përfituara në formën e dietës, janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e kursimeve. Pavarësisht qëndrimit të mësipërm, në analizë të situatës faktike që përcakton përftimin e tyre, nga dokumentacioni që ka dorëzuar (*Programin Ndërkombëtar të Vizitorëve, të zhvilluar në periudhën 22 maj 1993 – 22 qershor 1993, për sistemin e drejtësisë të ShBA-së*) subjekti i rivlerësimit në Komision, vërehet se natyra e aktivitetit për të cilin delegacioni i zyrtarëve shqiptarë kanë shkuar në ShBA, lidhet me trajnimin e tyre dhe konsultimin me mënyrën se si legjislacioni i një shteti demokratik funksionon. Pavarësisht programit të kësaj vizite për të cilën është akorduar dieta, e cila duket se e nxjerr këtë aktivitet dhe të ardhurat e paguara përgjatë zhvillimit të tij, nga natyra e aktiviteteve për të cilat Kolegji ka mbajtur qëndrimet e mësipërme, si edhe të ardhurën nga koncepti i një diete që siguron vetëm shpenzimet që do të kryheshin për nevojat e qëndrimit në atë vend, sërish subjekti nuk arriti të provonte përftimin e të ardhurave në formën e dietave për t'i dhënë mundësinë më pas trupit gjykues të vlerësonte peshën e saj në analizën financiare. Në këto kushte, trupi gjykues konfirmoi vlerën e pranuar si të ardhur prej Komisionit në zbatim të parimit *no reformatio in peius*.

13.20 Gjithashtu trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor se i ka kryer udhëtimet e pretenduara pranë Këshillit të Evropës, por solli dokumentacion vetëm për rregullat e miratuara për pagesat që Këshilli i Evropës kishte vendosur për ekspertët që udhëtonin me shpenzimet e buxhetit të tij. Në këto kushte, nuk i mundësoi Kolegjit kryerjen e përlllogaritjeve për të ardhurat e përfituara nga udhëtimet, si dhe mundësinë e kursimit të këtyre të

¹¹ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019.

ardhurave. Në vlerësim të sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka kryer 18 udhëtime dhe ka krijuar kursime nga të ardhurat e përfituara prej tyre, mbeti në nivel deklarativ.

13.21 Lidhur me pagesat e siguruara nga bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë gjatë periudhës 1992-1997, Komisioni ka konsideruar si të ardhura të ligjshme të përfituara nga mësimdhënia e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumë prej 89.044 lekësh, për periudhën 1992-1997, të përlogaritur nga kancelari i Fakultetit të Ekonomisë, në cilësinë e një konsulenti të posaçëm për subjektin dhe jo në cilësinë e tij si zyrtar.

13.22 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni duhet të konsideronte në të ardhurat nga mësimdhënia shumë 100.000 lekë, dhe jo 89.044 lekë sipas konkluzionit të Komisionit, duke qenë se subjekti ka bërë çdo përpjekje për të gjetur informacion, por ndodhet në kushtet e pamundësisë për të plotësuar kërkesën e ligjit. Subjekti pretendoi se sipas vërtetimit me nr. {***} prot., datë 27.05.2020, të Fakultetit të Drejtësisë, në të cilin specifikohet se për periudhën korrik 1992 - dhjetor 1997 nuk rezultojnë të dhëna për pagesat e pedagogëve të jashtëm, ai legjitimohet të përcaktojë në mënyrë alternative të ardhurat e krijuara. Në këtë kuptim, ai ka dorëzuar në Komision vërtetimin e Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, me nr. {***} prot., datë 27.05.2020, në të cilin sqarohet se për periudhën dhjetor 1991 - qershor 1992, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfitur shumë prej 7.470 lekësh si asistent pedagog. Gjithashtu dorëzoi shkresën me nr. {***} prot., datë 27.05.2020, të Fakultetit të Shkencave Sociale, në të cilën specifikohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfitur për periudhën nëntor 1990 - prill 1991, shumë prej 4.080 lekësh. Në mbështetje të pretendimeve të saj për të ardhurat e krijuara, gjithashtu dorëzoi në Komision edhe komunikimin elektronik të bashkëshortit të saj me kancelarin e Fakultetit të Ekonomisë, i cili ka kryer një përlogaritje të përafërt të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si pedagog i jashtëm, bazuar në numrin e studentëve pjesëmarrës në provime dhe akteve nënligjore, duke nxjerrë se rezultati për periudhën 1992-1997, ka qenë në shumë 89.044 lekë.

13.23 Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vërehet se përlogaritja e kryer nga kancelari i Fakultetit të Ekonomisë, cituar në paragrafin më sipër, është bazuar në aktet ligjore të kohës që përcaktonin vlerat e pagesave të pedagogëve për orë leksioni dhe seminari në raport me numrin e studentëve që kanë hyrë në provim çdo vit akademik. Nga kjo përlogaritje ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit mund të ketë përfitur si pagesë rreth 89.044 lekë të ardhura nga mësimdhënia gjatë periudhës 1992-1997. Duke qenë se nuk ka të dhëna të tjera për të cilat të vërtetohet sasia e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga mësimdhënia, nga kontrolli që ushtroi Kolegji në analizën financiare të kryer në Komision për periudhën 1986-1995, e gjeti të drejtë vendosjen si të ardhur të shumë prej 89.044 lekësh, sipas dokumentit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit.

13.24 Lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit, Komisioni ka konkluduar se: *Për sa u përket të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në Fier, të pretenduara si të marra/disponuara në vitin 1995, ndërkohë që kontrata e shitblerjes është nënshkruar në vitin 1998, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit jo vetëm që nuk provohet,*

pasi deklaratat e mëpasshme nuk mund të zhbëjnë çka është shprehur përpara noterit në një kontratë shitblerjeje e cila është regjistruar dhe i ka prodhuar efektet e saj reale në vitin 1998. Përmbajtja e kësaj të fundit prevalon mbi çdo deklaram apo pretendim ndryshe, për sa kohë nuk është cituar asgjë lidhur me pagesën e çmimit tri vite me herët. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk provohet pretendimi i subjektit mbi përfitimin/disponimin në një kohë më të hershme (në vitin 1995) të të ardhurave nga shitja në vitin 1998.

13.25 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, siç është referuar edhe në paragrafin 13.5 më sipër, rezultoi se apartamenti me sip. 81,4 m² është blerë me anë të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 30.04.1995, të lidhur ndërmjet Degës së Entit Kombëtar të Banesave, Tiranë dhe blerësit Th. S., kundrejt çmimit të blerjes 1.126.389 lekë. Komisioni konstatoi se të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier, të pretenduara si të disponuara në vitin 1995, për të cilin është nënshkruar kontrata e shitjes në vitin 1998, nuk janë deklaruar nga subjekti të përdorura si burim për blerjen e këtij apartamenti as në DIPP-në e vitit 2003 dhe as në deklaratën *vetting*. Për më tepër, subjekti e ka deklaruar këtë të ardhur si burim për blerjen e një apartamenti tjetër në vitin 2003, në lagjen “{***}”, Fier.

13.26 Me kontratën noteriale nr. {***} regj., dhe nr. {***} kol., datë 07.01.1998, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur apartamentin e ndodhur në Fier, për çmimin 1.100.000 lekë. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3 lidhur me burimin që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 81,4 m² të ndodhur në Tiranë, në përgjigje të të cilit subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se: *Siç kam deklaruar edhe për herë të parë, në vitin 1995 familja ime ka shitur një apartament në Fier, në shumën 1,1 milionë lekë, të fituar në bazë të ligjit "Për privatizimin e banesave". Privatizimi i këtij apartamenti është bërë në vlerën 2.561 lekë. Këtë apartament ia kemi shitur zotit S. D., i cili na ka dhënë cash në dorë vlerën e shitjes prej 1,1 milionë lekësh ditën e dorëzimit të apartamentit, në fillim të vitit 1995, ndërsa kontratën e shitblerjes e kemi bërë më vonë, në janar 1998. Kjo mospërputhje ka të bëjë me faktin që blerësi kishte disa probleme financiare, borxhe, te personat e tretë, dhe nuk donte ta regjistronte në hipotekë, nga frika se mos borxhlinjtë ia sekuestronin.*

13.27 Subjekti i rivlerësimit dorëzoi me pyetësorin nr. 3, kontratën e shitjes së këtij apartamenti, si dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.06.2020, hartuar nga blerësi i apartamentit S. D., i cili ka deklaruar se në vitin 1995 ka blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, apartamentin e ndodhur në Fier, kundrejt çmimit 1.100.000 lekë, pagesë të cilën e ka kryer *cash*. Ai ka shtuar gjithashtu se për shkak të problemeve të tij, akti noterial i shitjes është kryer në vitin 1998. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke konstatuar se: *Duket se deklaramet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3, janë kontradiktore krahasuar me deklaramet e saj në deklaratën vetting, sa i përket disponimit në një kohë më të hershme (1995) të të ardhurave nga shitja e apartamentit në vitin 1998. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit sqaroi se: “Referuar vetë kontratës së shitjes nr. {***} regj., nr. {***} kol., datë 07.01.1998, të apartamentit në Fier, në lagjen “{***}”, citohet se: Banesën së bashku me truallin e saj ne ia kemi shitur zotit S. D., në shumën 1.100.000 (një milion e njëqind mijë lekë). Këtë shumë e kemi marrë të gjithë jashtë kësaj zyre dhe i kemi liruar atij banesën dhe*

truallin e saj. Ka qenë pikërisht ky moment që na ka sjellë në kujtesë faktin se vlera e shitjes së këtij apartamenti na është dhënë shumë më parë sesa momenti në të cilin është realizuar kontrata e shitjes faktikisht. Arsyet pse ka ndodhur kjo situatë janë sqaruar dhe deklaruar nga vetë blerësi në deklaratën e tij noteriale, e cila ju është vënë në dispozicion. Konkretisht, kjo ka ndodhur pasi blerësi S. D., në vitin 1995 kishte probleme financiare me persona të tretë dhe realizimi i kontratës në këtë moment do t'i shkaktonte atij bllokimin e kësaj pasurie [...]"

13.28 Lidhur me sa u parashtrua më sipër, rezultoi e provuar se nëpërmjet kontratës së shitjes së datës 07.01.1998, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur apartamentin në Fier, të fituar nëpërmjet ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore". Këtë të ardhur nuk e ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003 e as në deklaratën *vetting* se ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 81,4 m² në Tiranë, por vetëm gjatë hetimit administrativ sjell në vëmendje që shuma e përfituar nga shitja e apartamentit në Fier është marrë në vitin 1995 dhe ka shërbyer për financimin e pasurisë objekt kontrolli. Përveç kontratës së shitjes së apartamentit, subjekti ka dorëzuar edhe deklaratën noteriale të blerësit, dokument i cili është hartuar dhe dorëzuar gjatë procesit të rivlerësimit, i pambështetur nga prova të tjera, si dhe duke konsideruar edhe kohën e përpilimit, nuk mund të prevalojë për nga fuqia provuese mbi vlerën provuese të kontratës së shitjes së apartamentit, e cila dokumenton si moment shitjeje vitin 1998. Si rrjedhojë e këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se shumën e përfituar nga shitja e apartamentit në Fier e ka marrë në vitin 1995, tri vite para lidhjes së kontratës së shitblerjes, mbeti në nivel deklarativ, si pasojë konsideroi të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos e përllogaritur si të ardhur në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit të vitit 1995, atë të krijuar nga shitja e kësaj pasurie në vitin 1998.

13.29 *Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të përfituara nga shitja e garazhit në shumën 800.000 lekë*, në vitin 1997, Komisioni nuk i ka konsideruar këto të ardhura në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Fillimisht Komisioni e pyeti subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3, për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie e të shitjes së saj, si dhe e ftoi të paraqesë dokumentacionin përkatës. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit sqaroi se: "Garazhi i ndërtuar në rr. "{***}" ka qenë i ndërtuar në bazë të lejes provizore, miratuar nga KRRt e Bashkisë Tiranë, me vendim nr. {***}, datë 02.07.1996. Ndërtimi i këtij garazhi është bërë nga ana e një shoku të bashkëshortit, i quajtur L. M., i cili ishte duke ndërtuar një godinë private pranë Gardës së Republikës, aktualisht godina ku ndodhen zyrat e Bankës Tirana. Subjekti ka pretenduar se nuk është paguar asnjë lek për ndërtimin e këtij garazhi, për shkak të lidhjeve shoqërore që kishte bashkëshorti me zotin M., si dhe nisur nga fakti që ndërtimi u krye me mbetjet e materialeve nga ndërtimi i godinës pranë Gardës. Ky garazh u shit në kohën e trazirave të vitit 1997. Blerësi quhet F. T.. Nuk është bërë kontratë shitjeje noteriale për shkak se ndërtimi ishte provizor, i pahipotekuar, por kujtoj se është bërë vetëm një deklaratë me shkrim dore që provonte sa më sipër".

13.30 Me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision shkresën nr. {***} prot., datë 11.05.2020, të Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në të cilën është bashkëngjitur formulari nr. 5 (leje për ndërtime të përkohshme), planvendosja dhe vendimi i KRRt-

së me nr. {***}, datë 02.07.1996, për miratimin e lejes së ndërtimit të përkohshëm të një garazhi në rr. “{***}”, midis pallateve, në emër të z. Th. S.. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 27.05.2020, nga z. L. M., i cili ka deklaruar se në vitin 1996 ka ndihmuar bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, pasi në atë kohë deklaruesi ka ndërtuar një godinë afër Gardës së Republikës dhe me materialet që i kishin tepruar nga ndërtimi i një godine tjetër dhe punëtorët e tij, i ka ndërtuar një garazh provizor, ku për shkak të marrëdhënieve miqësore nuk i ka kërkuar asnjë pagesë. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.05.2020, nga z. F. T., i cili ka deklaruar se nga fundi i vitit 1996 fillimi i vitit 1997, ka blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit garazhin, kundrejt çmimit 800.000 lekë, të cilat janë paguar *cash*. Ai ka deklaruar se kanë bërë një deklaratë me shkrim dore për të, si dhe garazhi më pas është prishur dhe në atë sipërfaqe është ndërtuar qendra arabe “{***}”.

13.31 Në rezultatet e hetimit, Komisioni konstatoi se nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit, ndonëse është marrë leje ndërtimi për garazhin e pretenduar si më sipër, me aq sa disponohet, nuk ka rezultuar e provuar nisja apo përfundimi i punimeve të ndërtimit, si dhe nuk është paraqitur asnjë kontratë shitblerjeje që të provojë shitjen më pas të tij. Në këto kushte, të ardhurat e pretenduara nga subjekti, në shumën prej 800.000 lekësh, nga shitja e garazhit mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, nuk janë përfshirë në analizën financiare si të ardhura me burim të ligjshëm. Me përgjigjet e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi dokumentacion shtesë në Komision, por pretendoi se ka bërë të gjitha përpjekjet për të dokumentuar gjithçka që lidhet me provueshmërinë e të ardhurave nga shitja e garazhit, por për shkak të kohës shumë të largët, nuk ekzistojnë dokumente të tjera provuese, duke pretenduar se ndodhet në kushtet e parashikuara nga pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

13.32 Në analizë të rrethanave si më sipër përshkruar, rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit, pasurinë e pretenduar të shitur në vitin 1997, e ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003. Në rubrikën e të ardhurave ka deklaruar: *Shitje garazhi në vitin 1997, në vlerën 800.000 lekë, në rr. “{***}”, ndërtim provizor*. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar edhe pasuritë të cilat i ka pasur në pronësi më parë, një ndër të cilat është deklaruar edhe garazhi provizor, i cili është shitur në vitin 1997 për çmimin 800.000 lekë. Gjithashtu rezultoi e provuar se bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i është miratuar nga Bashkia Tiranë dhënia e sheshit për ndërtim, si dhe leja e përkohshme për ndërtimin e garazhit në vitin 1996. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, pavarësisht se është marrë një leje ndërtimi për garazhin e pretenduar si të shitur, nuk ka rezultuar e provuar ekzistenca e këtij ndërtimi, pra nëse është realizuar ky ndërtim apo jo, si dhe nuk është paraqitur asnjë dokument i llojit, faturë, kontratë shitblerjeje, foto ose çdo lloj tjetër gjurme që të provojë ekzistencën e tij dhe më pas transaksionin për shitjen e garazhit. Përveç deklaratave noteriale të ndërtuesit të garazhit dhe të blerësit të garazhit, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka dorëzuar gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, dhe duken se janë hartuar në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, nuk paraqiti dokumentacion tjetër provues për të provuar pretendimet e saj lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë/zotërimit mbi këtë objekt, duke mos provuar as se çfarë ka shërbyer si burim financiar

për ndërtimin e tij, ekzistencën e këtij ndërtimi dhe më pas shitjen e tij. Edhe në versionin që do të abstragohej nga elementet e mësipërme, të cilat subjekti nuk arriti t'i provojë, dhe të konsiderohej se shitja është kryer dhe të ardhurat janë krijuar sipas deklaramit, nuk rezulton që këto të ardhura të përmbushin standardet e së ardhurës së ligjshme sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Kolegji e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se të ardhurat e pretenduara në shumën prej 800.000 lekësh, të realizuara nga shitja e garazhit, mbeten në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit si të ardhura me burime financiare të ligjshme.

13.33 Në përfundim të analizës lidhur me shkakun e ankimit që u përket burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 81,4 m², të ndodhur në Tiranë, për sa u përket të ardhurave të përfituara nga dietat nga udhëtimet në ShBA dhe në Këshillin e Evropës, u përfshi në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit e njëjta shumë si ajo e vlerësuar nga Komisioni, duke qenë se pretendimet për vlerën e përfituar si dietë nga Këshilli i Evropës mbeten në nivel deklarativ. Lidhur me të ardhurat nga avokatia, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ketë përfituar të ardhura në shumën 600.000 lekë, duke i konsideruar në analizën financiare vetëm shumën 300.000 lekë, në masën e konkluduar edhe nga Komisioni. Lidhur me pagesat si pedagog i jashtëm të bashkëshortit, për periudhën 1992-1997, subjektit të rivlerësimit iu konsiderua si e ardhur shuma 89.044 lekë, e njëjtë me atë të konsideruar nga Komisioni. Të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 1998, për të cilat subjekti pretendoi se i ka përfituar në vitin 1995, nuk iu konsideruan sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit në analizën financiare, por sipas kontratës së shitjes me anë të së cilës provohet momenti i përfitimit të këtyre të ardhurave. Gjithashtu, sa u përket të ardhurave nga shitja e garazhit, subjekti i rivlerësimit nuk provoi ekzistencën e tij dhe as përfitimin e këtyre të ardhurave, e për pasojë nuk u konsideruan pretendimet e subjektit të rivlerësimit për to, për të cilat pretendoi se kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi. Sa më sipër, nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, dhe familja e saj nuk kishin mundësi që, me burime financiare të ligjshme, të përballonin shpenzimet dhe të krijonin pasurinë apartament banimi me sip. 81,4 m², për diferencën negative në shumën -285.381 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

13.34 Pavarësisht këtij konkluzioni, trupi gjykues e gjeti pa peshë përcaktuese këtë balancë negative në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit, duke konsideruar qoftë vlerën e ulët të saj, qoftë kohën e marrë në analizë dhe përgjithësisht situatat faktike të pranuar edhe prej Komisionit se subjekti është gjendur në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për disa nga të ardhurat e pretenduara se janë krijuar, përfshi ato nga dietat për udhëtimet jashtë shtetit, të cilat kanë shërbyer për financimin e kësaj pasurie krahas përballimit të shpenzimeve të tjera për pasuri e jetesë, të kryera në këtë periudhë.

14. ***Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 195 m² dhe garazh me sip. 22,2 m²***, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se marrëdhënia ndërmjet saj dhe babait nuk ka qenë marrëdhënie interesi e krijuar nga një marrëdhënie biznesi, dhurimi apo huaje e, për rrjedhojë, ai nuk mund të konsiderohet si person tjetër i lidhur apo person i lidhur në kuptim

të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se babai i subjektit kishte krijuar marrëdhënie juridike personale në mënyrë të pavarur nga subjekti me shoqërinë e ndërtimit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se prej babait të saj janë kryer pagesa të cilat janë përlllogaritur si pjesë përbërëse e çmimit total të pasurive të përfituara nga subjekti dhe duhet të analizohen burimet e tij financiare. Subjekti pretendon se kjo marrëdhënie nuk është dhurim, as hua, por një marrëdhënie atipike që bazohet në parimet e përgjithshme të kontratave të lejuara nga Kodi Civil. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që, bazuar edhe në qëndrimet e tij, të mos kategorizojë babain e saj në grupin e personave të lidhur apo personave të tjerë të lidhur sipas ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu pretendon se edhe nëse babai i saj do të konsiderohet si person tjetër i lidhur, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, rezulton se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar pagesën e shumës prej 25.000 USD në vitin 2001. Subjekti pretendon se edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, ka arritur të provojë nëpërmjet dokumenteve se babai ka pasur një aktivitet tregtar dhe ka gjeneruar të ardhura. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, pretendon se ajo ka vërtetuar edhe me anë të provës shkresore se babai i saj ka pasur një marrëdhënie huaje me shtetasin V. K. për shumën 25.000 USD, çka i ka mundësuar atij pagesën pranë firmës së ndërtimit, por Komisioni nuk e ka konsideruar këtë huadhënie në analizën e tij, duke e paragjykuar situatën se ky dokument është paraqitur me vonesë, edhe pse sipas ligjit paraqitja e provave mund të bëhet në çdo fazë të procesit administrativ dhe se nuk ka pengesë që ato të paraqiten edhe në seancën dëgjimore. Në përfundim të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri financiare për subjektin, në shumën -189.091 lekë dhe për parapagimin nga babai i saj në shumën 3.426.000 lekë dhe kërkon nga Kolegji të konsiderojë (i) kohën e largët të kaluar për të verifikuar të ardhurat e babait të saj; (ii) faktin se subjekti i rivlerësimit e ka pasur të vështirë të sigurojë dokumentacion për të ardhurat e prindërve të saj, duke qenë se ka jetuar larg tyre; (iii) faktin se legjislacioni i kohës ishte në hapat e tij të parë drejt ekonomisë së tregut; (iv) faktin se babai i subjektit nuk u është shmangur me dashje detyrimeve tatimore dhe se fitimi i krijuar prej tij nuk ka pasur lidhje me subjektin e rivlerësimit; dhe (v) faktin se ekzistojnë prova për aktivitetin tregtar dhe fluksin e të ardhurave të familjes. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mundësi financiare për të krijuar këtë pasuri.

14.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: *Nisur nga analizat, argumentet dhe qëndrimet e lartpërshkruara, duke rishikuar analizën financiare, ndryshe nga sa ishte përcjellë me rezultatet e hetimit, përfundimisht lidhur me shpenzimet për këtë pasuri, subjekti do të kishte një mjaftueshmëri të burimeve për kryerjen e pagesës së këstit të parë prej 15.000 USD në vitin 2001 (në vend të 2.262.174 lekëve). Gjithashtu, për pagesën e kryer në vitin 2002, është i provuar burimi i ligjshëm nga kredia bankare. Ndërsa në vitin 2003 nuk do të rezultonte më ndonjë pagesë e kryer (për rrjedhojë as mungesë e burimeve), ndërkohë që për vitin 2005, do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në shumën prej 189.091 lekësh (në vend të 1.649.291 lekëve të përlllogaritura përgjatë hetimit administrativ), si pasojë e uljes së shumës së paguar në këtë vit, nga 2.160.000 lekë në 700.400 lekë, dhe për shkak të përfshirjes/konsiderimit si disponibilitet i të ardhurave nga shitja e banesës, në vlerën 1.100.000 lekë (në vend të 550.000 lekëve që ishte përlllogaritur më herët, me burim nga shitja e apartamentit në Fier, trajtuar në pikën në vijim).*

Për rrjedhojë dhe në konkluzion, pamjaftueshmëria e burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, bazuar në analizën financiare të rishikuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar në total në vlerën negative prej 189.091 lekësh nga subjekti i rivlerësimit dhe prej 3.426.000 lekësh për pagimin e shumës prej 25.000 USD nga babai i subjektit.

14.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, si burim krijimi të këtyre pasurive, ka deklaruar:

i. shuma prej 2.500.000 lekësh nga kredia e marrë në Bankën e Kursimeve dhe e paguar në Bankën Raiffeisen;

ii. shuma prej 30.000 eurosh, e cila ishte paguar/dhënë nga babai i subjektit, z. T. Ç., si kapar (pagesë paraprake) për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas kontratës premtim shitjeje nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 29.12.2005, dhe kontratës së shitjes me rezervë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.01.2006;

iii. të ardhurat nga pagat, kursimet nga dietat, shërbimet dhe udhëtimet jashtë shtetit [pa përcaktuar vlerë];

iv. shuma prej 11.500.000 dhrahmish greke, përfituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si këshilltar i jashtëm i Bankës Tirana në vitet 1996 - 2001.

14.3 Subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003, ka deklaruar një huadhënie në vlerën 60.000 USD me shoqërinë e ndërtimit “{***}” ShPK, dhe se ka porositur në vitin 2001, ndërtimin prej kësaj shoqërie të një apartamenti 3+1, duke përcaktuar si burim krijimi të ardhurat nga kredia pranë Bankës së Kursimeve në vlerën 25.000 USD, si dhe të ardhurat familjare në vlerën prej 35.000 USD.

14.4 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se dy apartamentet, të cilat janë bashkuar dhe regjistruar në një pasuri të vetme me sip. 195 m², janë përfituar nëpërmjet (i) kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.04.2005, për blerjen e apartamentit me sip. 135 m², në shumën 5.500.000 lekë; (ii) kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.04.2005, për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², në shumën 2.707.000 lekë; dhe (iii) kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.04.2005, për blerjen e garazhit me sip. 22,2 m², në shumën 475.000 lekë. Sipas parashikimeve të këtyre kontratave, çmimet e përcaktuara për blerjen e këtyre pasurive, janë likuiduar tërësisht pa asnjë diferencë jashtë zyrës noteriale.

14.5 Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me huadhënien prej 60.000 USD nga shoqëria “{***}” ShPK, të paraqesë dokumentacionin përkatës që provon dhënien e huasë dhe kthimin e saj te shoqëria, si dhe të japë shpjegime mbi mënyrën dhe kohën e kryerjes së pagesave për pasuritë e sipërcituara. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Nuk ka pasur ndonjëherë kontratë huaje për shumën 60 mijë USD ndërmjet z. S. K. dhe z. Th. S.. Pavarësisht nga përshkrimi si "huadhënie" në deklaratën e pasurisë për herë të parë në vitin 2003, kjo shumë përfaqëson pagesat e kryera nga bashkëshorti im dhe pjesërisht nga babai im T. Ç. deri në vitin 2003, për sipërfaqet e porositura te S. K.. Pagesat për sipërfaqet e porositura janë bërë me para në dorë, cash. Pagesa e parë prej 10 mijë dollarësh, e babait tim T. Ç., është bërë deri në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë*

*nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2001, fakt që vërtetohet edhe nga përmbajtja e kësaj kontrate. PAGESA e parë, e bërë nga bashkëshorti im, është bërë më datë 31.07.2001, në shumën 15.000 dollarë amerikanë, çka e provojmë me një vërtetim me shkrim dore të lëshuar nga S. K. dhe që rastësisht na kishte mbetur mes dokumenteve të shtëpisë. Data dhe koha e pagesave të tjera nuk dihet me saktësi, por deri më datë 31.12.2003, është e sigurt që janë paguar gjithsej 60 mijë dollarë amerikanë.*

14.6 Bashkëlidhur këtij pyetësori, subjekti i rivlerësimit, përveç kontratave të shitblerjes së këtyre pasurive të cituara në paragrafin 14.4 më sipër, ka dorëzuar:

(i) Kontratën e porosisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2001, të lidhur ndërmjet babait të subjektit, z. T. Ç., dhe sipërmarrësit, z. S. K., për porositjen e apartamentit me sipërfaqe 115 m², në vlerën 50.600 USD. Sipas kësaj kontrate, 10.000 USD janë paguar nga z. T. Ç. jashtë zyrës noteriale, duke parashikuar edhe planin e pagesave për pjesën e mbetur.

(ii) Kontratën e porosisë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.07.2001, sipas së cilës, bashkëshorti i saj ka porositur ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 93 m² kundrejt çmimit prej 40.900 USD.

(iii) Kontratën për premtim shitje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.12.2005, të lidhur ndërmjet premtuesit shitës Th. S. dhe blerësit T. Ç., i cili, sipas kësaj kontrate, ka paguar vlerën prej 30.000 eurosh nga çmimi total prej 80.000 eurosh për blerjen e apartamentit me nr. pasurie {***}, në {***}, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë. Sipas kësaj kontrate, shitja do të duhet të kryhej brenda vitit 2006 dhe nëse kjo nuk ndodh, “palët kthehen në gjendjen e mëparshme”.

(iv) Kontratën e shitjes me rezervë, mes po të njëjtave palë nënshkruese e për të njëjtin objekt, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.01.2006, sipas së cilës palët kanë rënë dakord që çmimi i apartamentit është 80.000 euro, ndërsa blerësi ka likuiduar shumën 30.000 euro jashtë zyrës noteriale, duke mbetur pa likuiduar edhe shumën prej 50.000 eurosh, që do të shlyhej brenda vitit 2006. Sipas kësaj kontrate, në rast të mosshlyerjes së shumës së mbetur pa likuiduar, shitësi do të rifitojë pronësinë e apartamentit, ndërsa blerësit do i kthehet shumën e paguar.

(v) Subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.04.2005, nga z. T. Ç., ku ka deklaruar se heq dorë nga pretendimet për pronësinë mbi apartamentin e ndodhur në rr. “{***}”, që buron nga kontrata e porosisë së datës 21.07.2001 dhe është dakord që ky apartament të regjistrohet në emër të subjektit të rivlerësimit (vajzës së tij) dhe bashkëshortit të saj. Në këtë deklaratë, nuk rezulton të jetë dhënë informacion lidhur me vlerën e paguar për apartamentin në fjalë nga z. T. Ç., dhe as njohje të ndonjë detyrimi të mbartur nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

14.7 Në deklaratën *vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar se ka marrë shumën prej 30.000 eurosh nga babai i saj, si pagesë paraprake për blerjen e apartamentit në rr. “{***}”, sipas kontratës së shitjes me rezervë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.01.2006, ku subjekti ka deklaruar se çmimi total është 80.000 euro, nga të cilat 30.000 euro të likuiduara dhe

diferenca e mbetur në shumën 50.000 euro do të shlyhet brenda vitit 2006. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka kthyer vlerën prej 30.000 eurosh dhe anulimin e kontratës së shitjes me rezervë të apartamentit.

14.8 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me kohën dhe mënyrën e dhënies nga babai i saj të shumës 30.000 euro, të deklaruar si burim për blerjen e pasurive objekt kontrolli, në përgjigje të së cilës subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Të dyja apartamentet e porositura në vitin 2001, ndodheshin në të njëjtin kat të pallatit (kati tetë) dhe ishin në vazhdim të njëra-tjetrës, sipas planimetrisë fillestare të miratuar. Në momentin e nënshkrimit të kontratave të porosisë, ndërtimi ishte në fillimet e tij, sapo kishte dalë me kolona mbi sipërfaqen e tokës. Gjatë kohës që ndërtohej pallati, ngjarjet që pasuan, bënë që të ndryshohej qëllimi i blerjes së dy apartamenteve. Kështu, djali i T. Ç. (vëllai im B. Ç.) u largua familjarisht në vitin 2002 në Milano/Itali me punë në konsullatë, ndërsa babai i bashkëshortit ndërroi jetë në vitin 2003. Në rrethanat e reja, babai im dhe bashkëshorti im bien dakord që gjithë sipërfaqet e porositura te S. K., në situatën kur akoma nuk kishin filluar ndarjet me tulla sipas apartamenteve, të modifikoheshin në dy apartamente me sipërfaqe ndryshe nga ato të parashikuara në kontratën e porosisë, konkretisht njëri 135 m² dhe tjetri 60 m², ngjitur me njëri-tjetrin. Për shkak se këto dy apartamente i përshtateshin më mirë familjes Sollaku, për arsye se duhej të jetonte nëna e ve e bashkëshortit pranë nesh, ramë dakord që këto dy apartamente të kalonin në pronësinë tonë, ndërsa babai im T., së bashku me nënën time të jetonin tek apartamenti ynë në rrugën "{***}", mbi postën shqiptare nr. 8 (ku edhe aktualisht jetojnë), me synimin e blerjes në të ardhmen të atij apartamenti. Për këtë qëllim, ky synim u formalizua edhe në kontratat e premtim shitjes me rezervë të apartamentit në fund të vitit 2005 e fillim viti 2006 në rrugën "{***}", të lidhura mes nesh dhe babait tim, T. Ç.. [...] Shpjegoj se shuma prej 30.000 eurosh përfaqëson shumën totale që babai ka kontribuar në vitet 2001-2005, ku një sasi e kësaj shume është përdorur për të kryer pagesat e dy apartamenteve. Prandaj në kontratat premtim shitje/shitje me rezervë, ne i kemi njohur babait pagesë paradhënie për apartamentin në rrugën "{***}". Më pas, meqenëse prindërit e mi nuk patën interes për të paguar edhe pjesën tjetër të shumës sipas kontratës shitje me rezervë, për shkak se vëllai im me familjen qëndruan në Itali, ata hoqën dorë nga synimi për të blerë apartamentin në rrugën "{***}" dhe, në këto kushte, ne i kemi kthyer shumën prej 30.000 eurosh, duke mbetur apartamenti në pronësi tonën dhe ata duke vazhduar të banojnë aty.*

14.9 Trupi gjykues vëren se për shkak të pagesës prej 30.000 eurosh të kryer nga babai i subjektit, pagesë e cila ka shërbyer si likuidim i një pjese të çmimit për blerjen e apartamentit 195 m² të subjektit të rivlerësimit, Komisioni e ka konsideruar atë si person tjetër të lidhur, duke i kërkuar subjektit të vendosë në dispozicion të Komisionit, dokumentacionin ligjor provues lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait, të cilat kanë mundur pagimin prej tij të shumës prej 30.000 eurosh. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, në ankim ka sjellë në vëmendje se në datën 21.07.2001, bashkëshorti i saj ka porositur një apartament me sipërfaqe 93 m², me vlerë 40.900 USD dhe se me lidhjen e kontratës së porosisë po në këtë datë, është paguar shuma prej 15.000 USD dhe me marrjen e kredisë në vitin 2002, është likuiduar shuma prej 2.500.000 lekësh. Po në datën 21.07.2001, babai i subjektit të rivlerësimit ka porositur apartamentin me sipërfaqe

115 m², me vlerë 50.600 USD, në të njëjtin pallat me subjektin e rivlerësimit. Me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes babai i subjektit të rivlerësimit ka paguar shumën prej 10.000 USD dhe në datën 31.07.2001, ka paguar këstin prej 15.000 USD. Për shkaqe të ndryshme familjare, familja e babait të subjektit nuk kishte më nevojë për këtë apartament, ndërsa situata familjare e subjektit ndryshoi dhe, për këtë arsye, babai i subjektit të rivlerësimit kërkoi të blinte apartamentin në rr. “{***}” në pronësi të subjektit, ndërsa subjekti e bashkëshorti i saj do të blinin edhe apartamentin e porositur nga babai i subjektit të rivlerësimit, por me një organizim të ri të hapësirave të apartamenteve.

14.10 Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim, se babai i saj nuk është person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, ndaj marrëdhënia e saj me babain kurrsesi nuk mund të futej në kornizën e një marrëdhënie juridike huaje apo dhurimi që ka mundësuar kryerjen e pagesave të apartamentit siç arsyeton Komisioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë rrethanat që rezultojnë nga aktet e administruara, por që janë deklaruar edhe prej subjektit të rivlerësimit e që janë përshkruar në paragrafët 14.2 - 14.9 më sipër këtij arsyetimi.

14.11 Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, se babai i saj nuk duhet kualifikuar si person tjetër i lidhur sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 në kushtet e mësipërme faktike, analizoi të dhënat që rezultojnë nga hetimi me qëllim kualifikimin e marrëdhënies së subjektit me babain e saj për efekt të procesit të rivlerësimit. Siç rezulton nga hetimi, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin kanë blerë nga shoqëria “{***} “ ShPK dy apartamente me përshkrimet si më sipër, për të cilat kanë lidhur në datën 13.04.2005, dy kontrata respektive me nr. {***} rep., e nr. {***} kol. (apartament 135 m²); dhe me nr. {***} rep., e nr. {***} kol. (apartament 60 m²) me këtë shoqëri, për një vlerë totale të paguar për to prej 8.682.000 lekësh. Nga deklaratimet e subjektit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, ka rezultuar se një pjesë e çmimit të blerjes së këtyre pasurive, të bashkuara në një të vetme, në vlerën prej 30.000 eurosh/25.000 USD, janë paguar prej babait të saj në periudhën 2001-2005, për shkak se babai i subjektit kishte porositur njërin prej këtyre apartamenteve për llogari të tij. Në këto kushte, në zbatim të detyrimit që vjen sipas parashikimit kushtetues të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, neneve 30 dhe 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar, ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të vlerës prej 30.000 eurosh, që ka shërbyer për krijimin e pasurisë në pronësi të saj, e cila i është nënshtruar kontrollit të ligjshmërisë prej organeve të rivlerësimit. Përveç sa më sipër, referuar parashikimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, verifikimi i burimeve të krijimit të pasurisë i referohet momentit të krijimit të tyre. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se kontrolli për ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh, të paguar nga babai i subjektit, duhet të bëhet deri në ditën e kryerjes së kësaj pagese.

14.12. Nën këtë këndvështrim, trupi gjykues konstaton disa rrethana që vlerësohen të rëndësishme për kualifikimin ligjor të marrëdhënies dhe statusit të babait të subjektit, si më poshtë.

- i) Në momentin e blerjes/krijimit të pasurisë, babai i subjektit ka investuar për llogari të subjektit shumën prej 30.000 eurosh.
- ii) Kjo shumë e paguar prej tij ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë.
- iii) Kontratat e premtim shitjes dhe shitjes me rezervë mes bashkëshortit të subjektit e babait të saj, janë lidhur pasi subjekti e kishte krijuar pasurinë dhe likuiduar çmimin për blerjen e saj, në datat 29.12.2005 dhe 12.01.2006.
- iv) Përveç sa më sipër, të dyja kontratat e premtim shitjes dhe shitjes me rezervë parashikojnë se blerësi, babai i subjektit, duhet të paguajë diferencën e çmimit të blerjes së apartamentit në pronësi të subjektit, të ndodhur në rrugën “{***}”, brenda vitit 2006, në të kundërt, palët kthehen në gjendjen e mëparshme dhe kontratat konsiderohen se nuk kanë prodhuar asnjë pasojë¹². Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, babai i saj si blerës i pasurisë jo vetëm që nuk e ka paguar këtë shumë brenda vitit 2006, por nuk e ka paguar atë asnjëherë, duke u tërhequr prej këtyre kontratave përfundimisht në vitin 2015, kur subjekti deklaroi se i ka kthyer atij mbrapsht edhe shumën prej 30.000 eurosh të paguar prej tij për porositjen e financimit e apartamenteve në rrugën “{***}”, si dhe të konsideruar si parapagim për blerjen e ardhshme të pasurisë tjetër të subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, kontratat e përmendura nuk kanë prodhuar efekte ligjore dhe pretendimi se shuma e paguar nga babai për financimin e apartamentit në pronësi të subjektit, mbahej prej saj për shkak të pasojave të këtyre kontratave, mbetet e pambështetur ligjërisht.
- v) Nga deklaratimet në DIPP-në e vitit 2015, subjekti sqaron se shuma prej 30.000 eurosh i është kthyer babait të saj për shkak të revokimit të kontratave të premtim shitjes dhe shitjes me rezervë, duke konfirmuar faktin se kjo shumë është konsideruar edhe prej subjektit se i përket/është në pronësi të babait të saj dhe se subjekti nuk e kishte fituar pronësinë mbi të me asnjë mënyrë tjetër të parashikuar prej ligjit.

14.13. Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues, së pari, vlerëson se pretendimi i subjektit se marrëdhënia mes saj dhe babait lidhur me financimin e shumës prej 30.000 eurosh, të konsideruar të kryer të paktën deri në datën 15.04.2005, nuk mund të justifikohet se rregullohet ligjërisht nëpërmjet dy kontratave të lidhura pas në kohë, pas fitimit të pronësisë mbi pronën. Në funksion të këtij procesi, ka rëndësi thelbësore kontrolli i burimeve në momentin e krijimit të pasurisë dhe marrëdhëniet e lindura më pas nuk mund të kenë efekt prapaveprues. Së dyti, bazuar në të drejtën e gjykatës për përcaktimin e saktë ligjor të situatave faktike sipas parashikimit të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues e sheh me vend, duke përshkruar të gjitha rrethanat

¹² Në kontratën e premtim shitjes, datë 29.12.2005, parashikohet se: “Blerësi pranon ta blejë këtë pronë me kushtet e mësipërme, me barrë dhe të paguajë çmimin prej 80.000 eurosh. Jashtë kësaj zyre, blerësi i ka paguar premtuesit të shitjes, shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro dhe pjesa tjetër prej 50.000 eurosh do të paguhet brenda vitit 2006. Kontrata e shitblerjes do të lidhet brenda vitit 2006. Premtuesi i shitjes merr përsipër të paguajë kredinë në favor të bankës, sipas kushteve të kredisë. Nëse nuk realizohet shitja brenda afatit të përcaktuar më lart, palët kthehen në gjendjen e mëparshme”.

Në kontratën e shitjes me rezervë, datë 12.01.2006, parashikohet se: “3. Diferenca e mbetur, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, do të shlyhet brenda vitit 2006. [...] Në rast të mosrespektimit të pikës 3 të kontratës, shitësi rifiton të drejtën e pronësisë mbi apartamentin, ndërsa blerësi i kthehet shuma e paguar, duke zbritur 400 euro në muaj, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës”.

e faktit të cituara më lart, t'i kualifikojë ato si elemente që përbëjnë një marrëdhënie me tipare të forta huaje, nga ato që i nënshtrohen kontrollit të burimit të krijimit sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Krahas këtij arsyetimi, trupi gjykues çmon të nënvizojë se detyrimi i subjektit për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume, vjen edhe në zbatim të drejtpërdrejtë të parashikimit kushtetues për të provuar bindshëm burimet e krijimit të pasurisë sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht se nga gjenerohet ai. Përderisa në kuptimin ligjor, transaksioni i kryer me babain e saj në funksion të financimit të shumës prej 30.000 eurosh, nuk mund të kualifikohet se ka ndodhur për shkak të kontratave të premtim shitjes dhe shitjes me rezervë, sipas arsyetimit më sipër dhe në këndvështrim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, i vetmi kualifikim adekuat me rrethanat e faktit në kuadër të procesit të rivlerësimit, është njohja e statusit të personit tjetër të lidhur për babain e saj, z. T. Ç..

14.14 Për sa i përket provueshmërisë së burimeve të ligjshme të babait të subjektit për të mundësuar krijimin e shumës prej 25.000 USD deri në vitin 2005, në zbatim të parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision një vërtetim¹³ të Bashkisë Peqin, sipas të cilit përcaktohet se babai dhe vëllai i subjektit, nga viti 1963 deri në vitin 2004, kanë bashkëjetuar në të njëjtën banesë në Peqin, Elbasan. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, ka sqaruar se ata kanë ushtruar një aktivitet privat, i cili ka qenë i babait të saj, pavarësisht se është regjistruar në emër të vëllait. Subjekti i rivlerësimit depozitoi vërtetim¹⁴ të lëshuar nga Drejtoria e Taksave Vendore, Bashkia Peqin, mbi detyrimet e shlyera për taksat dhe tarifave vendore nga z. B. Ç., gjatë periudhës 1999-2006. Në këtë vërtetim nuk janë përcaktuar të dhëna mbi xhirot apo fitimet e realizuara, por vetëm mandatet për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

14.15 Lidhur me aktivitetin e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. B. Ç., Komisioni i ka kërkuar informacion DRT-së Elbasan, e cila me shkresën nr. {***} prot., datë 30.12.2020, ka informuar se ky aktivitet është regjistruar si person fizik më datë 30.01.2003 dhe ka kaluar në status pasiv në të njëjtën datë e, për rrjedhojë, nuk ka realizuar dhe deklaruar të ardhura e fitime ndër vite, pasi data e regjistrimit dhe ajo e kalimit në status pasiv, është e njëjtë. Komisioni i ka kërkuar gjithashtu Bashkisë Peqin të vërë në dispozicion të gjitha të dhënat e disponuara mbi aktivitetin në fjalë, mbi detyrimet konkrete të taksave dhe tarifave vendore të paguara gjatë periudhës 1999 – 2005. Në përgjigje¹⁵, Bashkia Peqin ka paraqitur të dhënat mbi qarkullimin vjetor të vetëdeklaruar nga z. B. Ç., si dhe llojin e taksave të paguara përgjatë periudhës së kërkuar. Nga përmbajtja e shkresës, është konstatuar se detyrimet e paguara përfshijnë vetëm taksa dhe tarifa vendore (si: taksë ndërtese, pastrimi, reklame, zënie të hapësirës publike, si dhe tarifë shërbimi), dhe nuk ka rezultuar pagimi i ndonjë detyrimi tatimor pranë këtij institucioni. Komisioni, duke pasur në konsideratë vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Peqin mbi pagesat e taksave dhe tarifave vendore nga ky aktivitet në këtë institucion, iu drejtua sërish DRT-së Elbasan, për të riverifikuar të dhënat tatimore të disponuara për aktivitetin e vëllait të subjektit të rivlerësimit. Në përgjigje, DRT Elbasan ka

¹³ Vërtetim nr. {***} prot., datë 19.03.2020.

¹⁴ Vërtetim nr. {***} prot., datë 15.01.2019.

¹⁵ Shkresa nr. {***} prot., datë 26.01.2021.

rikonfirmuar¹⁶ të njëjtin informacion të përcjellë më parë, duke bërë me dije se nuk disponojnë informacion tjetër shtesë, jashtë të dhënave që gjenden në sistemin informatik tatimor.

14.16 Subjekti i rivlerësimit, bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka dorëzuar në Komision vërtetimin nr. {***}, datë 28.05.2020, lëshuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas të cilit vërtetohet se vëllai i subjektit ka qenë i punësuar si shofer në Konsullatën e Përgjithshme në Milano për periudhën 2002 – 2006 dhe ka marrë shpërblim mujor neto, në masën 520 USD/muaj deri në tetor të vitit 2003; nga tetor 2003 – 2006, shpërblimi mujor neto ka qenë në masën 558 euro/muaj. Subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision deklaratën noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 02.07.2020, të z. L. Ç., i cili deklaroi se në dyqanin e tij të tregtimit me shumicë të artikujve elektrikë, paraqitej z. T. Ç., fillimisht për periudhën 1994-1999, për furnizimin e dyqanit të vëllait, e më pas kishte dijeni se ushtronte aktivitet tregtar për llogari të vet, duke vazhduar të furnizohej derisa e shiti dhe u transferua në Tiranë.

14.17 Në kushtet e mësipërme, meqenëse babai i subjektit ka ushtruar aktivitetin tregtar në emër të djalit të tij, i cili ishte i punësuar jashtë Shqipërisë, nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit, u mor në shqyrtim dokumentacioni për të ardhurat dhe tatimet që ka gjeneruar ky aktivitet privat i mbikëqyrur nga babai i subjektit, ndërkohë që figuronin se jetojnë bashkë. Nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me aktivitetin tregtar të vëllait të saj, rezultojnë të dhëna kontradiktore për sa i përket kohës së ushtrimit të këtij aktiviteti. Sipas certifikatës së regjistrimit në organin tatimor për biznesin e vogël, vëllai i saj B. Ç. rezultoi i regjistruar në Degën e Tatimeve e Taksave të Rrethit Peqin. Numri i identifikueshëm i personit të tatueshëm (NIPT) i këtij biznesi, sipas kësaj certifikate, është {***}. Aktiviteti është regjistruar me objekt “Tregti artikujsh të ndryshëm”, i cituar në certifikatën e regjistrimit: “Regjistruar me vendim gjykate nr. {***}, datë 07.01.2000”, ndërsa data e regjistrimit në organin tatimor është 13.01.2000. Ndërkohë në shkresën e Bashkisë Peqin, drejtuar Komisionit (cituar në paragrafin më sipër), sipas të dhënave tabelare, rezultoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka pasur qarkullim xhiroje që nga viti 1999. Nga ana tjetër, informacioni i DRT-së Elbasan (cituar në paragrafin 14.15 më sipër) sqaron se vëllai i subjektit është regjistruar si person fizik në datën 30.01.2003 dhe ka kaluar në status pasiv po në të njëjtën datë. Në kushtet kur, nga dokumentacioni i administruar në dosje nga Bashkia Peqin, rezultoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka paguar taksat vendore për aktivitetin privat për periudhën 1999-2006, por nga organet tatimore është konfirmuar fakti që ky subjekt tregtar është regjistruar pranë këtyre organeve vetëm në janar të vitit 2003 dhe ka kaluar në status pasiv në të njëjtën datë, për të verifikuar ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, u vlerësua e nevojshme të kontrollohet nëse për këto vite të ushtrimit të aktivitetit privat (1999-2006, sipas shkresës së Bashkisë Peqin) janë paguar detyrimet tatimore. Nga dokumentacioni i administruar në dosje nuk rezultojnë të dhëna që të provojnë pagesën e detyrimeve tatimore, për më tepër në ekstraktet e QKB-së ky biznes rezultoi se është hapur dhe pezulluar në të njëjtën datë, duke krijuar bindjen se nuk ka gjeneruar të ardhura e, për rrjedhojë, as pagesa për taksat e tatimeve. Gjithashtu, edhe shkresa e Bashkisë Peqin, e cila pasqyron

¹⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 19.01.2021.

pagimin e taksave e tarifave vendore, detajon llojin e natyrën e tyre, të cilat evidentohet se janë të lidhura me detyrimet që u vijnë taksapaguesve për pushtetin vendor, por që janë të ndryshme dhe i nënshtrohen legjislacionit mbi pushtetin lokal, nga detyrimet tatimore që duhen paguar pranë administratës tatimore. Asnjë e dhënë në këto dokumente, ndonëse pasqyron qarkullimin vjetor të deklaruar prej subjektit tregtar, nuk evidenton pagimin e ndonjë detyrimi tatimor që buron prej tij, në zbatim të legjislacioni tatimor në fuqi.

14.18 Në përfundim të analizës lidhur me të ardhurat e aktivitetit privat të babait të subjektit, të cilat, sipas subjektit, një pjesë kanë shërbyer për të paguar këstet e apartamentit të prenotuar nga ai, rezulton se nuk identifikohen pagesa për detyrimet tatimore lidhur me xhiron e rezultuar të kryer nga ky biznes. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk përmbushi barrën e provës për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i regjistruar në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe të ushtruar nga babai i saj.

14.19 Përveç të ardhurave nga aktiviteti, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar të konsiderohen si të ardhura të babait të saj edhe ato të përfituara nga një kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.09.2006, sipas së cilës babai i subjektit i ka shitur një individ, një truall me sipërfaqe 20 m² dhe një dyqan me sipërfaqe 19 m², kundrejt çmimit total prej 3.200.000 lekë. Në këtë kontratë, parashikohet se shuma e mësipërme është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Bashkëngjitur kontratës, subjekti dorëzoi dhe një deklaratë, shkresë e thjeshtë, e nënshkruar nga palët më 18.11.2005, ku blerësi A. C. ka deklaruar se më 18 nëntor të vitit 2005, ka dhënë shumën prej 2.500.000 lekësh si parapagim dhe diferenca prej 700.000 lekësh do të paguhet në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes.

14.20 Lidhur me të ardhurën prej 2.500.000 lekësh, të përfitur nga babai i subjektit nga shitja e dyqanit, Komisioni vlerësoi se edhe nëse do të konsiderohej kjo shumë, rezulton se ajo është përfitur në nëntor të vitit 2005, pra, pas nënshkrimit të kontratave të shitblerjes së pasurive në prill të vitit 2005 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfshihet si burim për pagesat e kryera deri në këtë moment. Në këto kushte, nga përllogaritja e të ardhurave të dokumentuara të familjes Ç. dhe pas përllogaritjes së shpenzimeve jetike, duke përfshirë edhe një investim të kryer në vitin 1999 (blerje dyqani), Komisionit i ka rezultuar një pamundësi financiare në vlerën negative prej 5.843.963 lekësh. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se babai i subjektit të rivlerësimit, z. T. Ç., nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pagimin e shumës prej 30.000 eurosh.

14.21 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit për këtë çështje, ka sqaruar se: *Theksojmë se sipas legjislacionit të kohës, biznesi i vogël me xhiro deri 2 (dy) milionë lekë në vit, paguante vetëm taksa vendore në një kuotë fikse dhe asgjë më shumë. Nga analiza jonë, paraqitur dhe më parë në KPK, rezulton që babai ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar pagesën e shumës 25.000 USD në vitin 2001. Babai im ka ushtruar një aktivitet tregtar në Peqin, i cili në dijeninë time rezultonte i ligjshëm dhe iu garantonte atyre një jetesë të mirë. Ashtu sikundër edhe Komisionit i ka rezultuar nga hetimi, është e provuar se babai im ka ushtruar një aktivitet tregtar, i cili gjithashtu duhet të vlerësohet nga ky Komision në kontekstin e kohës kur*

është realizuar, legjislacionit dhe informalitetit të gjithëpranuar. Vlerësoj se analiza që duhet të bëjë Komisioni nuk duhet të jetë burimi i ligjshëm i të ardhurave për pasurinë e krijuar nga babai im, pasi në vlerësimin tim, detyrimi nga neni D i Aneksit të Kushtetutës është vetëm për subjektet e rivlerësimit dhe të ardhurat e tyre, të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurive. Në rastin konkret, jemi para faktit të shkëmbimit të dy pasurive, të cilat janë krijuar nga pronarët respektivë/përkatësisht. Nuk jemi para kushteve të nenit 32/4, pasi babai nuk më ka dhënë mua asnjë hua apo dhuratë, por ka porositur një apartament për familjen e tij, të cilin në vijim, sa shpjegova dhe më sipër, pa asnjë qëllim paraprak për të fshehur apo justifikuar ndonjë pasuri, e ka këmbyer me mua. Por pavarësisht sa më sipër, nga deklarimi i babait tim, rezulton që ai në aktivitetin e tij tregtar në ato vite, ka pasur marrëdhënie me shumë tregtare të tjerë, duke dhënë dhe marrë me njëri-tjetrin. [...] Nga deklarata e babait tim dhe e zotit V. K., rezulton se ata në vitin 2001 kanë pasur marrëdhënie huaje në shumën 25 (njëzet e pesë) mijë dollarë, çka i ka mundësuar pagesën e shumës prej 25 (njëzet e pesë) mijë dollarësh firmës ndërtuese, edhe nëse prej jush nuk do të konsiderohet asnjë e ardhur prej biznesit të tij. Kur e kam pyetur babain për të ardhurat që kanë mundësuar kryerjen e pagesave, nuk ka përmendur marrëdhëniet që ka pasur me shokët e miqtë, sepse ishte i bindur që të ardhurat nga aktiviteti tregtar ishin më se të mjaftueshme për të justifikuar kryerjen e pagesave të firma ndërtuese “{***}” dhe se nuk dëshironte që në këtë proces, të shqetësonte persona të tjerë.

14.22 Me përgjigjet e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision dy deklarata me shkrim dore të vitit 2001, të cilat tregojnë pagesat e kryera nga babai i saj në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, të shumave 10.000 USD në datën 20.07.2001, si dhe të shumës prej 15.000 USD në datën 31.07.2001. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit, dorëzoi deklaratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 18.06.2021, të deklaruesit V. K., i cili deklaroi se në vitin 2001 i ka dhënë hua babait të subjektit shumën prej 10.000 USD dhe 15.000 USD, pasi i dispononte nga shitja e apartamenteve në pronësi dhe nga aktiviteti i biznesit. Subjekti dorëzoi edhe dy kontrata¹⁷ shitjeje të pasurive të paluajtshme në pronësi të V. K., në shumën totale prej 3.850.000 lekësh.

14.23 Lidhur me dy deklaratat me shkrim dore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, cituar në paragrafin më sipër, trupi gjyqës vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, në pyetësonin nr. 2, në të cilin, e pyetur për mënyrën dhe kohën e dhënies së pagesës së 30.000 eurove, ka shpjeguar se: *Pagesa prej 30 mijë eurosh nga babai im T. Ç., përfaqëson shumën e përgjithshme që ai ka dhënë gjatë 4-5 viteve të ndërtimit të pallatit, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës së porosisë deri në datën e marrjes në dorëzim të sipërfaqeve të porositura nga ana jonë me kontratën e shitblerjes. Me saktësi dihet koha e pagesës prej 10 mijë dollarësh amerikanë që citohet në kontratën e porosisë të nënshkruar nga T. Ç. me ndërtuesin S. K., ndërsa për pagesat e kësteve të tjera nuk e përcaktojmë dot sepse nga babai im nuk janë ruajtur dëftesat e dorës të dhëna nga S. K. në momentin e pagesës së këstit të apartamentit. Nga ky i fundit, për shkak të situatës dhe moshës së tij 81-vjeçare, nuk na është mundësuar gjetja e ndonjë dokumenti që*

¹⁷ Kontrata nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.11.1999; kontrata nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 24.05.2001.

vërteton pagesën e kësteve. Siç rezulton në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorë lidhur me kohën e pagesës së kësaj shume, subjekti nuk ka dorëzuar dokument apo vërtetim të pagesave të kryera nga babai, duke mos përcaktuar kohën e pagesës së kësaj të dytë prej 15.000 eurosh, të dorëzuara nga babai i saj shoqërisë së ndërtimit, dhe ka dhënë një afat prej 4-5 vitesh për pagesën e kësteve, ndërkohë që në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti sjell dy deklarata për pagesën e kësteve, të cilat që të dyja përcaktojnë si moment dhënieje korrikun e vitit 2001. Ky fakt është mbështetur edhe nga z. V. K. në deklaratën noteriale, ku specifikon dy kështet të paguara në vitin 2001. Këto dokumente, të cilat janë paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit dhe të paidentifikuara apo cituara më parë, duket se janë hartuar për të mbështetur subjektin e rivlerësimit në procesin e saj të rivlerësimit dhe nuk japin besueshmëri për sa deklarohet në to, pikërisht se ato nuk vijnë në harmoni me përgjigjet dhe aktet që subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision deri para deponimit të tyre.

14.24 Në përfundim të sa më sipër, Komisioni, pas kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit, në vendimin objekt shqyrtimi, pas përlogaritjes së shpenzimeve jetike dhe të investimit të kryer nga babai i subjektit në vitin 1999¹⁸, ka konkluduar për një pamundësi financiare në shumën prej -5.843.963 lekësh. Nga dokumentacioni që subjekti ka paraqitur për të provuar të ardhurat e babait, nuk u provua që ky i fundit ka gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për të kryer pagesën e apartamentit, e cila më pas iu kalua subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Lidhur me burimet për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 195 m², nga kontrolli që Kolegji ushtroi mbi analizën financiare të Komisionit, pa përfshirë të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti privat në emër të vëllait dhe të ushtruar nga babai, si edhe pa njohur marrëdhënien e huasë mes personit tjetër të lidhur dhe z. K., duke bërë pjesë të kësaj analize shpenzimet e kryera për të përballuar kostot e jetesës, si një e dhënë bazike e përdorur tashmë për analizimin e mundësive financiare të personave të tjerë të lidhur, sipas jurisprudencës¹⁹ së Kolegjit, dhe duke korrigjuar analizën e kryer në Komision nëpërmjet përjashtimit si shpenzim të vlerës së dyqanit të blerë në vitin 1999 nga babai i subjektit, si një investim i mundshëm i kryer me të ardhura të tjera të padokumentuara të familjes, rezultoi se familja e babait të subjektit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën -4.248.358 lekë²⁰, për të paguar shumën prej 25.000 USD për prenotimin e apartamentit në vitin 2001 e të paguar deri në vitin 2005, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 15. Lidhur me dy apartamentet me sipërfaqe 184,2 m² dhe 82,4 m² dhe tri garazhet me sipërfaqe përkatësisht 21,93 m², 15,95 m² dhe 15,08 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, kompleksi “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se duhet ta kishte deklaruar huanë në deklaratën *vetting*, si një nga burimet financiare të përdorura për pagesën e pasurive, duke pretenduar se e ka deklaruar edhe huanë, edhe kreditë si burim për krijimin e kësaj**

¹⁸ Në vitin 1999, babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë dyqan në shumën 1.500.000 lekë.

¹⁹ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023.

²⁰ Kjo diferencë negative vjen më e vogël se e Komisionit, për shkak se në Kolegj nuk është përfshirë si shpenzim dyqani i blerë nga babai i subjektit në vitin 1999, si dhe përfshirja e të ardhurave nga puna e nuses së vëllait të subjektit, të cilat janë të provuara nga dokumentacioni i administruar në dosje.

pasurie. Subjekti pretendon se huaja është shlyer prej shumë së marrë kredi në Bankën Tirana, e cila është deklaruar si në deklaratat periodike, ashtu edhe në atë *vetting*. Sipas subjektit, huaja, si burim krijimi i kësaj pasurie, është shlyer me shumë e marrë kredi, prandaj për sa kohë është likuiduar plotësisht nëpërmjet shlyerjes nga ky burim, në momentin e përpilimit të deklaratës në vitin 2017, ajo nuk ka ekzistuar. Sipas subjektit, do të kishim një mbivendosje të burimeve nëse edhe kredia, edhe huaja do të citoreshin në të njëjtën kohë si burime më vete për krijimin e kësaj pasurie.

Për personin tjetër të lidhur, z. K. P., subjekti pretendon se konkluzionet e Komisionit nuk qëndrojnë, pasi të ardhurat e deklaruara nga z. P. në DIVA-t e viteve 2012 dhe 2013, ndryshe nga sa pretendon Komisioni, janë fitimet e realizuara nga subjekti tregtar K. P. person fizik, dhe jo shoqëria tregtare. Personi fizik K. P. dhe individi K. P. janë një në lidhje me të ardhurat, pasi ai mund të administrojë/përdorë në çdo moment të ardhurat e subjektit tregtar person fizik dhe janë këto të ardhura të cilat kanë shërbyer për t'i dhënë hua bashkëshortit të saj për një kohë të shkurtër. Në veprimtarinë huadhënëse është përdorur vetëm llogaria individuale e z. P. dhe jo llogaritë e subjektit tregtar. Referuar parashikimeve ligjore, sipas subjektit të rivlerësimit, K. P. klasifikohet nga pikëpamja tatimore si biznes i vogël që është nën përgjegjësinë tatimore të taksës fikse të biznesit të vogël dhe për të cilën destinimin e fitimit të realizuar e ka pasqyruar në Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA).

15.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Për rrjedhojë të sa më sipër, stricto legis dhe sipas jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke mos e konsideruar huamarrjen e lartpërmendur, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij rezulton me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën negative prej 14.021.000 lekësh, për pagesën e çmimit të këtyre pasurive. Gjithashtu, duhet qartësuar se: (i) nga njëra anë, kjo pamundësi financiare, në momentin e kryerjes së pagesave (si më sipër përshkruar), nuk ndikon në analizën financiare të vitit 2013 – duke mos u reflektuar kjo mungesë në fund të vitit në fjalë, për shkak të marrjes së kredisë bankare prej subjektit disa muaj më pas, shuma të përdorura pikërisht (edhe) për shlyerjen e kësaj huaje, duke u mbivendosur si burim alternativ brenda vitit, dhe për pasojë duke bërë që viti 2013 të mos rezultojë me balancë negative; (ii) nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se edhe nëse huamarrja në fjalë do të konsiderohej me burim të ligjshëm financiar, ndonëse përfaqëson një shumë të konsiderueshme, kjo nuk do të mjaftonte që vlerësimi dhe vendimi përfundimtar gjithëpërfshirës i kriterit të pasurisë të ishte i ndryshëm/pozitiv, për sa kohë pamjaftueshmëria totale që ka rezultuar në analizën financiare të pasurive/shpenzimeve të tjera (pa pasur asnjë efekt negativ prej kësaj huaje), si dhe problematikat e konstatuara lidhur me deklarinimet, nuk do ta mundësonin gjithsesi mosaplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

15.2 Lidhur me këtë pasuri, nga aktet e hetimit, rezultojnë të dhënat si vijojnë. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë: (i) apartament me sip. 184,2 m², me çmimin 181.200 euro; (ii) apartament me sip. 82,4 m², me çmimin 81.000 euro; (iii) garazh me sip. 21,93 m², me çmimin 15.600 euro; (iv) garazh me sip. 15,95 m², me çmimin 11.400 euro; (v) garazh me sip. 15,08 m², me çmimin 10.800 euro.

Si burim për krijimin e këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredi bankare në Bankën Amerikane të Shqipërisë (Intesa SanPaolo sot), me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.07.2007 (shuma e kredisë 200.000 euro), si dhe kredi bankare pranë Bankës Tirana, me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 16.07.2013 (shuma e kredisë 193.000 euro). Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë porosie për blerje apartamenti pranë shoqërisë “{***}” ShPK, me sip. 274 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, me çmimin 200.000 euro”.

Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë e paluajtshme në fjalë, blerë sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 03.04.2013.

15.3 Trupi gjykues vëren, referuar dokumentacionit të administruar në dosje, se këto pasuri të paluajtshme janë përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.03.2013, të lidhur ndërmjet palës shitëse, shoqërisë “{***}” ShPK dhe palës blerëse Zegjine Sollaku e Th. S., për blerjen e pasurive me vlerë totale prej 300.000 eurosh.

Duke qenë se pasuritë janë objekt i një transaksioni të vetëm, për të cilat nga subjekti i rivlerësimit deklarohen të njëjtat burime financimi, nga Komisioni është kryer një analizë e përbashkët.

Nga verifikimi i kontratës së shitblerjes së këtyre pasurive, vërehet se në pikat 3.2 dhe 3.3 të kësaj kontrate, është parashikuar në mënyrë të përmbledhur se palët bien dakord se vlera e blerjes është likuiduar nga blerësi dhe se shitësi do të paguajë taksën e transferimit të pasurisë. Likuidimi i shumës prej 300.000 eurosh është kryer në rrugë bankare në nr. llogarisë së shoqërisë “{***}” ShPK, para nënshkrimit të kësaj kontrate, si dhe pala shitëse ka deklaruar se nuk ka asnjë pretendim lidhur me likuidimin e çmimit të pasurive objekt të kontratës.

15.4 Në dokumentacionin e administruar në dosje, gjendet kontrata e kredisë me Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot Intesa Sanpaolo Bank), me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.07.2007, për marrjen e kredisë në shumën 200.000 euro. Sipas kësaj kontrate, shuma e kësaj kredie do të përdorej për blerjen e një apartamenti të ri (nuk ka specifikime se cilin apartament), dhe do të disbursohet në dy këste, respektivisht 100.000 euro kësti i parë dhe 100.000 euro kësti i dytë, sipas kërkesës së klientit. Nga verifikimi i pasqyrave të llogarive bankare, rezulton se më datë 06.10.2010, nga llogaria e kredisë në Intesa SanPaolo Bank është kryer transferi e shumës prej 200.000 eurosh në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “Pagesë për porositje apartamenti”.

Gjithashtu, sipas kontratës së kredisë së lidhur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, dhe bashkëshorti i saj me Bankën Tirana, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 16.07.2013, rezultoi se kishte për qëllim marrjen e kredisë në shumën 193.000 euro, për të likuiduar borxhin e marrë për blerjen e apartamentit²¹ 140,03 m² në Tiranë. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare në

²¹ Për shkak të kësaj mospërputhjeje të konstatuar nga Komisioni (objekti i kredisë për të cilin është marrë kredia), është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili, në përgjigje, ka sqaruar se ka një pasaktësi nga Tirana Bank në formulimin e kontratës së kredisë. Shuma e marrë hua nga K. P. në janar 2013, është përdorur për të paguar pranë “{***}” ShPK, diferencën 100.000 euro, shumë kjo e paguar në shkurt me tre mandatpagesat cash nga bashkëshorti. Subjekti shpjegoi se ishin të detyruar të merrnin hua, pasi shoqëria “{***}” kërkonte me insistim likuidimin e diferencës së mbetur dhe, pas kësaj, të bënte veprimet në ZRPP për kalimin e pronësisë, çka ishte dhe në interesin e tyre. Ndërkohë

Bankën Tirana, rezulton se kredia në shumën 193.000 euro është disbursuar në datën 19.07.2013 në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe, po në atë datë, shuma prej 93.000 eurosh është transferuar pranë Bankës Union, me përshkrimin: “Transfertë për mbyllje kredie”, dhe shuma prej 100.000 eurosh është transferuar në llogarinë e shtetasit K. P., me përshkrimin: “Kthim borxhi sipas kontratës së kredisë”.

15.5 Në deklaratën periodike të vitit 2013, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, apo bashkëshorti i saj të kenë deklaruar marrëdhënien e huasë, për shumën 100.000 euro, me z. K. P., si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003. Për këtë arsye, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për marrëdhënien me z. K. P.. Subjekti, në përgjigje, sqaroi se nuk ka qenë asnjëherë në dijeni të kësaj marrëdhënieje, sepse janë veprime të kryera nga bashkëshorti i saj dhe se ka marrë dijeni për herë të parë me rastin e dërgimit të pyetjeve nga Komisioni. Subjekti ka shpjeguar se marrëdhëniet nuk është deklaruar, sepse nuk ka pasur dijeni për të, për shkak se ka qenë pjesë e veprimtarisë private të bashkëshortit si avokat. Për më tepër, duke qenë se marrëdhëniet financiare të bashkëshortit janë mbyllur brenda vitit kalendarik, në çdo datë 31 dhjetor të vitit përkatës, nuk ka pasur asnjë marrëdhënie financiare të hapur. Bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë noteriale²² të datës 25.06.2013, në të cilën shtetasi K. P. ka deklaruar se në janar të vitit 2013, i ka dhënë hua Th. S., shumën 100.000 euro, me një afat 1-vjeçar dhe pa interes, për blerjen e një apartamenti. Lidhur me burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua nga K. P., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me përgjigjet e pyetësorit, ekstrakt nga QKB-ja për aktivitetin e tij si person fizik dhe lëvizjet bankare të llogarisë së huadhënësit në Bankën Veneto, të vitit 2012.

15.6 Nga verifikimi i lëvizjeve bankare, Komisioni nuk konstatoi ndonjë tërheqje të konsiderueshme nga huadhënësi, por kryesisht janë vërejtur transaksione/transferta bankare me klientë dhe furnitorë të ndryshëm, në kuadër të veprimtarisë ekonomike të personit fizik. Komisioni konstatoi edhe nga verifikimi *online* i pasqyrave financiare të depozituara në QKB, të aktivitetit të personit fizik K. P., se fitimet nuk janë tërhequr prej këtij të fundit, por janë vendosur në rezervat e tjera të shoqërisë, duke e pamundësuar konsiderimin e këtyre mjeteve monetare si të disponueshme dhe të përdorshme nga individi-huadhënës.

15.7 Për këto arsye, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës duke i njoftuar rezultatet e mëposhtme.

(i) Duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 dhe në deklaratën *vetting*, huanë e marrë nga z. K. P., si burim i përdorur për blerjen e pasurive në fjalë.

*marrja e kredisë nga banka kërkonte më tepër kohë. Pavarësisht pasaktësive në kontratën e kredisë me Bankën Tirana, në finale, destinimi i shumës së kredisë të marrë në Bankën Tirana, prej 100.000 eurosh, i ka shërbyer pagesës për blerje apartamenti, duke shlyer huanë e dhënë nga K. P., me anë të së cilës u pagua diferenca e vlerës për blerjen e apartamenteve dhe garazheve pranë “{***}” ShPK.*

²² *Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. kol., {***}, datë 25.06.2013.*

(ii) Duket se personi tjetër i lidhur K. P. nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huasë, në shumën 100.000 euro, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 14.021.000 lekësh (ekuivalenti i 100.000 eurove) për blerjen e pasurive objekt analize.

15.8 Në përgjigje të barrës së provës, lidhur me pikën (i) më sipër, subjekti i rivlerësimit sqaroi se: *Asnjëherë nuk janë deklaruar huatë/detyrimet kur ato janë shuar brenda vitit të deklarimit. Rubrika përkatëse e DIPP-së, f. 5, në krye, sqaron se çfarë duhet plotësuar dhe konkretisht: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura nga zyrtari gjatë vitit të deklarimit.*

Lidhur me pikën (ii) në paragrafin më sipër, për pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për dhënien e huasë, subjekti në prapësime ka sqaruar se: *Z. K. P. ka pasur burime të ligjshme për të dhënë hua shumën 100.000 euro në vitin 2013. Kjo vërtetohet edhe me deklaratat individuale vjetore të të ardhurave për vitet 2012 dhe 2013. Kështu, rezulton se z. K. P., për vitin 2012, ka realizuar të ardhura në shumën 45.880.356 lekë, duke paguar tatim në shumën 4.468.036 lekë, ndërsa për vitin 2013 ka realizuar të ardhura në shumën 32.139.672 lekë, duke paguar tatim në shumën 3.108.749 lekë. Bashkëlidhur prapësimeve për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision deklaratat DIVA për vitet 2012, 2013 të z. K. P..*

15.9 Nga dokumentacioni financiar i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në Komision (ekstrakt nga QKB-ja për aktivitetin e K. P. si person fizik dhe lëvizje bankare të llogarisë së huadhënësit në Bankën Veneto, të vitit 2012, të llogarisë në euro dhe një faqe të llogarisë në USD, nga data 30.09.2012 - 17.10.2012, ekstrakt më pak se 20-ditor), ka rezultuar se nga analizimi llogarisë në euro të personit fizik K. P., individë të ndryshëm kanë kryer pagesa me përshkrime kryesisht: “Likuidim kësti për blerje apartamenti”.

Nga lëvizjet bankare, konstatohet se vetë K. P., nga llogaria e tij e personit fizik, menjëherë pas arkëtimit të pagesave nga klientët, i kalon ato në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “Likuidim situacioni”.

Në llogarinë në euro të K. P. si person fizik, rezulton se për vitin 2012, janë kaluar në këtë llogari nga klientët 406.905 euro, vetë K. P. ka derdhur *cash* në këtë llogari 160.500 euro, ndërsa ka tërhequr *cash* nga kjo llogari 28.700 euro. Nga kjo llogari, gjatë vitit 2012 rezulton të jenë transferuar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, 526.997 euro.

Nga verifikimi i informacionit që përmban ky dokumentacion, rezulton se deri në fund të vitit 2012, nuk është kryer ndonjë tërheqje nga kjo llogari në shumën e dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni që subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion, nuk mund të konkludohet nëse shumat e derdhura *cash* nga bashkëshorti i subjektit në llogarinë e tij për të kryer transfertat²³ në llogarinë e “{***}” ShPK për shlyerjen e pagesave për blerjen e

²³ Nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Tirana janë kryer transferimet në llogari të shoqërisë “{***}” ShPK për blerjen e pasurive objekt shqyrtimi, më datë 14.02.2013 – shuma 20.000 euro; më datë

pasurive, kanë qenë ekuivalente me shumën e tërhequra nga z. K. P. nga llogaria e analizuar më lart, pasi pasqyrat bankare që i përkasin kësaj llogarie për vitin 2013, janë sjellë nga subjekti të fragmentuara dhe nuk krijojnë mundësinë e një analize financiare të plotë të të dhënave që ato pasqyrojnë.

15.10 Trupi gjykues, lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. K. P., në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, analizoi pretendimet e subjektit në raport me të dhënat që rezultojnë të provuara nga dokumentacioni financiar i administruar për huadhënësin si vijon. Nga pasqyrat financiare të K. P. person fizik dhe “{***}” ShPK, rezulton se këto dy subjekte tregtare ushtrojnë aktivitet tregtar prej një periudhe të gjatë kohore. Nga verifikimi në faqen zyrtare *online* të QKB-së, rezulton se K. P. është regjistruar në datën 16.02.2010 si person fizik, me veprimtari: “Investitor në fushën e punimeve të ndërtimit”. Gjatë vitit 2010, ky aktivitet (personi fizik) ka rezultuar me humbje në masën – 170.477 lekë, ndërsa në vitet 2011 dhe 2012, referuar pasqyrave financiare të publikuara nga faqja *online* e QKB-së, aktiviteti i tij ka realizuar me fitim neto në vlerat, përkatësisht 40.212.320 lekë dhe 27.950.923 lekë. Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare, rezulton se fitimi i vitit 2011 është përdorur për mbulimin e humbjes së vitit 2010 dhe pjesa tjetër për rritjen e zërit “Rezerva të tjera”.

15.11 Në nenin 13, pika 1 e ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me titull “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave (DIVA)”, parashikohet se tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Nga verifikimi i kësaj deklarate për vitin 2011, fitimi i përlllogaritur në pasqyrat financiare për këtë vit, ka shërbyer për mbulimin e humbjes së vitit 2010, ndërsa pjesa tjetër ka shërbyer për rritjen e zërit “Rezerva të tjera”. Shuma e rezultuar si fitim nga pasqyrat financiare është e njëjtë me të ardhurat e deklaruara nga z. K. P. në DIVA 2011. Për vitin 2012, nga verifikimi i kësaj deklarate, rezulton e njëjta situatë, sipas së cilës e ardhura e deklaruar dhe tatimi i paguar për këtë të ardhur janë të njëjtë në shifra me fitimin dhe tatimin e përlllogaritur në pasqyrat financiare të vitit 2012 të këtij aktiviteti. Këto përputhje tregojnë faktin se e ardhura e deklaruar në DIVA 2012 prej individit K. P., është pikërisht e ardhura e realizuar si fitim nga aktiviteti i personit fizik K. P. dhe nuk mund të deduktohet se në këtë deklaratë janë deklaruar të ardhura të tjera përtej atyre që pasqyrohen në pasqyrat financiare të personit fizik e për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore. Në vijim, fakti që në pasqyrat financiare të personit fizik për vitin 2012, është pasqyruar se ky fitim, i njëjtë me atë që deklarohet në DIVA-n e këtij viti, ka shkuar për rritjen e zërit “Rezerva të tjera”, tregon se individi K. P. nuk i ka disponuar objektivisht këto të ardhura, destinacioni i të cilave ka qenë për rritje të kapitalit të subjektit tregtar. Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i personit fizik K. P. gjatë vitit 2013, rezultuan në shumën 60.839.121 lekë, të cilat, sipas të dhënave të pasqyrave financiare të këtij viti, kanë shërbyer për të shtuar kapitalin e aktivitetit privat, që për vitin 2013 në total ka arritur vlerën 128.831.887 lekë. Duke

20.02.2013 – shuma 40.000 euro dhe më datë 22.02.2013 – shuma prej 40.000 eurosh, në total 100.000 euro. Këto shuma rezultojnë të jenë derdhur cash nga Th. S. në llogarinë e tij në të njëjtat data që janë kryer transfertat.

qenë se në të është përfshirë edhe fitimi i kapitalizuar i viteve 2011 dhe 2012, rrethana që rikonfirmojnë faktin se individi K. P. nuk ka pasur akses dhe as ka disponuar fizikisht shumat e realizuara si fitim nga aktiviteti i personit fizik me të njëjtin emër për këto vite.

15.12 Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se ndonëse personi fizik K. P. rezulton të ketë pasur një fitim nga aktivitetit i vitit 2012, i cili, në terma matematikorë do të mundësonte ligjshmërinë e shumës prej 100.000 eurosh, të deklaruar dhënë hua bashkëshortit të subjektit, nga analizimi i dokumentacionit financiar, rezulton se këto para janë përdorur për një qëllim tjetër, atë të rritjes së kapitalit të këtij subjekti tregtar, rritje e cila në terma praktikë mund të lexohet edhe si mjete likuiditeti për të mundësuar zhvillimin e aktivitetit në fushën e investimeve në ndërtime sipas objektit të veprimtarisë. Në këtë mënyrë, mbetet e paprovuar se pikërisht nga këto shuma, të cilat deklarohen prej subjekti se kanë mundësuar dhënien e huasë, të jenë qarkulluar/tërhequr vlera që përfaqësojnë huanë prej 100.000 eurosh. Pretendimi i subjektit se të ardhurat e përdorua për dhënien e huasë janë ato të deklaruara prej K. P. si individ në DIVA-t e viteve 2012 e 2013, gjendet prej trupit gjykues si jorelevant përderisa, sipas analizës së shifrave dhe të dhënave të tjera, rezulton se shumat e deklaruara në këto deklarata, për këto dy vite, përfaqësojnë pikërisht shumat e deklaruara si fitim të këtyre viteve nga aktivitetit i personit fizik, edhe sepse nuk identifikohet ndonjë aktivitet tjetër i personit tjetër të lidhur që të ketë realizuar të ardhura në vlerat e deklaruara në DIVA, duke u identifikuar dhe pasur në këtë mënyrë të njëjtin regjim juridik, atë të rritjes së kapitalit të personit fizik, regjim i cili përjashton disponimin e lirshëm të tyre për qëllime tjera prej pronarit.

15.13. Përveç sa më sipër, trupi gjykues, në këndvështrim të analizës lidhur me këtë shkak ankimi, shqyrtoi edhe rrethanat e çështjes që i dedikohen transferimit/dorëzimit objektiv/efektiv të shumës prej 100.000 eurosh prej huadhënësi të bashkëshortit të subjektit, të dhëna që janë shqyrtuar nga Komisioni në drejtim të besueshmërisë së ekzistencës së kësaj marrëdhënieje, krahas deklarimeve jo të plota të subjektit të rivlerësimit rreth saj. Së pari konstatohet se transferimi i shumës prej huadhënësit të bashkëshortit është bërë në *cash*, rrethanë e cila është vlerësuar prej Komisionit si një element që cenon besueshmërinë e transaksionit, konsideruar vlerën e lartë të shumës së dhënë hua. Për shkak të këtij transaksioni në *cash*, është presupozuar se nuk ka gjurmë në dokumentacionin bankar që dokumenton transfertën e drejtpërdrejtë, për pasojë janë këqyrur aktet financiare për të kuptuar nëse prej tyre evidentohen të dhëna që tregojnë për tërheqje të huadhënësit, të përafërta në vlerë e në kohë me atë që i ishte dhënë subjektit. Në këtë drejtim, ka rezultuar pa efekt kontrolli mbi librat e arkës së personit fizik, për sa kohë që huaja është deklaruar si e marrë në fillim të vitit 2013 e kthyer brenda të njëjtit vit, duke pamundësuar në këtë mënyrë evidentimin e ndonjë veprimi kontabël në librat e arkës në fund të vitit, krahas faktit se këta libra nuk disponohen as për të kontrolluar veprimet e kryera në ta përgjatë vitit ushtrimor 2013.

15.14 Krahas sa më sipër, referuar dokumentimit të transaksionit në dokumentacion shkresor, e vetmja gjurmë e kësaj natyre është deklarata noteriale e huadhënësit K. P., e cituar në paragrafin 15.5 më sipër, e cila është përpiluar në datën 25.06.2013. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë procesit administrativ se huaja është dhënë në janar të vitit 2013, po ashtu është deklaruar edhe në këtë deklaratë noteriale, e cila, edhe pse huaja është dhënë në janar të këtij viti, nuk është hartuar

në momentin e marrjes/dhënies së saj, por vetëm rreth tri javë para marrjes së kredisë në Bankën Tirana (16.07.2013), duke sugjeruar se kjo deklaratë i ka shërbyer jo aq dokumentimit të marrëdhënies së huasë në vetvete, sa nevojës së justifikimit të marrjes së kredisë. Për më tepër, deklarata noteriale e hartuar para noterit prej personit tjetër të lidhur, nuk ka formën tipike të një kontrate huaje, për sa kohë që përmban vetëm deklarimin e huadhënësit për dhënien e shumës hua, ndërsa do të duhej logjikisht që në mungesë të një kontrate të mirëfilltë huaje, të ishte e kundërta, dhe huamarrësi të deklaronte marrjen e shumës hua dhe detyrimin për ta shlyer, si një akt garancie për kthimin e saj huadhënësit. Krahas elementeve të mësipërme, konstatohet se në kontratën e kredisë bankare të lidhur më datë 16.07.2013 me Bankën Tirana, në pikën 2.1 është përcaktuar: *Kredia do të përdoret nga kredimarrësi për blerje kredie hipotekore në Union Bank dhe likuidimin e borxhit të marrë për blerjen e apartamentit 140,03 m² në Tiranë.* Në pikën 2.2 është parashikuar se: *Banka do të disbursojë kredinë: a) 93.000 euro do të transferohen në Union Bank për të mbyllur kredinë hipotekore. b) 100.000 euro do të transferohen në llogarinë e z. K. P. (borxhdhënësi).* Pra, duket se nëpërmjet kredisë në Bankën Tirana është blerë kredia në Union Bank dhe është kryer likuidimi i borxhit të marrë për blerjen e një apartamenti tjetër²⁴, të referuar nga banka, dhe jo pasuritë objekt shqyrtimi. Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni në pyetësin nr. 3 për këtë referim të bankës, ka shpjeguar se ka qenë një pasaktësi në formulimin e kontratës së kredisë. Trupi gjykues vlerëson se ndonëse kjo e dhënë nuk të çon në përfundimin që huaja e dhënë nga z. P. të ketë shërbyer për krijimin e pasurisë objekt analize, duke qenë se burimi për krijimin e saj është i mirëpërcaktuar dhe i verifikuar nga Komisioni, sërish këto anomali/pasaktësi në përcaktimin e objektit që ka financuar huaja, hedhin më së paku dyshime për ekzistencën e saj si një prej burimeve të përdorura për financimin e pasurive objekt kontrolli, siç është deklaruar prej subjektit.

15.15 Në drejtim të besueshmërisë së subjektit për përdorimin e këtij burimi, trupi gjykues vlerëson të evidentojë faktin se ndonëse kjo hua nuk është deklaruar si një burim i krijimit të pasurive, as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën periodike të vitit 2013, kur ajo është marrë, pretendimi i subjektit se ajo nuk kishte dijeni për marrjen e saj, konsiderohet deklarativ dhe i pabesueshëm. Së pari, subjekti i rivlerësimit, duke qenë subjekt deklarues në vite sipas ligjit nr. 9049/2003, kishte përgjegjësinë të informohej dhe të deklaronte për burimet e krijimit të pasurive të saj dhe bashkëshortit, aq më tepër kur flitet për pasuri në vlera të konsiderueshme, të cilat kërkojnë vlera të larta investimi. Në këtë kuptim, padijenja për marrjen e një huaje prej 100.000 eurosh për të financuar apartamentet e banimit dhe garazhet në pronësi të familjes, nuk vlerësohet se justifikon subjektin karshi detyrimeve që buronin nga ligji nr. 9049/2003. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë garantore dhe palë në kontratën e kredisë, për shumën prej 193.000 euro, në Bankën Tirana, në të cilën përshkruhet se 100.000 euro do të disbursohen për z. K. P. për shlyerje borxhi, element që prezumohet se ka ardhur në dijeninë e saj në momentin e nënshkrimit të kontratës. Për këto arsye, konsideruar edhe vlerën e lartë të huasë, të paguar në *cash*, pretendimet e subjektit të

²⁴ *Ky apartament, me sipërfaqe 140,03 m² (objekt i kontratës së kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2013, në Tirana Bank), ka rezultuar të jetë paguar totalisht nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti si vijon: (i) në vitin 2007, paguar shuma prej 70.000 eurosh; dhe (ii) në vitin 2008, shuma prej (30.000 eurosh), pra 5 vite përpara marrjes së kësaj kredie.*

rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, se ajo nuk kishte dijeni për ekzistencën e saj, mbetën të pabesueshme për trupin gjykues, si një element që ndonëse nuk e ngarkon subjektin me përgjegjësi sipas ligjit nr. 84/2016 (meqë në deklaratën *vetting*, ndonëse jo si burim, por si një detyrim i shlyer, kjo hua është deklaruar), shërben për krijimin e besueshmërisë për të gjithë marrëdhënien e huasë, në funksion të provimit të burimeve të ligjshme të kësaj shume sipas përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

15.16 Në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë ekzistencën marrëdhënies së huasë në shumën 100.000 euro, e pretenduar si e marrë nga bashkëshorti i saj për likuidimin e shoqërisë ndërtuese për blerjen e pasurive objekt shqyrtimi. Element i rëndësishëm i konkluzionit të mësipërm është edhe fakti që subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume prej huadhënësit, për shkak të mungesës së disponueshmërisë së saj. Në funksion të detyrimit që buron nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, ndonëse provoi se personi tjetër i lidhur kishte krijuar me burime të ligjshme të ardhura që e justifikonin shumën e dhënë hua, nuk provoi në asnjë mënyrë që kjo shumë të ishte e aksesueshme/disponueshme lirisht prej tij dhe as të ishte transferuar në ndonjë mënyrë të bashkëshortit i saj. Si deduksion i këtij arsytimi, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për shumën prej 14.021.000 lekësh, aq sa konvertohet në lekë shuma prej 100.000 eurosh, për pagesën e çmimit të këtyre pasurive, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

16. ***Lidhur me pasurinë apartament, me sipërfaqe 57 m² dhe verandë me sipërfaqe 31 m²***, ndodhur në {***}, Vlorë, subjekti i rivlerësimit shpjegon se për kontratën e porosisë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 07.06.2013, të lidhur ndërmjet bashkëshortit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, nuk ka pasur dijeni për kohën kur ajo është nënshkruar, pasi u revokua brenda një muaji, duke qenë se apartamenti i përcaktuar në këtë kontratë nuk ishte i njëjtë fizikisht me atë dorëzuar porositesve, ndaj shoqëria e ndërtimit i ktheu shumën prej 30.000 eurosh personit të lidhur. Me të njëjtën shoqëri ndërtimi, është lidhur një kontratë e re porosie për blerjen e një apartamenti në datën 22.03.2018. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatin financiar të nxjerrë nga Komisioni, i cili ka rezultuar me një diferencë negative në shumën 2.661.037 lekë, pasi pretendon se është zbritur padrejtësisht nga analiza financiare shuma prej 1.888.950 lekësh, që përfaqëson shumën e detyrimeve tatimore të subjektit tregtar person fizik, të cilat paguhen vitin pasardhës, por që në momentin e kryerjes se pagesës për blerjen e apartamentit, kanë qenë të disponueshme nga bashkëshorti.

Sipas subjektit të rivlerësimit, shuma e mjeteve monetare në fund të muajit maj të vitit 2013, të siguruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është në masën 6.198.173 lekë, ndërsa shuma e përlllogaritur nga Komisioni padrejtësisht është në masën 4.554.510 lekë.

Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se Njësia e Shërbimit Ligjor e Komisionit nuk ka pasqyruar si burim të të ardhurave në analizën financiare, shumën e përdorur nga limiti i kartës së kreditit VISA në pronësi të bashkëshortit të subjektit, nga e cila, për periudhën janar – maj, duhet të përfshihen edhe shumat e limitit të përdorura nga kjo kartë, në shumën prej 418.873 lekësh, të

cilën e konsideron si një kredi konsumatore të kartës. Nga analiza e kryer nga subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, bazuar në ndryshimet që ajo ka bërë në përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, duket se analiza financiare për periudhën janar – maj 2013, rezulton me balancë pozitive në shumën prej 82.115 lekësh.

16.1 Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka konkluduar: *Komisioni, nisur nga dispozitat ligjore përkatëse dhe duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, ka përlllogaritur në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, të gjitha të ardhurat e deklaruara dhe të vërtetuara të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit e familjes së tij, dhe në konkluzion, në këtë rast, rezultati i njoftuar subjektit, në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, për këtë pikë nuk ndryshon, duke mbetur një vlerë negative për krijimin e kësaj pasurie, në masën prej 2.661.037 lekësh.*

16.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi kontrata e porosisë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 07.06.2013, e nënshkruar përpara noterës A. M., nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si palë porositëse dhe shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit, për porositjen e një apartamenti banimi në {***}, me sipërfaqe totale 57 m² dhe sipërfaqe verande 31 m², kundrejt çmimit total prej 30.000 eurosh, pagesë kjo, sipas kontratës së sipërcituar, e kryer jashtë zyrës noteriale.

16.3 Pasi është konstatuar nga Komisioni se kjo pasuri nuk është deklaruar në asnjë nga DIPP-të nga ana e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj, duke filluar nga viti 2013 e në vijim dhe as në deklaratën *vetting*, subjektit i është kërkuar të shpjegojë, me anë të pyetësorit nr. 3, lidhur me arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Në lidhje me kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2013, me shoqërinë “{***}” ShPK, nuk kam pasur dijeni në kohën kur ajo është nënshkruar nga bashkëshorti im. Ai më ka shpjeguar se kontrata e mësipërme nuk është deklaruar, sepse është revokuar nga palët brenda afro një muaji. Kontrata u nënshkrua duke u bazuar në të dhënat dokumentare që ofroi firma ndërtuese, veçanërisht planimetria e apartamentit objekt kontrate, si dhe planimetria e ambienteve të përbashkëta të kompleksit. Por, kur shkuam në vend, në fshatin Drimadhes, për të parë apartamentin, rezultoi se përshkrimet në kontratë nuk përputheshin me gjendjen në fakt, pasi ishin bërë ndryshime të projektit. Apartamenti që përshkruhej në kontratë pothuajse nuk ekzistonte, pasi sipërfaqe të tij ishin hequr dhe ishin shtuar apartamenteve ngjitur me të. Po kështu, edhe ambienteve të përbashkëta, pishina, lulishtet, nuk ekzistonin. Në këto kushte, pas debateve të shumta, ramë dakord që kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2013, të zgjidhej duke u kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Shoqëria ndërtuese ktheu pagesën prej 30 mijë eurosh, që i ishte paguar cash para momentit të nënshkrimit të kontratës datë 07.06.2013, me premtimin që në të ardhmen do të shikonte mundësinë e gjetjes së një apartamenti me çmim për më të katror pothuajse të njëjtë me atë të kontratës së datës 07.06.2013. Në kushtet e mësipërme, në datën 18.07.2018, është nënshkruar aktmarrëveshja “Për zgjidhjen e kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2013”, me shoqërinë “{***}” ShPK. Ndërkohë, në datën 22.03.2018, është nënshkruar kontrata e porosisë me shoqërinë “{***}” ShPK, për një apartament të ndodhur në të njëjtin kompleks ku ndodhej apartamenti objekt i kontratës së*

revokuar, por me sipërfaqe dhe mënyrë pagese ndryshe nga apartamenti i parë. Ky apartament është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2018 pranë ILDKPKI-së.

16.4 Nëpërmjet pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit është ftuar nga Komisioni të japë shpjegime për kohën dhe mënyrën e kthimit të shumës 30.000 euro bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe të vërë në dispozicion dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave për kryerjen e pagesës prej 30.000 eurosh në vitin 2013. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka sqaruar se si burim i të ardhurave të përdorura për pagesën prej 30.000 eurosh kanë shërbyer të ardhurat nga biznesi i bashkëshortit si avokat me NIPT-in përkatës, të mbartura dhe të vitit 2013. Revokimi i kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2013, si dhe kontrata e porosisë e vitit 2018, me shoqërinë “{***}” ShPK, ndonëse janë bërë me kontratë të shkruar dhe nënshkruar nga palët, ato nuk janë kryer nëpërmjet një akti noterial, pasi sipas nenit 83 të Kodit Civil, veprimet juridike të sipërcituara nuk kërkojnë formën noteriale për vlefshmërinë e tyre.

16.5 Nga dokumentacioni i gjendur në dosje, rezultojnë e administruar aktmarrëveshja, e pasqyruar në një shkresë të thjeshtë, të datës 18.07.2013, "Për zgjidhjen e kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2013", e lidhur ndërmjet porositësit Th. S. dhe përfaqësuesit të shoqërisë ndërtuese, sipas së cilës palët kanë rënë dakord që të zgjidhet kontrata e porosisë e datës 07.06.2013, kthimin e shumës së paguar prej 30.000 eurosh, si dhe në të ardhmen porositësi të ketë mundësi të blejë një apartament të ofruar nga sipërmarrësi afërsisht me të njëjtin çmim për m², të parashikuar në kontratën e porosisë së datës 07.06.2013. Gjithashtu në dosje gjendet e administruar edhe kontrata e porosisë, e pasqyruar në një shkresë të thjeshtë, të datës 22.03.2018, e lidhur ndërmjet personit të lidhur Th. S. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për porositjen e një apartamenti me sipërfaqe 82 m² dhe verandë 15 m², kundrejt çmimit 40.000 euro, çmim i cili do të paguhet 30.000 euro në momentin e dorëzimit të apartamentit dhe 10.000 euro në momentin e regjistrimit të pasurisë në ZRPP, transaksione të cilat nuk rezultojnë të jenë kryer ende. Komisioni, pasi i kërkoi dokumentacion shoqërisë “{***}” ShPK për dorëzimin e ndërtesës dhe procedurat e regjistrimit të saj, me shkresën kthim përgjigje të datës 23.06.2020, shoqëria “{***}” ShPK ka konfirmuar kryerjen e veprimeve si më sipër deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, duke bashkëngjitur edhe kontratat e sipërpërmendura, si dhe ka sqaruar se procedurat e regjistrimit të apartamentit në AShK nuk kanë përfunduar ende.

16.6 Lidhur me verifikimin e burimit të krijimit të shumës prej 30.000 eurosh, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 4, Komisioni administroi shkresën nr. {***} prot., datë 16.10.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila ka informuar se gjatë vitit 2013, Th. S. person fizik ka realizuar qarkullim/xhiro në masën 19.839.135 lekë (6.508.435 lekë si biznes i vogël dhe 13.330.700 lekë si biznes i madh) dhe fitim neto pas tatimit, në masën 14.431.491 lekë (4.554.509 lekë si biznes i vogël dhe 9.876.982 lekë si biznes i madh). Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, dhe të familjes së saj deri në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë dhe pagesës së shumës prej 30.000 eurosh, analizë e cila ka rezultuar me diferencë negative në shumën 2.661.037 lekë. Për këtë arsye, i njoftoi subjektin të rivlerësimit rezultatet e hetimit për këtë pasuri, duke i kaluar barrën e provës si në vijim.

(i) Duket se për kryerjen e pagesës prej 30.000 eurosh për porositjen e apartamentit në {***}, Vlorë, si dhe kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve të tjera deri në atë datë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 2.661.037 lekë.

[...]

(iii) Duket se revokimi i kontratës së porosisë së kësaj pasurie nuk është kryer me një akt noterial, për të provuar vullnetin e palëve lidhur me zgjidhjen e kësaj marrëdhënieje porosie.

16.7 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit në lidhje me pikën (i) më sipër, ka sqaruar se analiza financiare e lidhur me mundësinë e pagesës se shumës 30.000 euro, nuk mund të kryhet mbështetur në të ardhurat e deklaruara të biznesit. Të ardhurat nga biznesi i bashkëshortit tim, duke qenë person fizik kanë qenë të pandara nga të ardhurat familjare. Vetëm tërheqjet nga bankat për periudhën e analizuar janë në shumën 7.345.568 lekë, pa përfshirë këtu tërheqje të tjera në *cash* që bashkëshorti mund të ketë marrë nga arka e biznesit. Analiza financiare e kryer nga Komisioni nuk është e saktë, pasi nuk pasqyron aftësinë pagueuse deri në momentin e pagesës së shumës. Bashkëshorti, duke qenë i vetëpunësuar (person fizik), të gjitha të ardhurat që krijon i ka të tijat, personale, dhe ka të drejtën t'i përdorë në çdo kohë për nevoja vetjake. Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, në nenin 8 përcaktohet se kush është subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, ku shihet se personi fizik përjashtohet nga ky tatim dhe në nenin 16 përcaktohet se kush është subjekt i tatimit mbi fitimin, ku personi fizik mund të jetë subjekt nëse kalon kufirin minimal të xhiros vjetore të parashikuar në ligj. Subjekti sqaroi gjithashtu se në ndryshim nga ShPK-të ku të ardhurat e krijuara janë të shoqërisë dhe i administron administratori i zgjedhur dhe ato nuk mund të tërhiqen nga ortaku për përdorim personal, personi fizik i tërheq në çdo kohë.

16.8 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se revokimi i kontratës së porosisë nuk kërkon formën noteriale për të qenë i vlefshëm. Vullneti i palëve në një kontratë jo domosdoshmërisht provohet me akt noterial. Kodi Civil parashikon se cilat veprime juridike kërkojnë detyrimisht formën noteriale. Një kontratë porosie apo zgjidhja e saj nuk kërkohet nga Kodi Civil të bëhet me akt noterial për provueshmëri apo për të qenë e vlefshme.

16.9 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se, bazuar në analizimin e kryer nga Komisioni për "llogarinë e pronarit", referuar ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe formës së organizimit ligjor të njësisë ekonomike të biznesit, si biznes me një pronar i vetëpunësuar (person fizik), ndarja e veprimeve të njësisë ekonomike nga veprimet e karakterit personal të pronarit shpesh është e vështirë të dallohet. Veprimtaria ekonomike me një pronar është ligjërisht një zgjerim, shtrirje e pasurisë vetjake; pronari i njësisë ekonomike është ligjërisht pronari i të gjithave aktiveve të njësisë ekonomike dhe ka të drejtën ligjore t'i përdorë ato për nevoja personale. Subjekti parashtron se ligjërisht, në këtë formë të organizimit ligjor të njësive ekonomike të biznesit me të vetëpunësuar (person fizik), pronari përgjigjet për gjithçka dhe gëzon gjithçka që rrjedh nga njësia e tij, pra biznesi me një pronar është njësi ligjore e pandarë nga pronari i saj.

16.10 Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori fillimisht në shqyrtim verifikimin e deklarimeve të subjektit rreth ekzistencës dhe anulimit të kësaj kontrate, si elemente që do të vlejshëm për të vlerësuar në tërësi konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri. Siç u evidentua edhe më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontratën e porosisë, datë 07.06.2013, në DIPP-në e vitit 2013 dhe as në deklaratën *vetting*. Gjurmë të kësaj kontrate nuk gjenden as në ZRPP, për shkak të mosregjistrimit të saj në këta regjistra dhe evidentimi i saj prej Komisionit ka dalë vetëm nga hetimi administrativ, nëpërmjet marrjes së informacionit nga Regjistri Noterial Shqiptar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar mosdeklarimin e kësaj marrëdhënieje, së pari me mungesën e dijenisë dhe më pas, me faktin se ajo ishte revokuar një muaj pas lidhjes, në datën 07.06.2013, nëpërmjet një aktmarrëveshjeje të lidhur nëpërmjet një shkresë të thjeshtë mes palëve. Pjesë e këtyre ngjarjeve është edhe marrëdhënia e porosisë së lidhur mes të njëjtave palë në mars të vitit 2018, për porositjen e një apartamenti në të njëjtin kompleks, sërish të dokumentuar nëpërmjet një akti, shkresë e thjeshtë, ndonëse angazhimet kontraktuale duken të njëjta me ato të kontratës së parë të porosisë së lidhur para noterit në qershor të vitit 2013.

16.11 Në këtë situatë deklarimesh, trupi gjykues konstaton rrethana që nuk marrin një përgjigje bindëse prej subjektit të rivlerësimit lidhur me faktet e përshkruara më lart. Mosdeklarimi i kontratës së porosisë në DIPP-në e vitit 2013, për shkak të revokimit të saj brenda një muaji, me anë të një aktmarrëveshjeje, së cilës, duke mos pasur formën e aktit noterial, i zbehet besueshmëria/provueshmëria lidhur me kohën e hartimit, për sa kohë që nuk ka asnjë gjurmë të saj në ndonjë dokumentacion i cili mund ta konfirmonte atë përtej ndikimit të subjektit. Mbetet e pakuptueshme përse një kontratë e lidhur para noterit, e regjistruar në regjistrin noterial kombëtar, të revokohet me një akt të thjeshtë i cili nuk pasqyrohet në regjistrat publikë, aq më tepër kur palët janë subjekte deklaruese. Gjithashtu, edhe marrëdhënia e porosisë e lidhur në vitin 2018 për porositjen e ndërimit të një apartamenti të ri mes të njëjtave palë dhe në të njëjtin objekt, është e lidhur nëpërmjet një shkresë të thjeshtë, ndërsa kultura e kontratave të sipërmarrjes para noterit duket se është zhvilluar, aq më shumë për palë të cilat e kanë ndërtuar marrëdhënien si të tillë që në vitin 2013. Përveç elementit të formës, sipas kësaj kontrate, konstatohet se nuk rezultoi të jetë kryer asnjë pagesë për apartamentin e porositur, që do të kryheshin vetëm pas dorëzimit dhe regjistrimit të apartamentit, edhe ky një parashikim jashtë logjikës të një ekonomie të tregut. Kjo situatë lidhur me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe mungesat në anën formale të akteve të analizuar, sillen në vëmendje si një element që do të shoqërojë në vijim edhe analizën për verifikimin e burimeve të financimit të këtij apartamenti, të kontraktuar në qershor të vitit 2013.

16.12. Krahas analizës së mësipërme, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kontrollon analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me burimet e financimit, në vlerën prej 30.000 eurosh, të këtij apartamenti në momentin e kryerjes së pagesës, e cila, sipas kontratës së sipërmarrjes, rezultoi të jetë qershori i vitit 2013. Lidhur me këtë çështje, trupi gjykues, nga verifikimi në faqen *online* të QKB-së, i të dhënave të bilancit financiar të personit fizik, në emër të personit të lidhur, për periudhën janar – prill 2013, konstaton se është tërhequr prej tij shuma prej 4.554.510 lekësh nga arka e personit fizik. Në Komision, subjekti i rivlerësimit

ka pretenduar se kjo paraqitje në pasqyra financiare ka ndodhur për shkak të një gabimi të kryer nga kontabilisti, i cili i ka përgatitur këto pasqyra financiare, për këtë arsye subjekti pretendon se fitimi i vitit 2013 është tërhequr dhe përdorur nga bashkëshorti i saj.

16.13 Ndonëse mbahet në konsideratë se në aktivitetin tregtar mund të ndodhë që llogaritë e personit fizik të përzihen me ato personale, udhëzimet për regjistrimet e veprimeve kontabël sipas legjislacionit përkatës, kërkojnë pasqyrim me vërtetësi dhe besueshmëri të veprimeve financiare të njësisë ekonomike. Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare të vitit 2013 për personin fizik në emër të bashkëshortit të subjektit, rezulton se gjatë vitit 2013, ai ka realizuar fitim në vlerën 4.554.510 lekë si biznes i vogël, për periudhën janar – prill 2013, dhe 9.621.542 lekë si biznes i madh, për periudhën maj – dhjetor 2013. Nga të dhënat e pasqyrave financiare për periudhën janar - prill 2013, rezulton se vetëm fitimi prej 4.554.510 lekësh, realizuar deri në këtë moment, është tërhequr nga pronari i njësisë tregtare. Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit të detajuar të arkës, si dhe pasjes vetëm të këtij informacioni rreth tërheqjes së fitimit, sipas deklarimeve të personit fizik, nuk mund të evidentohet se kur janë kryer pagesa të tjera të cilat afektojnë gjendjen e arkës, përfshirë këtu edhe pagesën e tatimit mbi fitimin. Nga subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë dokument i cili të provojë tërheqjen nga arka e “personit fizik” të shumës 30.000 euro për prenotimin e apartamentit objekt kontrolli. Gjithashtu nuk është paraqitur ndonjë libër arke në të cilin të jenë specifikuar detajime të tërheqjeve apo lëvizjeve monetare nga arka e personit fizik dhe, në këto kushte, mbetet e paprovuar shuma e pretenduar si e tërhequr në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se shuma prej 1.888.950 lekësh, që përfaqëson shumën e detyrimeve tatimore të subjektit tregtar person fizik, të cilat subjekti pretendoi se paguhen vitin pasardhës, dhe që në momentin e kryerjes së pagesës për blerjen e apartamentit kanë qenë gjendje të personi fizik, të destinuara për të paguar detyrimet tatimore, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht se ky shpenzim ishte akoma i papaguar nga bashkëshorti i subjektit, kjo shumë ndërsa kishte një destinacion të përcaktuar në dokumentacionin financiar, nuk rezulton/provohet të ketë shërbyer ndërkohë për të plotësuar nevoja të tjera monetare të subjektit të rivlerësimit.

16.14 Situata e mësipërme rreth përdorimit të likuiditeve të personit fizik, është e vendosur në kontekstin e mungesës së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me momentin e lidhjes së kontratës e kryerjes së pagesës prej 30.000 eurosh, si edhe në dritën e çështjeve të ngritura rreth formës së revokimit të kësaj kontrate apo formës së lidhjes së kontratës së re të porosisë në vitin 2018, si edhe modaliteteve të kryerjes së pagesave për këtë porosi të re. Në të njëjtën logjikë, edhe pretendimi për përdorimin e fitimit të realizuar në muajin maj, si pjesë e fitimit prej 9.621.542 lekësh, për periudhën maj - dhjetor 2013, e rezultuar në pasqyrat financiare si fitim i biznesit të bashkëshortit të subjektit, ndërsa referuar po këtyre pasqyrave ka shërbyer për rritjen e kapitalit të pronarit të njësisë ekonomike, mbetet sërish një pretendim i paprovuar me dokumentacionin ligjor. Për më tepër, vetë subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë kontradiktore dhe i paqartë rreth përdorimit të këtyre fondeve, në kushtet që në prapësimet mbi rezultatet e hetimit të Komisionit ka përfunduar analizën financiare me diferencën pozitive prej 16.808.493 lekësh, ndërsa në ankim ka paraqitur një analizë financiare me diferencë pozitive në shumën 82.115 lekë, rrethana që e bëjnë edhe më

të ndërlikuar mbajtjen e një qëndrimi të ndryshëm nga Komisioni rreth përdorimit të likuiditeteve të arkës sipas pretendimit të subjektit.

16.15 Në funksion të analizës së këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vlerëson se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, megjithëse kishte mjaftueshëm likuiditete në arkën e personit fizik, nga verifikimi i kryer në pasqyrat financiare, nuk rezultoi se këto likuiditete i ka tërhequr nga arka. Mostërheqja e tyre prej pronarit të aktivitetit konfirmohet edhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e rrjedhjes së flukseve monetare, nga ku është konstatuar se, ndonëse detyrimet tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i bashkëshortit, janë paguar më pas, ato të ardhura, referuar disa prej pasqyrave financiare të dorëzuara në organet tatimore, nuk kanë qenë të disponueshme për përdorim personal/familjar, për sa kohë aty është përshkruar shprehimisht vijueshmëria e pasjes së shumave të fituara, si të ruajtura dhe jo të përdorura. Në konsideratë edhe të jurisprudencës²⁵ së Kolegjit, kjo pasuri/gjendje likuiditeti do t'i takonte ekonomisë së biznesit të bashkëshortit të subjektit dhe jo njësisë familjare të subjektit, por vlerësimi i saj do të duhej të kryhej nga organet e ngarkuara me kontrollin e aktivitetit ekonomik, për sa kohë që i nënshtrohet regjimit të personit fizik dhe përdoret për qëllime të ushtrimit të aktivitetit privat që ushtron bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në mungesë të një vlerësimi të tillë, i cili do të përcaktonte saktësisht shpenzimet për ekonominë familjare dhe ato për biznesin, trupi gjykues mundet të konsiderojë në funksion të këtij arsyetimi, vetëm të dhënat e dokumenteve financiare të biznesit, të cilat përmbajnë të dhënat e analizuara më sipër dhe nuk mbështesin pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përdorimin apriori të llogarive të biznesit për nevoja familjare. Trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se, duke qenë se biznesi i përkiste personit të lidhur, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të provonte qartësisht lëvizjet e këtyre llogarive dhe se ato kanë mbështetur ekonominë familjare, qoftë nëpërmjet deklarimeve në DIPP, apo nëpërmjet dokumentacionit financiar të personit fizik.

16.16 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me analizën financiare që i përket kontrollit të kësaj pasurie të krijuar në maj të vitit 2013, ngriti në Kolegj pretendime edhe mbi mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të kartës së kreditit VISA në Tirana Bank, nga Komisioni. Trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, verifikoi metodologjinë e përdorur nga Komisioni lidhur me pasqyrimin e efektit financiar në analizë të përdorimit të kartës së kreditit. Nga ky verifikim, rezultoi se Komisioni ka konsideruar në analizë, në zërin e të ardhurave, të gjitha tërheqjet e kryera nga karta e kreditit nga bashkëshorti dhe të gjitha shlyerjet e kryera nga ana e tij në zërin shpenzime, pa vendosur dhe konsideruar në të gjendjet e llogarive bankare në fillim të vitit dhe ato deri në muajin maj, periudhë në të cilën përmbillet analiza financiare për këtë pasuri. Këto defekte të konstatuara në analizën financiare të Komisionit, u korrektojnë në analizën e kryer nga Kolegji për këtë periudhë, korrektim i cili modifikoi ndër të tjera rezultatin financiar lidhur me krijimin e kësaj pasurie.

²⁵ *Vendimet e Kolegjit nr. 31/2021 (JR), datë 12.10.2021 (G. Brahimllari); nr. 27/2023 (JR), datë 05.07.2023 (E. Haxhira).*

16.17 Nga kontrolli që trupi gjykues ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit për periudhën janar – maj 2013, mbështetur në argumentet e mësipërme, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e shumës 30.000 euro për prenotimin e apartamentit dhe të përballonte shpenzimet, për diferencën negative në shumën 2.147.974 lekë. Trupi gjykues e vlerësoi këtë balancë negative lidhur me investimin e kryer nga familja e subjektit në muajin maj 2013 për porositjen e apartamentit në fjalë, krahas problematikave dhe çështjeve të ngritura rreth mungesës së deklarimit mbi këtë pasuri, si edhe formës së hartimit të akteve që dokumentojnë veprimet juridike mes palëve, e që, sipas subjektit, përlligjin mosdeklarimin e saj. Sa më sipër, u konkludua se mungesa burimeve në këtë rast, vlerësohet edhe si pasojë e sjelljes së subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, karshi provueshmërisë së pretendimeve e shpjegimeve që ajo jep, si për ekzistencën e marrëdhënieve juridike, ashtu edhe për përdorimin e likuiditeteve të personit fizik, në emër të bashkëshortit, sjellje e cila e pamundëson trupin gjykues t’u japë besueshmëri deklarimeve të saj rreth përdorimit të këtyre gjendjeve, në mungesë të dokumentimit të tyre, e për pasojë, e kualifikon subjektin se gjendet edhe në momentin e pagimit të çmimit për këtë pasuri, në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

17. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton si jo të drejtë analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2006, 2015 dhe 2016, Kolegji konstaton dhe analizon sa vijon.

17.1 Në vendimin e Komisionit për këto vite, pas kalimit të barrës së provës dhe përcjelljes së provave/shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, është konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë financiare negative për vitin 2006, në masën (-) 1.916.644 lekë.

i. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, ka kontestuar fillimisht analizën financiare të kryer në Komision për vitin 2006 lidhur me ngarkimin e kësaj analize me shpenzime për mobilim në vlerën prej 400.000 lekësh, për apartamentin e ndodhur në vendin e quajtur “{***}”, Kavajë, duke pretenduar se ajo këtë vlerë e ka shpenzuar në vitin 2009, referuar edhe përgjigjeve që ajo ka dhënë në pyetësorët përkatës lidhur me këtë moment. Trupi gjykues, nga kontrolli i kryer në analizën e Komisionit, konstatoi se këto shpenzime janë përlllogaritur edhe në analizën e vitit 2006, edhe në analizën e vitit 2009. Duke qenë se këto shpenzime i përkasin një pasurie të krijuar në vitin 2009, ato logjikshëm nuk mund të përlllogariten në analizën financiare të vitit 2006, siç ka bërë Komisioni, si rrjedhojë këto shpenzime u konsideruan të përfshira sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të vitit 2009.

ii. Subjekti të rivlerësimit ka kontestuar në analizën e vitit 2006 edhe përlllogaritjen e të ardhurave të bashkëshortit nga punësimi përgjatë këtij viti. Në analizë të këtij pretendimi, u konstatua se në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pranë Raiffeisen Bank, ka pasur kreditime nga pagat dhe burime të përshkruara si “Honorare” apo “Shpërblime”. Në total, të gjitha kreditimet nga këto burime për vitin 2006, kanë rezultuar në shumën 2.014.972 lekë. Pavarësisht se këto kreditime në llogarinë bankare nuk kanë përshkrimin se nga cili subjekt janë kryer e, për këtë arsye, nuk identifikohen qartësisht të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, janë përfshirë në

të ardhurat e bashkëshortit në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin 2006, sipas pretendimit të subjektit.

iii. Trupi gjykues vlerësoi edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, lidhur me moskonsiderimin si shpenzim të vlerës së përllëguaritur për udhëtimet jashtë vendit të bashkëshortit të saj, në vitin 2006 në shumën prej 3.315 eurosh, si dhe në vitin 2007 në shumën prej 2.254 eurosh, kohë kur ai ushtronte funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat ishin kryer për shkak të detyrës së tij. Lidhur me këtë pretendim, subjekti shpjegoi se për shkak të kohës së largët, nuk ka arritur të gjejë dokumentacion justifikues për përballimin e tyre prej organizatave ftuese të bashkëshortit. Trupi gjykues, mbështetur në jurisprudencën²⁶ e tij të deritanishme, në mungesë të dokumentacionit justifikues, e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos zbritur nga zëri shpenzime, këto vlera. Pavarësisht këtij qëndrimi, trupi gjykues, në vlerësimin në tërësi që i bëri kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe balancës negative që rezultoi në finale nga ky vlerësim, pati në konsideratë edhe versionin garantist, sipas të cilit, shpenzimet e pretenduara për udhëtim në këto vite të mos t'i ngarkoheshin analizës financiare, duke pasur në konsideratë specifikat dhe profilin e lartë të detyrës së ushtruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Siç mund të konstatohet në vijim, edhe ky vlerësim garantist nuk e çliron subjektin nga një balancë negative në drejtim të burimeve të ligjshme, që mbetet gjithsesi përcaktuese për vlerësimin përfundimtar të këtij kriteri.

iv. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2004, në vlerën 600.000 lekë në vitin 2005 dhe 900.000 lekë në vitin 2006, trupi gjykues mbajti të njëjtin qëndrim të konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij, se nuk mund të merrej në konsideratë, në kushtet kur në deklaratat periodike vjetore, si të vetmet dokumente provuese, ku ky veprim mund të kishte lënë gjurmë, nuk ka asnjë deklaram të tillë.

v. Në përfundim të konkluzioneve të mësipërme, pasi vlerësoi lidhur me analizën financiare të vitit 2006, trupi gjykues arriti në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni për sa i përket balancës negative të këtij viti, nga (-) 1.916.644 lekë të nxjerrë prej tij, në vlerën prej (-) 1.348.879 lekësh. Kjo balancë do të ulej me vlerën prej 3113 eurosh në rast të zbritjes së shpenzimeve të udhëtimit të bashkëshortit, duke konfirmuar sërish një balancë negative të konsiderueshme për këtë vit.

17.2 Lidhur me analizën financiare të vitit 2015, sipas së cilës në vendimin e Komisionit është përcaktuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një balancë negative në vlerën prej 1.502.271 lekësh për vitin 2015, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat në thelb dhe fillimisht kontestojnë analizën për shkak të padijenisë së metodologjisë së përdorur nga Komisioni për hartimin e saj dhe, më pas, për elemente të ngritura rishtas në ankim, të cilat e kontestojnë analizën në pikëpamjen e shifrave dhe qëndrimeve të mbajtura lidhur me përdorimin e gjendjes së arkës, përdorimin e kartave të kreditit, përdorimin e një kredie të marrë nga ekonomia e personit fizik, si edhe pagën e vajzës së subjektit të rivlerësimit.

²⁶ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019; nr. 27/2020 (JR), datë 22.10.2020; etj.

i. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk i janë kërkuar shpjegime nga Komisioni për diferencat negative të viteve 2015 dhe 2016, duke mos iu vënë në dispozicion metodologjia e ndjekur për krijimin e analizës financiare me qëllim që të ndërtonte një mbrojtje efektive duke u konsultuar me ekspertë të fushës, përveç sa është analizuar më lart në këtë vendim, në analizë të shkaqeve që lidhen me procesin e rregullt ligjor, trupi gjykues vëren se, së bashku me rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit analizën financiare për periudhën 2003-2016, së bashku me shpjegimet e mënyrës së hartimit të kësaj analize. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, së bashku me parashtrimet, në përgjigje të rezultateve, ka paraqitur një analizë financiare të re të kësaj periudhe, mbështetur në qëndrimet e saj për zërat e analizës financiare, sipas së cilës vitet 2015 dhe 2016 kanë rezultate pozitive, çka provon se subjekti i rivlerësimit është njohur me rezultatin negativ të këtyre viteve, si edhe metodologjinë bashkangjitur analizës, pjesë e aktit “Relacion për rezultatet paraprake të hetimit”²⁷, duke korigjuar këto rezultate pas dorëzimit të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit.

ii. Pavarësisht se disa nga pretendimet janë ngritur për herë të parë në ankim, trupi gjykues mori në shqyrtim kontestimet e subjektit për secilin zë të analizës financiare të vitit 2015, duke arsyetuar si në vijim. Në lidhje me pretendimin e ngritur për herë të parë në ankim, për ta konsideruar si të ardhur të ekonomisë familjare të vitit 2015, një kredi të marrë nga bashkëshorti i saj në Credins Bank, si person fizik, pasi ka shërbyer për të plotësuar shpenzimet familjare, trupi gjykues konstatoi se në dokumentacionin bankar të administruar në dosje, gjendet përgjigja²⁸ e Bankës Credins, e cila informon në lidhje me llogaritë e aktivitetit privat si person fizik të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij akti, në llogarinë me nr. {***} të personit fizik të bashkëshortit, rezultoi se në datën 15.09.2015, është disbursuar kredia në vlerën 1.500.000 lekë, për qëllime të shlyerjes së detyrimeve tatimore, e cila pas disbursimit është tërhequr *cash*. Me dokumentacionin e administruar në dosje, nuk provohet që kredia të jetë përdorur për të plotësuar nevojat e familjes së subjektit të rivlerësimit, pasi kredia është marrë nga bashkëshorti i subjektit si person fizik, duke u disbursuar në llogari të aktivitetit tregtar, si rrjedhojë nuk u konsiderua kjo shumë si e ardhur e vitit 2015 për familjen e subjektit dhe me të njëjtën logjikë, nuk u konsiderua si shpenzim familjar as shlyerja e kësaj kredie në analizën financiare të vitit 2015.

iii. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vajza e saj A. S. ka përfituar të ardhura më të larta se ato të llogaritura nga Komisioni, nga verifikimi i të dhënave në pasqyrën e llogarisë me nr. {***} në Raiffeisen Bank, rezultoi se kjo llogari është kredituar me përshkrimin “pagë” gjatë vitit 2015, në shumën 832.828 lekë, ndërsa Komisioni ka llogaritur për vajzën e subjektit të ardhura në vitin 2015, në shumën 794.750 lekë. Në këto kushte, në referim të të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni bankar, trupi gjykues korrektoi analizën financiare të këtij viti me vlerën e saktë të përfituar prej vajzës së subjektit dhe të pretenduar prej këtij të fundit.

²⁷ Faqe 59-61 e rezultateve të hetimit në Komision.

²⁸ Shkresa e Credins Bank me nr. {***} prot., datë 08.11.2019.

iv. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e paraqitur vetëm me ankimin në Kolegj, se për shpenzimet e shlyerjes së kredisë së marrë në vitin 2013 në Tirana Bank, për blerjen e apartamenteve dhe shlyerjes së huasë ndaj K. P. (vlera e kredisë 193.000 euro), në shumën prej 1.909.285 lekësh në vitin 2015, janë paguar dhe deklaruar si shpenzim në pasqyrat financiare të aktivitetit tregtar të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në zërin “Shpenzime të panjohura”, në vlerën 1.932.307 lekë, për pasojë nuk duhet t’i ngarkohen analizës financiare të familjes. Në pasqyrat financiare të aktivitetit të bashkëshortit, ekzistonte zëri “Detyrime”, i përcaktuar për pasqyrimin e detyrimeve ndaj bankave dhe në këta zëra nuk gjendet i pasqyruar shpenzimi për kredinë në Bankën Tirana në vitin 2015. Si rrjedhojë, mbetet e paqartë nëse vlera e pretenduar, prej 1.932.307 lekësh, si shpenzim i panjohur përfshin shpenzimet e kredisë, të cilat rezultojnë të paguara nga llogaria personale e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i të dhënave bankare, rezultoi se kjo kredi është shlyer nga llogaria personale e bashkëshortit të subjektit, si rrjedhojë është e pamundur të identifikohet se vlera e shpenzuar për shlyerjen e kredisë ka derivuar nga të ardhurat e biznesit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për më tepër që kredia është marrë për blerje pasurie familjare, si rrjedhojë shlyerja e saj do të duhej t’i ngarkohej sërish ekonomisë familjare dhe nuk mund të përfshihet në shpenzimet për qëllime të aktivitetit tregtar. Sa më sipër, trupi gjykues nuk e gjeti të gabuar qëndrimin e Komisionit sipas të cilit shpenzimet për shlyerjen e kredisë në vitin 2015, i ka përfshirë në analizën financiare të këtij viti.

v. Në lidhje me shpenzimet e kryera me kartë krediti, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se tërheqjet e kryera nga kjo kartë kanë shërbyer për të mbuluar shpenzime jetese dhe, për pasojë, nuk duhet të përlllogariten si shpenzime shtesë, por të përfshihen/përthithen nga shpenzimet e jetesës. Trupi gjykues vëren se në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit në analizën financiare nuk e ka kundërshtuar vlerën e shpenzimeve të kartës së kreditit, por ka lënë të njëjtën vlerë shpenzimi si edhe Komisioni. Pavarësisht kësaj situatë lidhur me pretendimet e ngritura rishtas në ankim, trupi gjykues verifikoi gjendjen e llogarisë së kartës së kreditit, sipas pretendimeve të subjektit, dhe nga ky proces i rezultoi se Komisioni, në zërin “Shpenzime” të analizës financiare për kartën e kreditit, ka vendosur vetëm shlyerjet që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka bërë për llogari të përdorimit të kartës dhe kthimit të “borxhit” bankës kredituese dhe nuk ka përfshirë në analizë si të ardhura shumë të tërhequra/marra prej saj, të cilat kanë qenë të hyra në ekonominë familjare. Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pabazuar e të paprovuar pretendimin e subjektit se shumë të tërhequra prej kartës duhet të përlllogariten se kanë mbuluar shpenzimet për jetesë të familjes, për shkak të faktit se nga një këqyrje e veprimeve financiare të kartës, rezultoi se shumë të shpenzuara nuk kanë shërbyer për përbalimin e shpenzimeve për jetesë, dhe për ato të tërhequra është e pamundur të verifikohet destinacioni i tyre, për të konkluduar nëse këto tërheqje kanë mbuluar shpenzime jetese të familjes së subjektit të rivlerësimit, por, edhe për shkak të faktit se kartat e kreditit, duke qenë karta huaje, nuk debitohen si rregull për shpenzime të jetesës, por për shpenzime ekstra. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues korrektoi në analizën financiare të Komisionit, zërin “Të ardhura”, në të cilin u përfshinë edhe shumë të tërhequra apo debituar prej kartës së kreditit, si vlera monetare që kanë hyrë në ekonominë familjare, ndonëse jo të dedikuara posaçërisht shpenzimeve të jetesës.

vi. Nga kontrolli që trupi gjykues ushtroi ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke reflektuar konkluzionet e mësipërme, rezultoi një balancë e ndryshme financiare, ndonëse sërish negative, nga vlera prej (-) 1.502.271 lekësh në vlerën prej (-) 993.494 lekësh, e cila u konsiderua në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

17.3 Lidhur me analizën financiare të vitit 2016, sipas së cilës Komisioni ka konkluduar se subjekti ka një balancë negative për të mbuluar krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera në vlerën prej (-) 1.556.025 lekësh, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, për secilin zë të analizës financiare të kontestuar prej saj, pavarësisht faktit se këto pretendime, ashtu si edhe për vitin 2015, ishin ngritur për herë të parë në ankim.

i. Subjekti i rivlerësimit ka ngritur të njëjtin pretendim me atë që i përket vitit 2015, të analizuar më sipër, lidhur me përllogaritjen e pagës së vajzës së saj për këtë vit. Nga verifikimi i këtij pretendimi në dokumentacionin bankar, trupi gjykues konstatoi të njëjtën problematikë si për vitin 2015. Nga të dhënat e pasqyrës së llogarisë me nr.1215692 në Raiffeisen Bank Albania, në emër të vajzës së subjektit, rezultoi se kjo llogari është kredituar me përshkrimin “pagë” gjatë vitit 2016, në shumën 929.161 lekë, ndërsa Komisioni ka llogaritur të ardhura për të vetëm shumën 796.212 lekë. Në të njëjtat kushte e mbështetur në të njëjtën logjikë, trupi gjykues korrektoi analizën e Komisionit për këtë zë duke reflektuar në të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni bankar.

ii. Trupi gjykues vlerësoi në të njëjtën mënyrë edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet e kartës së kreditit për këtë vit, duke mos pranuar si të provuar pretendimin se ato u përkasin shpenzimeve të jetesës, por duke korrektoar në analizën e Komisionit në të njëjtën mënyrë si për vitin 2015, përfshirjen në zërin “Të ardhura”, të shumave të shpenzuara prej kartës, për sa kohë në këtë analizë gjenin pasqyrim vetëm shlyerjet e bëra nga bashkëshorti i subjektit për debitë e krijuara ndaj bankës prej përdorimit të kartës

iii. Në lidhje me pretendimin që të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit për vitin 2016, të cilat subjekti ka pretenduar se kanë rezultuar në një fitim në shumën 41.492.322 lekë, duhet të përfshihen në të ardhurat në dispozicion të ekonomisë familjare, trupi gjykues analizoi të dhënat e dokumentacionit fiskal të gjendura në aktet e depozituara lidhur me aktivitetin e personit fizik. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ky fitim gabimisht është përshkruar se ndodhet në gjendjen e arkës së personit fizik, por në të vërtetë ai është tërhequr prej bashkëshortit përgjatë vitit për përballimin e shpenzimeve të ndryshme familjare, duke pasur në konsideratë faktin se personi fizik dhe individi kanë elemente të përbashkëta, të tilla që e bëjnë të vështirë një ndarje të vërtetë mes llogarive të tyre. Sipas pretendimit të subjektit, ky gabim është ndrequr në pasqyrat financiare të vitit 2017.

Nga analizimi i të dhënave të përfuara prej dokumentacionit të administruar, rezultoi se, sipas pasqyrave financiare të personit fizik në emër të bashkëshortit, fitimi i deklaruar nga aktiviteti i vitit 2016, në vlerën prej 41.492.322 lekësh, gjendet në arkën e personit fizik dhe nuk është tërhequr prej tij. Përveç pasqyrave financiare të publikuara në faqen zyrtare të QKB-së, në këtë faqe gjendet edhe materiali sqarues i hartimit të këtyre pasqyrave për vitin 2016, i cili është sigluar nga kontabilisti dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në këtë material, në pikën 3

pasqyrohen veprimet për aktivet monetare (likuiditete në arkë dhe bankë) në datën 31.12.2016. Sipas këtij materiali, konfirmohet se të dhënat janë nxjerrë nga llogaritë bankare dhe inventarët fizikë të monedhave. Sipas këtij dokumentacioni, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka tërhequr fitimin e vitit 2016, por e ka gjendje në arkën e personit fizik. Këto të dhëna të nxjerra nga dokumentacioni ligjor i hartuar dhe nënshkruar edhe prej bashkëshortit të subjektit, vlerësohen se përbëjnë një të dhënë që nuk mund të kontestohet vetëm mbi deklaratimet e subjektit gjatë procesit apo me ndreqjen e pasqyrave në vitet pasardhëse, pavarësisht nga identifikimi i vijave të qarta ndarëse mes llogarive të personit fizik dhe individit. Në këtë arsyetim, trupi gjykues ka parasysh edhe disa veçori të aktivitetit të bashkëshortit të subjektit, i cili, siç rezultoi edhe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, në rubrikën “Gjetje”²⁹, ka pasur një dinamikë në aktivitetin e tij të orientuar jo vetëm në drejtim të mbrojtjes ligjore, por edhe me interesa financiare e investime apo marrëdhënie huaje/bashkinvestitore në fushën e ndërtimeve, elemente që krijojnë një panoramë jo shumë të thjeshtë e të lexueshme të aktivitetit financiar të personit fizik. Me fjalë të tjera, rezultoi e vështirë të arrihet qartësia mbi objektin e veprimtarisë së personit të lidhur, gama e shtrirjes së tij dhe natyra e veprimeve financiare të kryera në këtë kontekst. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se e dhëna që del nga dokumentacioni ligjor, që këto para edhe pse janë deklaruar gjendje në arkë, në të vërtetë nuk ishin gjendje, për shkak të mospasjes së një ndarjeje të qartë mes personalitetit juridik të individit dhe personit fizik, mbetet një argument i dobët dhe i pamjaftueshëm, për të përmbysur apo vënë në dyshimin informacionin zyrtar, në kuadër të panoramës së përgjithshme të aktivitetit.

iv. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, trupi gjykues korrektoi analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2016, dhe nga analiza e kryer rezultoi sërish një balancë negative e ndryshme nga ajo e nxjerrë prej tij, nga vlera prej (-)1.556.025 lekësh, në vlerën prej (-) 692.684 lekësh.

17.4 Në përfundim të sa më sipër, në analizën financiare për vitet 2006, 2015 dhe 2016, nga kontrolli që trupi gjykues ushtroi ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, mbështetur në

²⁹- Aktmarrëveshje e datës 07.01.2015, e lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK dhe Th. S. person fizik. Referuar kësaj aktmarrëveshjeje, A. R. kishte investuar në ndërtimin e një kompleksi ndërtesash, për të cilin kishte nënshkruar dhe marrëveshjet me pronarët e truallit. Në përfundim të ndërtimeve, Th. S. do të përfitonte një shumë nga fitimet e realizuara, në përputhje me shumën totale të investimit dhe, në rast se do të rezultonte pa fitim, shoqëria “{***}” do t’i kthente pas shumën e investuar prej 200.000 USD.

- Në datën 17.07.2017, z. L. L. ka transferuar në llogarinë e përbashkët të subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin, shumën 100.000 euro, me përshkrimin: “Borxh deri në 30 tetor 2017”.

- Në datën 29.07.2015, N. L. person fizik ka transferuar në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumën prej 10.000.000 lekësh, me përshkrimin: “Shlyerje detyrimi”.

- Në datën 21.07.2014, znj. J. S. ka transferuar shumën prej 2.700.000 lekësh në llogari të bashkëshortit, me përshkrimin: “Dhënie borxhi personal”.

- Në datën 04.03.2015, janë transferuar në llogari të bashkëshortit të subjektit, pranë Bankës Tirana, shuma prej 19.975 eurosh nga B/O Qarri me përshkrimin: “Prestito”.

- Në datën 23.09.2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka transferuar në llogari të shtetasit H. G., shumën prej 4.200.000 lekësh, me përshkrimin: “Kalim sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol.”.

- Në datën 12.02.2015, shtetasi Y. E. S. A. A. E. E. ka transferuar nëpërmjet Unionit Financiar Tiranë (Western Union), shumën prej 11.650 euro, në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

pretendimet e subjektit, edhe pse të paraqitura për herë të parë në ankim, rezultoi sërish se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe përballuar shpenzimet në këto vite, duke e vendosur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. Si rrjedhojë e konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për shkak se rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar pasuritë dhe përballuar shpenzimet, si vijojnë: (i) për pasurinë “apartament banimi me sip. 195 m²” dhe “garazh me sip. 22,2 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, subjekti i rivlerësimit nuk provoi ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 25.000 USD, paguar prej babait të saj, për shkak se ky i fundit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj; (ii) për pasurinë “dy apartamente banimi me sipërfaqe 184,2 m² dhe 82,4 m²”, si dhe “tri garazhe me sipërfaqe përkatësisht 21,93 m², 15,95 m² dhe 15,08 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, kompleksi “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 100.000 eurosh, të marrë hua prej z. K. P. dhe të përdorur për kryerjen e pagesave në vitin 2013; (iii) për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 57 m²” dhe “verandë me sipërfaqe 31 m²”, ndodhur në {***}, Vlorë, rezultoi se për periudhën janar - maj 2013, subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e shumës 30.000 euro, për diferencën negative prej (-) 2.147.974 lekësh; (iv) nga analiza financiare për vitin 2006, rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 1.348.879 lekë; për vitin 2015, rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 993.494 lekë; dhe për vitin 2016, rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 692.684 lekë.
19. Krahas qëndrimeve të mësipërme, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe konkluzionet e Komisionit në çështjet për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkaqe ankimore³⁰, duke konfirmuar qëndrimet e Komisionit lidhur me to e duke i bërë ato pjesë të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë
20. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 416, datë 08.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

³⁰ (i) Pasaktësi në deklarimin e subjektit në deklaratën “vetting”, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë automjet, tip “Toyota”, me targë {***}.

(ii) Pasaktësi në deklarimin e subjektit në deklaratën “vetting”, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targë {***}.

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 416, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.02.2024.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, parashtroj mendimin tim paralel, lidhur me vendimin nr. 9 (JR), datë 28.02.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen (JR) nr. 56, datë 11.10.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Zegjine Sollaku, për disa momente për të cilat nuk jam dakord me arsyetimin dhe konkluzionin e shumicës.

*1. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 195 m² dhe garazh me sipërfaqe 22,2 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, ka pretenduar se marrëdhënia ndërmjet saj dhe babait nuk ka qenë marrëdhënie interesi, e krijuar nga një marrëdhënie biznesi, dhurimi apo huaje e, për rrjedhojë, ai nuk mund të kualifikohet person i lidhur apo person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit pretendon se edhe nëse babai i saj do të konsiderohet si person tjetër i lidhur, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, rezulton se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar pagesën e shumës prej 25.000 USD, për porositjen e apartamentit nëpërmjet kontratës së datës 21.07.2001.

2.1. Komisioni ka konkluduar se, për sa kohë ky i fundit ka kryer pagesa të pretenduara nga të ardhurat e tij, të cilat më pas janë përlllogaritur si pjesë përbërëse e çmimit total të pasurive të përfituara nga subjekti dhe familja e saj, bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, por edhe në jurisprudencën e deritanishme të procesit të rivlerësimit, pikërisht për këtë shkak-pasojë detyrimisht duhet të analizohen burimet financiare të shtetasit T. Ç. – kjo pavarësisht paqartësisë dhe mosdeklarimit nga subjekti mbi tipologjinë e përfitimit të shumës prej 25.000 USD nga të ardhurat e babait të saj. Nëse ato janë kthyer apo do të kthehen, gjendemi përballë një huadhënieje, ndonëse e padeklaruar si e tillë, dhe në rast moskthimi të shumave të përfituara, marrëdhënia financiare e lartpërshkruar do të futej pa dyshim në kornizën e një dhurimi. Kësisoj, në çdo rast, mbetet detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar burimet e ligjshme të shumave monetare të përfituara dhe të përdorura/konsideruara si pjesë e çmimit të pasurisë së saj.

2.2. Sikurse rezulton nga analizimi i vendimit të arsyetuar, shumica e trupit gjykues, edhe në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ka mbështetur dhe miratuar konkluzionin e Komisionit në vendim, paragrafi 14.13, duke u shprehur se: [...] e sheh me vend, duke përshkruar të gjitha rrethanat e faktit të cituara më lart, t'i kualifikojë ato si elemente që përbëjnë një marrëdhënie me tipare të forta huaje, nga ato që i nënshtrohen kontrollit të burimit të krijimit sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Krahas këtij arsyetimi, trupi gjykues çmon të nënvizojë se detyrimi i subjektit për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume, vjen edhe në zbatim të drejtpërdrejtë të parashikimit kushtetues për të provuar bindshëm burimet e krijimit të pasurisë sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht se nga gjenerohet ai. Përderisa në kuptimin ligjor, transaksioni i kryer me babain e saj në funksion të financimit të shumës prej 30.000 eurosh, nuk mund të kualifikohet se ka ndodhur për shkak të kontratave të premtim shitjes dhe shitjes me rezervë, sipas arsyetimit më sipër dhe në këndvështrim të dispozitave kushtetuese dhe

ligjore, i vetmi kualifikim adekuat me rrethanat e faktit në kuadër të procesit të rivlerësimit, është njohja e statusit të personit tjetër të lidhur për babain e saj, z. T. Ç.

2.3. Unë, gjyqtarja me mendim paralel, çmoj se kualifikimi i babait të subjektit të rivlerësimit si person tjetër i lidhur, duhet të jetë rezultat i një analizimi të tillë të situatës faktike dhe akteve në dosjen gjyqësore, që marrëdhënia e krijuar mes tyre të gjejë veten në një nga kërkesat e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016³¹. Kjo dispozitë ligjore parashikon si një parakusht për lindjen e detyrimit për provimin e burimeve të ligjshme prej personit tjetër të lidhur, deklarin e një marrëdhënieje huaje apo dhurimi, si dhe konfirmimin e kësaj marrëdhënieje. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk kemi as deklarin dhe as konfirmim të ndonjë marrëdhënieje huaje apo dhurimi mes subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj, që të legjitimonte verifikimin e mundësisë financiare të babait për kryerjen e pagesës 25.000 USD. Në këto kushte, vlerësoj se arsyetimi i shumicës në këtë pikë, nuk është në zbatim të përpiktë të ligjit, gjë që ka sjellë si pasojë afektimin e ekonomisë gjyqësore, nëpërmjet kryerjes së analizave financiare të tepërta dhe joproductive për persona të cilët ligji nuk i vesh me ndonjë detyrim për të justifikuar pasurinë e tyre.

2.4. Rrethanat faktike të mbështetura në prova, më bëjnë të mbaj qëndrim ndryshe nga ai i Komisionit dhe i shumicës së trupit gjykues në Kolegj. Më konkretisht, unë, gjyqtarja me mendim paralel, e vlerësoj si vijon këtë situatë.

2.4.1. Më datë 21.07.2001, lidhen dy kontrata porosie me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, përkatësisht: (i) kontratë porosie nr. {***} rep./kol., mes babait të subjektit të rivlerësimit, z. T. Ç., dhe sipërmarrësit, për porositjen e apartamentit me sipërfaqe 115 m², në vlerën 50.600 USD, prej të cilave 10.000 USD janë paguar nga z. T. Ç. jashtë zyrës noteriale, ndërsa pjesa tjetër do të paguhej sipas parashikimit në këtë kontratë; (ii) kontratë porosie nr. {***} rep./kol., nënshkruar mes porositësit Th. S., bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe së njëjtës shoqëri, për ndërtimin e apartamentit me sipërfaqe 93 m², kundrejt çmimit 40.900 USD.

2.4.2. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar rrethanat familjare, të cilat kanë çuar bashkëshortin dhe babain e saj, të binin dakord për këmbimin e apartamenteve apo modifikimin e sipërfaqeve të atyre të porositura te shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK nëpërmjet kontratave të porosisë. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, në momentin e nënshkrimit të kontratave të porosisë, ndërtimi ishte në fazat fillestare të tij dhe në kohën e ndërtimit, ngjarjet e ndodhura kishin ndryshuar qëllimin e blerjes së apartamenteve. Më konkretisht, vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. B. Ç., u largua familjarisht në vitin 2002 në Milano, Itali, me punë në Konsullatë, ndërsa babai i bashkëshortit ndërroi jetë në vitin 2003. Rrethanat e reja, në situatën kur akoma nuk kishin filluar ndarjet me tulla sipas apartamenteve, çuan në dakordësinë e babait të subjektit dhe bashkëshortit që të modifikoheshin në dy apartamente me sipërfaqe të ndryshme nga të parashikuarat në kontratën e porosisë, konkretisht njëri 135 m² dhe tjetri 60 m², ngjitur me njëri-tjetrin. Apartamentet u përshtatën që vjehrra e subjektit të rivlerësimit,

³¹ Ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 4 parashikon: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

mbetur e ve, të jetonte pranë tyre, ndërsa prindërit e saj të banonin në apartamentin në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, ndodhur në rrugën "{***}", Tiranë.

2.4.3. Përmes deklaratës noteriale nr. {***} rep./kol., datë 13.04.2005, babai i subjektit të rivlerësimit heq dorë nga pretendimet për pronësinë mbi apartamentin e ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, pasuri e cila buron nga kontrata e porosisë së datës 21.07.2001, dhe shpreh dakordësinë që ky apartament të regjistrohet në emër të subjektit të rivlerësimit (vajzës së tij) dhe bashkëshortit të saj.

2.4.4. Për të formalizuar vullnetin e tyre, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. Th. S., dhe babai i saj, z. T. Ç., nënshkruajnë: (i) kontratë premtim shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep./kol., datë 29.12.2005, mes premtuesit shitës Th. S. dhe blerësit T. Ç., i cili, referuar kontratës, i ka paguar premtuesit të shitjes jashtë zyrës noteriale, shumën 30.000 euro nga çmimi i blerjes 80.000 euro të apartamentit në rr. "{***}", Tiranë. Sipas kësaj kontrate, diferenca prej 50.000 eurosh do të paguhej brenda vitit 2006 dhe nëse kjo shitje nuk realizohej brenda afatit të përcaktuar, "palët kthehen në gjendjen e mëparshme"; (ii) kontratë shitjeje me rezervë nr. {***} rep./kol., datë 12.01.2006, përmes së cilës të njëjtat palë kanë rënë dakord që çmimi i apartamentit është 80.000 euro, blerësi ka likuiduar shumën 30.000 euro jashtë zyrës noteriale duke mbetur pa likuiduar edhe shuma prej 50.000 eurosh, e cila do të shlyhej brenda vitit 2006. Sipas kësaj kontrate, në rast të mosshlyerjes së shumës së mbetur pa likuiduar, shitësi do të rifitojë pronësinë e apartamentit, ndërsa blerësit do t'i kthehet shuma e paguar.

2.4.5. Sipas subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, *shuma prej 30.000 eurosh përfaqëson shumën totale që babai ka kontribuar në vitet 2001-2005, ku një sasi e kësaj shume është përdorur për të kryer pagesat e dy apartamenteve. Prandaj në kontratat premtim shitjeje/shitjeje me rezervë, ne i kemi njohur babait pagesë paradhënie për apartamentin në rrugën "{***}"*. Më pas, meqenëse prindërit e mi nuk patën interes për të paguar edhe pjesën tjetër të shumës sipas kontratës shitjeje me rezervë, për shkak se vëllai im me familjen qëndruan në Itali, ata hoqën dorë nga synimi për të blerë apartamentin në rrugën "{***}" dhe, në këto kushte, ne i kemi kthyer shumën prej 30.000 eurosh, duke mbetur apartamenti në pronësi tonën dhe ata duke vazhduar të banojnë aty.

2.4.6. Në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën e interesave privatë 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë shumën prej 30.000 eurosh nga babai i saj, si pagesë paraprake për blerjen e apartamentit në rr. "{***}", ndërsa në deklaratën periodike vjetore 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i ka kthyer babait shumën 30.000 euro, si dhe anulimin e kontratës së shitjes me rezervë të apartamentit.

2.5. Për sa më sipër parashtruar, vlerësoj se arsytimi i përdorur nga shumica e trupit gjykues nuk është i drejtë, pasi pavarësisht se apartamentet janë bashkuar në një pasuri të vetme në pronësi të familjes së subjektit të rivlerësimit, në kohën kur babai i subjektit ka porositur apartamentin në rr. "{***}", Tiranë, apo kur ka kryer pagesat për të në shumën 25.000 USD (30.000 euro), nuk ka pasur asnjë lidhje interesi pasuror mes tyre dhe porositja e apartamenteve është bërë në mënyrë të pavarur, me kontratat përkatëse. Kanë qenë rrethanat familjare, si transferimi në Milano, Itali, i

vëllait të subjektit, vdekja e vjehrrit të saj, si dhe nevoja që vjehrra të vinte në Tiranë dhe të jetonte afër të birit, që kanë çuar prindërit e subjektit të rivlerësimit drejt heqjes dorë nga apartamenti i porositur në rr. “{***}” dhe kalimi i tyre tek apartamenti tjetër në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj, në rrugën “{***}”, Tiranë, veprime këto plotësisht të provuara me dokumentacion justifikues të kohës (shih paragrafët 2.4.3 dhe 2.4.4). Në asnjë rast, nuk rezultojnë të jetë deklaruar apo konfirmuar ndonjë marrëdhënie huaje apo dhurimi mes subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe babait të saj. Mbështetur në sa arsyetuar më sipër, në vlerësimin tim, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se babai i saj nuk mund të konsiderohet person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4, janë bindëse dhe të bazuara në prova dhe në ligj dhe, në këto kushte, ngarkimi i subjektit të rivlerësimit me detyrimin për të justifikuar mundësinë e krijimit me të ardhura të ligjshme të shumës 25.000 USD është në kapërcim të kërkesave të ligjit nr. 84/2016. Gjykata duhet të jetë e vëmendshme në analizimin harmonik të provave dhe, në përfundim, duhet të dalë me një konkluzion bindës, të analizuar profesionalisht dhe të kuptueshëm. Prandaj, rasti në fjalë, i cili ka të bëjë me një dispozitë të interpretuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, siç është neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2026, i cili në rastin objekt gjykimi, për mua nuk gjen zbatim.

*II. Për pasuritë, apartamente me sipërfaqe 184,2 m² dhe 82,4 m², si dhe tri garazhe me sipërfaqe 21,93 m², 15,95 m² dhe 15,08 m², me vendndodhje në rr. “{***}”, kompleksi {***}, Tiranë.*

3. Shumica e trupit gjykues, nisur nga mosdeklarimi i huasë, marrë nga z. K. P., në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore, si burim për krijimin e këtyre pasurive objekt shqyrtimi, si dhe mospasjen e gjurmëve bankare për marrjen e saj, formalizimin në një kontratë tipike huaje, si dhe mungesën e të ardhurave të huadhënësit, nuk e ka konsideruar atë si të ardhur të ligjshme.
4. Komisioni për këtë pasuri ka konkluduar se: *pretendimi i subjektit mbi mosdeklarimin e huasë mund të vlejë vetëm për sa i përket deklaratës vjetore, por në deklaratën “vetting” duhej ta kishte deklaruar këtë hua si një nga burimet financiare të përdorura për pagesën e pasurive në analizë në këtë pikë – ndonëse fakti që pas pak muajve dhe brenda të njëjtit vit, është përfituar një kredi bankare dhe me këto të ardhura është kthyer shuma e huazuar, mund të ketë çuar në një mbivendosje të burimit, duke cituar në deklaratën “vetting” vetëm kreditë. [...] trupi gjykues vlerëson se shpjegimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me rezultatet e hetimit, ndonëse krijojnë bindjen e disponibilitetit de facto të huadhënësit të shumës në fjalë prej 100.000 eurosh, nëpërmjet përdorimit të mjeteve monetare që përbënin kapitalin dhe/ose fitimin apo gjendjen e arkës së shoqërisë së tij, por nuk përmbushin kriteret e konsiderimit si një burim i ligjshëm në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion mbështetet mbi faktet si vijojnë: (i) të ardhurat e deklaruara nga shtetasi K.P. në DIVA-t e viteve 2012 dhe 2013 përkojnë/përfaqësojnë fitimet e realizuara nga shoqëria dhe jo të individit; (ii) edhe tatimet e përshkruara në DIVA-t e sipërcituara referojnë shumat e paguara si detyrime tatimore prej kësaj shoqërie mbi fitimin e realizuar dhe jo tatime të paguara nga individit K. P.; (iii) siç është konstatuar edhe nga pasqyrat financiare të shoqërisë së shtetasit K.P., këto fitime nuk janë tërhequr prej këtij të fundit, por janë vendosur në rezervat e tjera të shoqërisë – duke e pamundësuar konsiderimin e këtyre mjeteve monetare si të disponueshme dhe të*

përdorshme nga individi-huadhënës; (iv) edhe nëse do të konsiderohej përdorimi në këtë huadhënie i shumave të fituara, pjesë e arkës apo e rezervave, mungon prova e përshkrimit të veprimeve financiare në fjalë (dhënie huaje dhe marrje huaje), në datat përkatëse, në librat e shoqërisë, konkretisht në lëvizjet e arkës – për sa kohë ka qenë detyrim pasqyrimi në kohë reale i çdo daljeje dhe hyrjeje të shumave monetare të shoqërisë, për më tepër që në rastin konkret bëhet fjalë për një shifër të rëndësishme prej 100.000 eurosh, që veç të tjerash, pretendohet se është dorëzuar cash.

Për rrjedhojë të sa më sipër, *stricto legis* dhe sipas jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke mos e konsideruar huamarrjen e lartpërmendur, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij rezulton me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën negative prej 14.021.000 lekësh për pagesën e çmimit të këtyre pasurive. Gjithashtu, duhet qartësuar se: (i) nga njëra anë kjo pamundësi financiare, në momentin e kryerjes së pagesave (si më sipër përshkruar), nuk ndikon në analizën financiare të vitit 2013 – duke mos u reflektuar kjo mungesë në fund të vitit në fjalë, për shkak të marrjes së kredisë bankare prej subjektit disa muaj më pas, shumave të përdorura pikërisht (edhe) për shlyerjen e kësaj huaje, duke u mbivendosur si burim alternativ brenda vitit, dhe për pasojë duke bërë që viti 2013 të mos rezultojë me balancë negative; (ii) nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se edhe nëse huamarrja në fjalë do të konsiderohej me burim të ligjshëm financiar, ndonëse përfaqëson një shumë të konsiderueshme, kjo nuk do të mjaftonte që vlerësimi dhe vendimi përfundimtar dhe gjithëpërfshirës i kriterit të pasurisë të ishte i ndryshëm/pozitiv, për sa kohë pamjaftueshmëria totale që ka rezultuar në analizën financiare të pasurive/shpenzimeve të tjera (pa pasur asnjë efekt negativ prej kësaj huaje), si dhe problematikat e konstatuara lidhur me deklaratimet, nuk do ta mundësonin gjithsesi mosaplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

5. Ndryshe nga Komisioni dhe shumica e trupit gjykues, për situatën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me huanë që bashkëshorti i saj ka marrë nga z. K. P. për të krijuar pasurinë objekt shqyrtimi, arsyetojë e vlerësoj si më poshtë.

5.1. Më datë 04.10.2010, nënshkruhet kontratë sipërmarrjeje mes shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK (në vijim “{***}” ShPK) dhe porositësit Th. S., me objekt ndërtimin e dy apartamenteve me sipërfaqe bruto 199,54 dhe 89,26 m², përkatësisht kundrejt vlerës 200.000 euro. Më datë 04.03.2013, nënshkruhet kontratë shitblerjeje për pasuri të paluajtshme nr. {***} rep./kol., mes palës shitëse, shoqërisë “{***}” ShPK, dhe palës blerëse Th. e Zegjine Sollaku, me objekt blerjeje: (i) apartament me sipërfaqe neto 82,4 m², në vlerën 81.000 euro; (ii) apartament me sipërfaqe neto 184,2 m², në vlerën 181.200 euro; (iii) garazh me sipërfaqe 15,08 m², në vlerën 10.800 euro (iv) garazh me sipërfaqe 15,95 m², në vlerën 11.400 euro; (v) garazh me sipërfaqe 21,93 m², në vlerën 15.600 euro. Në këtë kontratë, palët deklarojnë se likuidimi i shumës 300.000 euro është bërë nëpërmjet bankës në numrin e llogarisë së shoqërisë “{***}” ShPK, para datës së nënshkrimit të kësaj kontrate dhe jashtë zyrës noteriale.

5.2. Kontratat e sipërcituara janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë të viteve respektive, 2010 dhe 2013 përkatësisht.

5.3. Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep./kol., datë 25.06.2013, në të cilën z. K. P. deklaroi se në janar të vitit 2013, i ka dhënë Th. S., hua shumë 100.000 euro, me afat 1 (një) vjeçar dhe pa interes, për blerjen e një apartamenti.

5.4. Si burim krijimi të këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*: (i) kredi bankare në shumë 200.000 euro, financuar nga ish-Banka Amerikane e Shqipërisë (sot Intesa SanPaolo Bank ShA, në vijim “ISP ShA”), me kontratë kredie nr. {***} rep./kol., datë 04.07.2007; (ii) kredi bankare në shumë 193.000 euro, financuar nga Tirana Bank ShA nëpërmjet kontratë kredie nr. {***} rep./kol., datë 16.07.2013.

- Referuar kontratës së kredisë me ish-Bankën Amerikane të Shqipërisë ShA, kredia në shumë 200.000 euro do të përdorej për blerjen e një apartamenti të ri dhe do të disbursohej në dy këste, respektivisht 100.000 euro kësti i parë dhe 100.000 euro kësti i dytë, sipas kërkesës së klientit. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare, rezultoi se më datë 06.10.2010, nga llogaria e kredisë në Intesa SanPaolo Bank është kryer transferi i shumës 200.000 euro në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “Pagesë për porositje apartamenti”.

- Në kontratën e kredisë bankare me Tirana Bank ShA, përcaktohet se kredia në shumë 193.000 euro do të përdorej nga kredimarrësi: (i) për blerje kredie hipotekare në Union Bank ShA; dhe (ii) për likuidimin e borxhit të marrë për blerjen e apartamentit në Tiranë. Kjo kredi, sikurse parashikuar në kontratë, do të disbursohej: a) 93.000 euro do të transferoheshin në Union Bank për të mbyllur kredinë hipotekare; b) 100.000 euro do të transferoheshin në llogarinë e z. K. P. (borxhdhënës).

- Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare të bashkëkredimarrësve, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në Tirana Bank ShA, rezultoi që kredia në shumë 193.000 euro të jetë disbursoar në datën 19.07.2013, në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe në të njëjtën datë, të jetë transferuar prej saj shuma 93.000 euro për mbylljen e kredisë hipotekare të kredimarrësve në Union Bank ShA, me përshkrimin: “Transferi për mbyllje kredie”, ndërsa diferenca prej 100.000 eurosh të jetë transferuar në llogarinë e borxhdhënësit K. P., me përshkrimin: “Kthim borxhi sipas kontratës së kredisë”.

5.5. Sipas analizës më sipër, provat e sipërcituara dëshmojnë vërtetësinë e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit se: *shuma e marrë hua nga K. P. në janar 2013, është përdorur për të paguar pranë “{***}” ShPK, diferencën 100.000 euro, shumë kjo e paguar në shkurt me tri mandatpagesat cash nga bashkëshorti. Subjekti shpjegoi se ish-in të detyruar të marrin hua, pasi shoqëria “{***}” kërkonte me insistim likuidimin e diferencës së mbetur dhe, pas kësaj, të bënte veprimet në ZRPP për kalimin e pronësisë, çka ishte dhe në interesin e tyre. Ndërkohë marrja e kredisë nga banka kërkonte më tepër kohë. Pavarësisht pasaktësive në kontratën e kredisë me Bankën Tirana, në finale, destinimi i shumës së kredisë të marrë në Bankën Tirana, prej 100.000 eurosh, i ka shërbyer pagesës për blerje apartamenti, duke shlyer huanë e dhënë nga K. P., me anë të së cilës u pagua diferenca e vlerës për blerjen e apartamenteve dhe garazheve pranë “{***}” ShPK.*

5.6. Jam dakord që subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor për ta deklaruar huanë në shumën 100.000 euro, marrë nga shtetasi K. P. në vitin 2013, në deklaratën periodike të vitit përkatës, pavarësisht faktit që ky detyrim është mbyllur brenda vitit, por gjej të pabazuar konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë ekzistencën marrëdhënies së huasë në shumën 100.000 euro. Dokumentet shkresore të administruara në cilësinë e provës, si deklarata noteriale e datës 25.06.2013, e z. K. P., përcaktimet në kontratën e kredisë bankare me Tirana Bank ShA, si dhe veprimet bankare, provojnë në mënyrë të pakundërshtueshme marrëdhënien e huasë mes palëve. Këto akte noteriale përkohë me kohën e dhënies së shumës 100.000 euro, njëkohësisht përputhen me të gjitha shpjegimet e subjektit lidhur me këtë hua dhe me qëllimin e përdorimit të kësaj huaje, akte të cilat nuk janë krijuar përgjatë procesit të rivlerësimit.

5.7. Lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit K. P., për dhënien hua të shumës 100.000 euro në janar të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit akte shkresore lidhur me situatën financiare të huadhënësit, që në vlerësimin tim provojnë mundësinë financiare të tij, për dhënien e kësaj huaje.

Konkretisht, dokumentacioni provues i administruar në dosjen gjyqësore konsiston në: ekstrakt regjistrimi të aktivitetit të tij si person fizik në QKB, dhe lëvizjet e llogarisë bankare të borxhdhënësit në Veneto Bank ShA për vitin 2012. Nga verifikimi i të dhënave në ekstraktin historik të regjistrimit në QKB, me NIPT {***}, më datë 16.02.2010, konfirmohet aktiviteti ekonomik i huadhënësit si investitor në fushën e ndërtimit. Nga analizimi i pasqyrave financiare të administruara për vitin 2010, subjekti ka rezultuar me humbje në masën – 170.477 lekë, me fitim 40.212.320 lekë për vitin 2011, të cilin subjekti e ka transferuar në “Rezerva të tjera”³², dhe 27.950.923 lekë për vitin 2012, i cili rezulton “Fitim i pashpërndarë”. Ndërkohë në analizën analitike të bilancit financiar për vitin 2010, në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, rezulton që shoqëria i ka dhënë hua ortakut K. P. shumën 10.993.207 lekë (apo 79.200 euro, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit ALL/EUR për vitin 2010).

Po kështu, nga analizimi i bilancit kontabël të aktivitetit të personit fizik “K. P.” për vitin 2012, zëri “Hua të tjera” (pasiv të bilancit), rezulton me balancë 102.611.440 lekë. Nga leximi i shënimeve shpjeguese, “Listë e llogarive K. P. PF – viti 2012”, bashkëlidhur bilancit të këtij viti, rezulton që “Hua të tjera” konsiston në “Kreditorë-debitorë të tjerë, K. P.”, me balancë 102.611.440 lekë. Pra, siç rezulton nga analizimi i pasqyrave financiare, shtetasi K. P. ka pasur të disponueshme gjendje likuiditetesh për periudhën 2010-2012, qoftë edhe në formë huaje nga vetë aktiviteti ekonomik.

Përveç sa sipër, nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të personit fizik “K. P.”, me nr. {***}, në monedhën euro, në Veneto Bank ShA, për periudhën 06.01.2012 – 31.12.2012, rezulton që kjo llogari të jetë kredituar nga klientë (blerës apartamentesh) në shumën 406.905 euro dhe me shumën 160.500 euro të depozituar *cash* në arkë nga vetë K. P., ndërsa ka tërhequr nga kjo llogari 28.700 euro dhe janë transferuar për llogari të shoqërisë “{***}” SA, 526.997 euro. Llogaria e

³² Sikurse rezulton nga analizimi i pasqyrës financiare të ndryshimit të kapitalit për periudhën 01.01.2012 - 31.12.2012, bashkëlidhur pasqyrës së bilancit financiar të vitit 2012.

sipërcituar, më datë 31.12.2012, ka rezultuar me balancë negative në vlerën - 29,90 euro, që tregon se shumat e kredituara në të, janë tërhequr.

5.8. Nga sa më sipër konstatuar, ndryshe nga shumica, vlerësoj se provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit provojnë se huadhënësi kishte në disponim gjendje likuiditeti nga aktiviteti ekonomik i ligjshëm dhe qarkullonte shuma të konsiderueshme, të cilat tejkalonin vlerën e dhënë hua, e që për rrjedhojë më krijojnë bindjen se përmbushen kërkesat e parashikuara në ligj, që kjo hua të konsiderohet e ligjshme e të përfshihet në analizën financiare për krijimin e pasurive objekt shqyrtimi.

5.9. Në mënyrë të përmbledhur, nisur nga faktet e konstatuara nga analizimi i provave të administruara:, (i) deklarata noteriale e kohës nr. {***} rep./kol., datë 25.06.2013, e palëve në marrëdhënien e huasë, deklaruar përpara notere A. R. M.; (ii) përcaktimet në kontratën e kohës së kredisë bankare hipotekare nr. {***} rep./kol., datë 16.07.2013, në të cilën parashikohet në mënyrë eksplicite përdorimi i një pjese të kredisë (100.000 euro) për të shlyer borxhdhënësin K. P.; (iii) të dhënat e bilanceve financiare dhe lëvizjet e llogarive bankare tregojnë se borxhdhënësi ka pasur gjendje disponibël likuiditeti për t'i dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumën 100.000 euro në janar të vitit 2013, të para në harmoni, më krijuan bindjen se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje, qëndrojnë.

6. Pavarësisht se kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 416, datë 08.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, vlerësoj se situata financiare e saj nuk mund të rëndohet edhe për çështjet e trajtuara në këtë mendim paralel, të cilat e ngarkojnë padrejtësisht subjektin e rivlerësimit, përtej asaj që parashikon ligji.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi